

Mekanizmi i Raportimit të Pavarur (MRP): Raporti i Progresit për Shqipërinë 2016 - 2017

Gjergji Vurmo, Hulumtues i pavarur

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje Ekzekutive: Shqipëria	2
I. Hyrje	11
II. Konteksti	12
III. Udhëheqja dhe Procesi me Shumë Aktorë	17
IV. Angazhimet	28
1. Përmirësimi i portalit për akses tek informacioni	30
2. Transparenca e buxhetit	33
3. Regjistri i integruar i banesave të shtetasve	37
4. Regjistri i njoftimeve dhe konsultimeve publike	40
5. Arkiva Dixhitale	43
6. Baza e të dhënave të kërkimeve shkencore	46
7. Publikimi në internet i legjislacionit të qeverisë	49
8. Regjistri Elektronik i Koncesioneve	53
★9. Zbatimi i Ligjit për Sinjalizimet dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve	57
10. Ofrimi i shërbimeve elektronike	62
11. Thjeshtimi i aplikimit për lejet e ndërtimit	65
12. Ngritja e sporteleve dixhitale	68
13. Standardizimi i shërbimit të pasaportave	71
14. Kartela informative e qytetarit	74
15. Receta elektronike pilot	77
16. Sistemi i monitorimit elektronik të pyjeve	80
17. Sistemi elektronik për aplikimet për licenca profesionale	83
V. Rekomandime të përgjithshme	86
VI. Metodologjia dhe burimet	90
VII. Shtojca e Kushteve për Pranim	99



Përmbledhje Ekzekutive: Shqipëria

Mekanizmi i Raportimit të Pavarur (MRP) Raporti i Progresi 2016-2017

Në planin e tretë kombëtar të veprimit të Shqipërisë trajtohen çështje që variojnë nga aksesimi tek informacioni, kontratat e hapura deri tek mbrojtja e sinjalizuesve. Megjithatë, më pak se gjysma e angazhimeve kanë lidhje të qartë me vlerat PQH dhe vetëm një angazhim ka ndikim të mundshëm transformues. Për të ardhmen, është me rëndësi të madhe që qeveria të harmonizojë përparësitë e saj PQH me reformat për anëtarësim në BE dhe të prioritetizojë angazhime të tilla si transparenca e prokurimeve publike, deklarimi i pasurive të zyrtarëve publikë dhe zbatimi me efektivitet i ligjit për konsultimin publik.

Partneriteti për Qeverisje të Hapur (PQH) është një nismë vullnetare ndërkombëtare që synon të sigurojë angazhime të qeverive ndaj qytetarëve për të promovuar transparencën, fuqizimin e qytetarëve, luftën ndaj korrupsionit, dhe për të shfrytëzuar teknologjitë e reja për forcimin e qeverisjes. Shqipëria filloi të marrë pjesë në PQH në shtator të vitit 2011. Mekanizmi i Raportimit të Pavarur (MRP) shqyrton çdo vit aktivitetet e çdo vendi që merr pjesë në PQH.

Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike (MIAP) është institucioni kryesor që përgjigjet për angazhimet PQH të Shqipërisë. MIAP nuk ka fuqi ligjore për të imponuar ndryshime tek agjencitë e tjera të qeverisë qendrore dhe kompetencat e saj për t'iu imponuar autoriteteve nënkombëtare ishin të kufizuara. MIAP nuk ekziston më pas ndryshimeve në qeveri në shtator të vitit 2017. Koordinator i ri Kombëtar për PQH nuk është caktuar ende.

MIAP ngriti Grupin Ndërmnistror të Punës (GNP) me përfaqësues nga çdo institucion pjesëmarrës sipas Urdhrit të Kryeministrit. Ndonëse ky Urdhër përcakton se organizatat e shoqërisë civile (OSHC) mund të marrin pjesë në takimet e GNP-së, OSHC nuk u bënë pjesë e këtij organi në planin aktual të veprimit. Në mars të vitit 2016 u krijua OpenAlb, forumi i aktorëve kryesorë.

Në një shikim:

Anëtar prej:	2011
Numri i angazhimeve:	17

Niveli i zbatimit:

I përfunduar:	35% (6)
I konsiderueshëm:	24% (4)
I kufizuar:	29% (5)
Nuk ka filluar:	12% (2)

Theksi i angazhimit:

Akresi në informacion:	47% (8)
Pjesëmarrja qytetare:	18% (3)
Përgjegjshmëria publike:	6% (1)
Teknologjia & inovacioni për transparencë & llogaridhënie:	24% (4)

Angazhime që janë

Qartësisht relevante për një vlerë të PQH:	41% (7)
Me ndikim potencial transformues:	6% (1)
Të zbatuara ndjeshëm ose plotësisht:	59% (10)
Të treja (★):	6% (1)

Procesi i PQH

Vendet pjesëmarrëse në PQH ndjekin një proces të caktuar për konsultimin gjatë hartimit të plan veprimit PQH dhe gjatë zbatimit të tij.

Zyrtarët e MIAP dhe Koalicioni i OSHC-ve për Shqipëri PQH (organizatat që iniciuan OpenAlb) patën disa takime për t'u bashkërenduar në hartimin e planit të veprimit. Në prill 2016 nga institucionet qeveritare dhe OSHC-të u propozuan 42 angazhime, të cilat më pas u botuan për komente nga publiku. Edhe pse nga qeveria u morën parasysh disa sugjerime të OSHC-ve, MIAP kishte fjalën e fundit në miratimin e planit të veprimit. Nga 42 angazhime të propozuara, u përfshinë 17, 4 nga të cilat u propozuan nga organizatat e shoqërisë civile.

Qeveria dhe OSHC-të punuan bashkërisht për ngritjen e OpenAlb si forum i aktorëve të përfshirë. Edhe pse OpenAlb ka luajtur një rol kryesor në hartimin e planit të veprimit, ky organizëm është mbledhur vetëm një herë gjatë periudhës së zbatimi të planit të veprimit. OpenAlb u bë pasiv pas muajit nëntor 2016. Në të ardhmen është me rëndësi që OpenAlb të mbledhet rregullisht dhe të vendosë rregulla zyrtare të funksionimit të saj, anëtarësisë në të dhe raportimit.

Deri në kohën kur u përpilua ky raport (tetor 2017), qeveria shqiptare nuk kishte publikuar asnjë raport vetëvlerësimi.

Zbatimi i angazhimeve

Si pjesë e pjesëmarrjes në PQH, vendet ndërmarrin angazhime në një plan veprimi dy-vjeçar. Plan Veprimi i Shqipërisë përmban 17 angazhime. Në Tabelën 1 jepen përmbledhtazi për secilin angazhim niveli i zbatimit dhe ndikimi potencial. Në Tabelën 2 jepet një panoramë e progresit të arritur për secilin angazhim dhe rekomandimet për hapat e mëtejshëm. Në disa raste, angazhimet e ngjashme grupohen dhe ri-renditen për të lehtësuar leximin.

Duhet pasur parasysh se MRP i përditësoi kriteret për angazhimet me yll në fillim të vitit 2015 për të rritur standardet për angazhimet model të PQH. Sipas këtyre kriterëve, angazhimet duhet të jenë tejet specifike, relevante ndaj vlerave PQH, me ndikim potencial transformues dhe të zbatuara plotësisht ose ndjeshëm (në nivel të konsiderueshëm). Shqipëria ka marrë një angazhim me yll (Angazhimi 9).

Tabela 1: Vlerësimi i progresit sipas angazhimeve

EMRI I SHKURTËR I ANGAZHIMIT	NDIKIMI POTENCIAL				NIVELI I ZBATIMIT			
	ASNJË	MINIMAL	I MESËM	TRANSFORMUES	NUK KA FILLUAR	I KUFIZUAR	KONSIDERUESHËM	I PËRFUNDUAR
ANGAZHIMI ★ ËSHTË I MATSHËM, QARTËSISHT RELEVANT NDAJ VLERAVE TË PQH (SIÇ ËSHTË SHKRUAR NË PV), KA NDIKIM POTENCIAL TRANSFORMUES DHE ËSHTË ZBATUAR PLOTËSISHT OSE NDJESHËM.								
1. Përmirësimi i portalit për aksesin tek informacioni								
2. Transparenca e buxhetit								
3. Regjistri i integruar për vendbanimin e qytetarëve								
4. Regjistri i njoftimeve dhe konsultimeve publike								
5. Arkiva dixhitale								
6. Baza e të dhënave e kërkimeve shkencore								
7. Publikimi në internet i legjisllacionit të qeverisë								
8. Regjistri elektronik i koncesioneve								
★9. Zbatimi i Ligjit “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”								
10. Ofrimi i shërbimeve elektronike								
11. Thjeshtimi i aplikimit për lejet e ndërtimit								
12. Ngritja e sporteleve dixhitale								
13. Standardizimi i shërbimit të pasaportave								
14. Kartela informative e qytetarit								
15. Receta elektronike pilot								
16. Sistemi i monitorimit elektronik të pyjeve								
17. Sistemi elektronik për aplikimet për licenca profesionale								

Tabela 2: Përmbledhje e progresit sipas angazhimeve

EMRI I ANGAZHIMIT	REZULTATET
1. Përmirësimi i portalit për aksesin tek informacioni - Lidhja me vlerën PQH: E qartë - Ndikimi i mundshëm: Mesatar - Zbatimi: Përfunduar	Mungesa e një portali të centralizuar për marrjen e kërkesave për informacion bëhet pengesë për zbatimin e Ligjit për të Drejtën e Informimit. Ky angazhim përfshin një funksion në portalin “pyet shtetin” për të gjurmuar kërkesat për informacion, përfshin një mekanizëm ankesash dhe zgjeron bazën e të dhënave për programet e transparencës dhe informacionet e kontaktit për koordinatorët e të drejtës për informim. Në vitin 2016 në portal u shtua një funksion gjurmimi që u bën të mundur palëve të interesuara të kontrollojnë gjendjen e kërkesës së tyre për informacion ose ankesën që kanë bërë. Portali ka edhe të dhëna të përditësuara për programet e transparencës dhe koordinatorët e të drejtës për informim. Hulumtuesi i MRP-së konstatoi se numri i ankesave të paraqitura është rritur ndjeshëm. Për të ardhmen, qeveria duhet të sigurojë marrjen e masave administrative kundër personave përgjegjës që shkelin ligjin.
2. Transparenca e buxhetit - Lidhja me vlerën PQH: E qartë - Ndikimi i mundshëm: Mesatar - Zbatimi: Konsiderueshëm	Ky angazhim synon të përmirësojë transparencën dhe pjesëmarrjen në procesin e buxhetimit duke rritur sasinë e dokumenteve buxhetore që duhet të publikohen si dhe duke rritur mundësitë që qytetarët të marrin pjesë në procesin e përgatitjes së buxhetit. Buxheti i Qytetarëve për vitet 2016 dhe 2017, lista e investimeve publike, raportet e monitorimit për çdo ministri dhe të gjitha dokumentet që lidhen me projekt buxhetin u publikuan në faqen në internet të Ministrisë së Financave, edhe pse sa informacion ka shkuar te publiku është ende e paqartë. Konsultimet nuk përfshinë shoqërinë civile në procedurën e hartimit të buxhetit. Për të ardhmen, qeveria duhet të nxisë pjesëmarrjen e qytetarëve dhe të bëjë përpjekje për përmirësimin e përdorimit të informacionit mbi buxhetin.
3. Regjistri i integruar për vendbanimin e qytetarëve - Lidhja me vlerën PQH: E paqartë - Ndikimi i mundshëm: I vogël - Zbatimi: I kufizuar	Për të ofruar sa më mirë shërbimet civile, si asistencë sociale apo për të marrë informacione të rëndësishme për emigrantët shqiptarë për përdorim në institucionet shtetërore dhe private, Ministria e Brendshme (MB) synon të krijojë një Regjistrë të përditësuar të Banesave të shtetasve, regjistrë që do të përqendrojë të gjitha informacionet për qytetarët shqiptarë në një vend të vetëm. Lidhja e këtij angazhimi me vlerën PQH është e paqartë, duke qenë se regjistri do të jetë i aksesueshëm vetëm për zyrtarët publike. Në nëntor të vitit 2015 Ministria e Brendshme njoftoi për krijimin e bazës së re të të dhënave dhe në vitin 2016 sistemi i popullimit me të dhëna u fillua në tre bashki pilot. Në fund të vitit të parë të zbatimit, më pak se gjysma e adresave të qytetarëve (600,000) ishin verifikuar gjatë fazës pilot. Për ta mundësuar lidhjen me vlerën PQH të këtij angazhimi qeveria mund të përfshijë një nismë për të dhëna të hapura me qëllim që t'i japë publikut akses tek regjistri i integruar.
4. Regjistri i njoftimeve dhe konsultimeve publike - Lidhja me vlerën PQH: E qartë - Ndikimi i mundshëm: Mesatar	Për të siguruar zbatimin efektiv të ligjit dhe për të rritur përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje, ky angazhim përfshin një portal për konsultim që integrohet me portalin e-Albania dhe nuk kërkon regjistrimin për të parë projekt-dokumentet. Portali i ri që mban regjistrin për njoftimet publik u hap në kohë: është i integruar me portalin e-Albania dhe përfshin seksione për konsultime me qytetarët dhe ekspertët. Për shkak të mungesës së

• Zbatimi: Përfunduar	ndërgjegjësimit, nuk është bërë asnjë koment apo sugjerim nga qytetarët apo ekspertët nëpërmjet portalit për 15 projektligjet e para që u hodhën në portal për konsultim. Për të ardhmen, qeveria duhet të nisë një fushatë publike për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për portalin dhe për të hartuar procedura nënligjore me qëllim drejtimin e angazhimit publik.
5. Arkiva dixhitale • Lidhja me vlerën PQH: E paqartë • Ndikimi i mundshëm: I vogël • Zbatimi: I kufizuar	Mungesa e një baze të dhënash shtetërore online ose e arkivit dixhital u krijon vështirësi qytetarëve që duan të marrin dokumente që lidhen me ndërtimet. Ky angazhim synon të ndihmojë zbatimin e Axsendës së Shqipërisë Dixhitale duke ofruar akses tek shërbimet dhe materialet në internet. Aktorët kryesorë bien dakord se ky angazhim përbën një hap përpara në drejtim të përmirësimit të shërbimeve qeveritare përmes dixhitalizimit, ndonëse, lidhja e tij me vlerat PQH është e paqartë, pasi ky angazhim nuk specifikon nëse arkiva dixhitale është e destinuar për përdorim publik. Që nga shtatori 2017, institucioni kryesor nuk ekziston më dhe prova e vetme e përfundimit të zbatimit të këtij angazhimi është një VKM për miratimin e akteve nënligjore për të mundësuar krijimin e arkivit dixhital. Për të ardhmen, ky angazhim duhet të rishikohet në planin e ardhshëm të veprimit për të siguruar akses publik tek arkivi dixhital duke e integruar atë në portalin e-Albania.
6. Baza e të dhënave e kërkimeve shkencore • Lidhja me vlerën PQH: E qartë • Ndikimi i mundshëm: Mesatar • Zbatimi: Nuk ka nisur	Me qëllim nxitjen së bashkëpunimit trepalësh (publik-shoqëri civile-privat) në zhvillimin e politikave dhe afimit të Shqipërisë me standardet e BE-së për shkencë të hapur, ky angazhim synon hartimin, miratimin dhe promovimin e standardeve të hapura dhe krijimin e legjislacionit që do të mundësojë një portal për kërkimin e të dhënave shkencore dhe publikimet e financuara nga qeveria. Agjencia përgjegjëse për zbatimin e këtij angazhimi iu nënshtrua reformave dhe është përballur me mungesën e burimeve njerëzore dhe infrastrukturës. Hulumtuesi MRP nuk konstatoi progres në zbatimin e këtij angazhimi. Për të ardhmen, angazhimi duhet të riformulohet dhe të përshtatet me kompetencat e institucionit përgjegjës dhe për të duhet të kërkohet bashkëpunimi i institucioneve përkatëse.
7. Publikimi në internet i legjislacionit të qeverisë • Lidhja me vlerën PQH: E qartë • Ndikimi i mundshëm: Mesatar • Zbatimi: I kufizuar	Edhe pse akses i publikut tek legjislacioni është detyrim ligjor, legjislacioni i qeverisjes vendore nuk publikohet dhe nuk bëhet i disponueshëm për publikun në të 61 bashkitë e vendit dhe sistemi aktual për ofrimin e informacionit për legjislacionin e tyre është joefikas. Ky angazhim përcakton se ministritë e qeverisë qendrore e publikojnë informacionin për legjislacionin në faqet e tyre të internetit, kurse bashkitë e publikojnë legjislacionin në adresën www.vendime.al. Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore nuk ishte në dijeni të përgjegjësisë së tij dhe nuk ishte në gjendje të ofronte informacione për përfundimin e angazhimit. Plot 41 nga 61 (67 për qind) njësi të qeverisjes vendore publikuan informacione për vendimet/urdhëresat e tyre në vitin 2017, duke shënuar kështu një rritje krahasuar me 12 NJQV që publikonin në vitin 2016. Për të ardhmen, angazhimi duhet të riformulohet për të përcaktuar qartë përgjegjësinë institucionale, përfshirë këtu edhe mekanizmat për konsultime publike kur hartohen aktet nënligjore dhe të tjera.
8. Regjistri elektronik i koncesioneve	Ky angazhim synon të përmirësojë aksesin tek informacioni, mbikëqyrjen publike dhe integritetin e institucioneve të përfshira në menaxhimin e koncesioneve dhe partneriteteve publike-private

• Lidhja me vlerën PQH: E qartë • Ndikimi i mundshëm: Mesatar • Zbatimi: I kufizuar	(PPP) me anë të krijimit të një regjistri elektronik për koncesionet bazuar në Ligjin aktual mbi Koncesionet dhe PPP. Agjencia e Trajtimin të Koncesioneve e nisi regjistrin në fund të vitit 2016. Vetëm një pjesë e kontratave janë publikuar në regjister dhe asnjë prej këtyre kontratave nuk është në formatin e të dhënave të hapura. Për të ardhmen, regjistri duhet të publikojë të gjitha kontratat në formatin e të dhënave të hapura në përputhje me OCDS, dhe të harmonizohet edhe më tej me rregullat e BE-së për prokurimet publike.
9. Zbatimi i Ligjit “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” • Lidhja me vlerën PQH: E qartë • Ndikimi i mundshëm: Transformues • Zbatimi: Përfunduar	Ky angazhim ka për qëllim rritjen e denoncimit të rasteve të korrupsionit dhe mbrojtjen e informatorëve nëpërmjet zbatimit të Ligjit " Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve" në katër hapa: miratimi i akteve nënligjore, konsultimi me grupet e interesit, përmirësimi i kapaciteteve të institucionit mbikëqyrës dhe rritja e sensibilizimit publik për sinjalizimin. Aktet nënligjore u hartuan dhe u miratuan pasi organizata “Partnerët Shqipëri” nisi fazën e komenteve publike dhe zhvilloi konsultime publike. Kjo organizatë dhe ILDKPKI zhvilluan disa aktivitete për ngritjen e kapaciteteve dhe organizuan dy fushata, duke ofruar informacion për ligjin, përfitimet që sigurohen ligji dhe të tjera. Për të ardhmen, qeveria duhet të vazhdojë aktivitetet e ndërgjegjësimin dhe trajnimit.
10. Ofrimi i shërbimeve elektronike • Lidhja me vlerën PQH: E paqartë • Ndikimi i mundshëm: I vogël • Zbatimi: Përfunduar	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI) synon të ngrejë një sistem për menaxhimin e formularëve elektronikë për të ndihmuar institucionet publike uljen e numrit të dokumenteve dhe kohën që nevojiten për të ofruar shërbime. Në mënyrë të veçantë, AKSHI synon të dixhitalizojë 36 shërbime të Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ) dhe të ofrojë një shërbim të lejeve elektronike, duke mundësuar aplikimin online për lejet e ndërtimit. Deri në vitin 2017, të 36 shërbimet e MPJ-së ofroheshin në portalin e-Albania dhe në faqen e internetit të MPJ-së. Shërbimet e lejes elektronike nisën të ofroheshin në portalin e-Albania në fillim të hartimit të planit të veprimit dhe përdorimi i tij është i ulët tek bashkitë e vogla e të mesme. Për të ardhmen, duhet të hartografohet përdorimi i shërbimit që ofrohet në portalin e-Albania dhe të shtohet një element i komunikimit me publikun për të siguruar lidhen me vlerat PQH.
11. Thjeshtimi i aplikimit për lejet e ndërtimit • Lidhja me vlerën PQH: E paqartë • Ndikimi i mundshëm: Mesatar • Zbatimi: Përfunduar	Me qëllim trajtimin e procesit intensiv dhe të kushtueshëm të marrjes së një lejeje ndërtimi, ky angazhim synon ta përkthejë aplikimin për leje në një platformë online duke shfrytëzuar komunikimin elektronik midis regjistrin aktual dhe regjistrimeve të institucioneve të tjera publike për të rigjetur të dhënat dhe për të evidentuar statusin e aplikimeve. Palët e interesuara e mirëpresin projektin por ngrenë shqetësime lidhur me zbatueshmërinë e tij në bashkitë që nuk kanë plane rregulluese për përdorimin e tokës. AKSHI dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) raportojnë se ky projekt është i plotë dhe është përdorur 25,000 herë nga qytetarët dhe bizneset. Ky angazhim nuk duhet të merret përpara pasi nuk ka lidhje me vlerat PQH.
12. Ngritja e sporteleve dixhitale • Lidhja me vlerën PQH: E paqartë	Për të përmirësuar aksesin e qytetarëve në portalin e-Albania dhe shërbimeve të tij, AKSHI u angazhua për instalimin e sporteleve (ose kioskave) dixhitale në të gjithë vendin, ku qytetarët do të jetë në gjendje të hyjnë në e-Albania në 24 orë në ditë për 7 ditë të javës. Pavarësisht qëllimit për rritjen e aksesit tek shërbimet

• Ndikimi i mundshëm: None • Zbatimi: Përfunduar	elektronike, thjesht vendosja e sporteleve në qendrat urbane nuk përmirëson aksesin për banorët e zonave rurale që nuk kanë akses në internet. Në vitin 2016 AKSHI raportoi se në të gjithë vendin ishin instaluar mbi 15 sportele ku ofroreshin 465 shërbime elektronike përmes portalit e-Albania. Qytetarët e intervistuar nga zonat e largëta ishin të informuar për sportelet dixhitale por nuk i kishin përdorur ato. Qeveria duhet të konsiderojë mundësinë e përhapjes së materialeve të dobishme nëpërmjet sporteleve dixhitale sesa të vazhdojë me këtë angazhim në planin e ardhshëm të veprimtimit të PQH-së.
13. Standardizimi i shërbimit të pasaportave • Lidhja me vlerën PQH: E paqartë • Ndikimi i mundshëm: I vogël • Zbatimi: Konsiderueshëm	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) synon të vijojë me reformën e shërbimit publik që standardizon 700 pasaporta shërbimi, duke ofruar informacione për të gjitha shërbimet publike. Ky angazhim është një detyrim ligjor rutinë dhe nuk ka lidhje me vlerat PQH. Në vitin 2016 ADISA njoftoi se janë përpunuar 548 pasaporta: ADISA është në rrugën e duhur për të arritur objektivin e 700 pasaportave të standardizuara të shërbimit deri në fund të vitit 2017. Ky angazhim nuk duhet të çohet më tej.
14. Kartela informative e qytetarit • Lidhja me vlerën PQH: E qartë • Ndikimi i mundshëm: I vogël • Zbatimi: Konsiderueshëm	Ky angazhim synon të sigurojë publikimin e rregullt të kartelës informative të qytetarit, një grafikë informative ku shpjegohen shërbimet elektronike që ofrohen nga portali e-Albania, siç kërkohet nga Ligji “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”. Në fund të vitit 2016, drafti i kartelës së qytetarit iu paraqit 18 institucioneve dhe në vitin 2017 MIAP organizoi konsultime në shkollat e mesme dhe me institucionet përgjegjëse. Pjesëmarrësit e fokus grupeve nuk ishin të informuar për këtë angazhim dhe, si përfundim, ky angazhim nuk duhet të çohet më tej.
15. Receta elektronike pilot • Lidhja me vlerën PQH: E paqartë • Ndikimi i mundshëm: I vogël • Zbatimi: I kufizuar	Ky angazhim lehtëson kalimin e recetave nga formati letër në një sistem kombëtar recetash elektronike, në mënyrë që të ulët numri i recetave të false, i gabimeve mes mjekëve dhe farmacistëve për zbatimin e recetave etj. Pavarësisht kësaj nisme ambicioze, ky angazhim është një hap i vogël që nuk trajton praktikën korruptive ose besimin e ulët të publikut tek sistemi i kujdesit shëndetësor. Sistemi i recetës elektronike u fillua në Tiranë në mars 2017 së bashku me një sërë materialesh udhëzuese. Edhe pse shumë pjesëmarrës të grupeve të fokusit e vlerësuan sistemin si një hap drejt përmirësimit të shërbimeve publike, disa shprehën skepticizëm në lidhje me rezultatet aktuale të këtij sistemi në luftën kundër korrupsionit në sistemin e kujdesit shëndetësor. Për të ardhmen, duhet të ndërmerren angazhime të mëtejshme që i sigurojnë akses publikut tek të dhënat dhe informacionet e tjera të mbledhura përmes sistemeve elektronike.
16. Sistemi i monitorimit elektronik të pyjeve • Lidhja me vlerën PQH: E paqartë • Ndikimi i mundshëm: I vogël • Zbatimi: Nuk ka nisur	Prerjet e paligjshme e pyjeve kanë kontribuar në degradimin e rëndë të pyjeve shqiptare dhe në Shqipëri nuk ka një sistem të kompjuterizuar për monitorimin dhe evidentimin e aktiviteteve të paligjshme dhe/ose zjarreve në pyje. Ky angazhim synon të krijojë një sistem për monitorimin elektronik të pyjeve, përfshirë këtu zbulimin e zjarrit në kohë reale, kamera monitorimi, shkëmbim informacioni në kohë reale dhe më shumë të tjera. Megjithatë, nuk është e qartë se si do të parandalojë drejtpërsëdrejti abuzimin dhe korrupsionin ky sistem i monitorimit elektronik. Nuk ka të dhëna që

	të tregojnë se ky angazhim ka filluar nga zbatimi. Për të ardhmen, ky angazhim duhet të riformulohet për të përfshirë shoqërinë civile dhe për të siguruar publikimin e rregullt të të dhënave për respektimin e ligjeve dhe rezultateve të tjera përkatëse.
17. Sistemi elektronik për aplikimet e licencave profesionale • Lidhja me vlerën PQH: E paqartë • Ndikimi i mundshëm: I vogël • Zbatimi: Konsiderueshëm	Korrupsioni në procesin e licencimit profesional minon sigurinë dhe verifikueshmërinë e profesionistëve në sektorë të tillë si ndërtimi dhe kujdesi shëndetësor. Ky angazhim synon të krijojë një shërbim online për aplikimet për licencime, për shkëmbimin e informacionit për të verifikuar statusin e aplikimit dhe për të përmirësuar kapacitetin e brendshëm për monitorimin e licencave. Ky angazhim nuk përcakton se si do të përmirësojë aksesin e publikut tek informacionet ose si do të ulë korrupsionin. Mundësia për aplikim për licencë individuale ofrohet në portalin e-Albania, por nuk ka të dhëna që të tregojnë se aktivitetet e tjera kanë përfunduar. Ky angazhim nuk duhet të vazhdohet në planin e ardhshëm të veprimit.

Rekomandime

Edhe pse është bërë progres në zbatimin e angazhimeve, plani aktual i veprimit nuk trajton prioritetet kryesore të aktorëve dhe disa angazhime nuk kanë lidhje të qartë me vlerat PQH. Një rekomandim kryesor është që qeveria të ndërmarrë angazhime ambicioze që janë në përputhje me procesin e anëtarësimit të vendit në Bashkimin Evropian (BE) dhe të prioritzojë angazhime të tilla si kontratat e hapura, deklarimi i pasurive të zyrtarëve publikë dhe zbatimi me efektivitet i ligjit për konsultimin publik.

Duke filluar që nga viti 2014, në të gjitha raportet MRP të PQH përfshihen pesë rekomandime kryesore për ciklin e ardhshëm të planit të veprimit PQH. Qeverive që marrin pjesë në PQH do t'u kërkohet të përgjigjen për këto rekomandime kryesore në vetë-vlerësimet e tyre vjetore. Këto rekomandime janë në përputhje me logjikën SMART – ato janë specifike, të matshme, të arritshme, relevante dhe me afat kohor. Duke pasur parasysh këto konstatime, hulumtuesi MRP paraqet rekomandimet kryesore si më poshtë:

Tabela 3: Pesë rekomandimet kryesore

Të sigurohet rinovimi i udhëheqjes dhe transferimi i njohurive institucionale mbi PQH
Të respektohen Standardet e Pjesëmarrjes dhe Bashkë-Krijimit të PQH
Të vihet fokusi tek angazhime ambicioze me lidhje me vlerat PQH për sa i përket kontratave të hapura në përputhje me kuadrin e anëtarësimit në BE
Të sigurohet zbatimi me efektivitet i legjislacionit për konsultimin publik
Të prioritzohet deklarimi i pasurive të zyrtarëve dhe aksesit i publikut tek regjistri i tokës

Kërkesat për pranim: Për të marrë pjesë në PQH qeveritë duhet të demonstrojnë angazhim për qeverisjen e hapur duke plotësuar kriteret minimale në dimensionet bazë të qeverisjes së hapur. Për të vlerësuar progresin e vendit në secilin prej dimensioneve përdoren tregues të hartuar nga palë të treta. Për më shumë informacion lexoni seksionin VII për kërkesat e pranimit, të dhënë në fund të këtij raporti ose vizitoni bit.ly/1929F1l.

Gjergji Vurmo është hulumtues i pavarur në Shqipëri. Ai ka një përvojë pune mbi 15-vjeçare me organizatat e sektorit të tretë në fushat e qeverisjes së mirë, integritetit evropian, zhvillimit të shoqërisë civile, dhe menaxhimit të organizatave. Ai është edhe Drejtor Programi në Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim, një organizatë joqeveritare me qendër në Tiranë.

Partneriteti i Qeverisë së Hapur (PQH) synon të sigurojë angazhime konkrete të qeverive për të promovuar transparencën, fuqizimin e qytetarëve, luftën kundër korrupsionit, dhe për të shfrytëzuar teknologjitë e reja për forcimin e qeverisjes. Mekanizmi i Raportimit të Pavarur (MRP) vlerëson hartimin dhe zbatimin e planeve kombëtare të veprimit për të nxitur dialogun mes aktorëve kryesorë dhe për të përmirësuar kërkesën e llogarisë.



I. Hyrje

Partneriteti për Qeverisje të Hapur (PQH) është një nismë vullnetare ndërkombëtare dhe me shumë partnerë, që synon të sigurojë ndërmarrjen e angazhimeve konkrete nga qeveritë për qytetarët e tyre me synim rritjen e transparencës, fuqizimin e qytetarëve, luftën kundër korrupsionit, dhe shfrytëzimin e teknologjive të reja për forcimin e qeverisjes. Në funksion të këtyre qëllimeve, PQH ofron një forum ndërkombëtar dialogu dhe ndarje përvojë mes qeverive, organizatave të shoqërisë civile (OSHC) dhe sektorit privat të cilët kontribuojnë në një përpjekje të përbashkët për qeverisje të hapur.

Shqipëria filloi zyrtarisht procesin e anëtarësimit në PQH në gusht të vitit 2011 kur Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit (MITIK) z. Genc Pollo shpalli synimin e qeverisë për anëtarësim.¹

Për të marrë pjesë në PQH qeveritë duhet të provojnë angazhimin e tyre për qeverisje të hapur duke përmbushur një sërë kriteresh (minimale) për performancën. Për të vlerësuar progresin e vendit në secilin prej dimensioneve përdoren tregues objektivë të hartuar nga palë të treta. Për më shumë informacion lexoni seksionin VII për Kërkesat e Pranimi për më shumë hollësi.

Të gjitha qeveritë pjesëmarrëse në PQH hartojnë plane kombëtare veprimi të PQH, të cilat të shtjellojnë angazhimet konkrete me qëllim ndryshimin e stadi aktual të periudhës fillestare prej dy vitesh. Angazhimet mund të bazohen tek përpjekjet aktuale, të identifikojnë hapa të reja për të përfunduar reformat e papërfunduara, ose të nxisin veprim në fusha krejtësisht të reja.

Shqipëria hartoi planin e saj të tretë kombëtar të veprimit gjatë periudhës mars-korrik 2016. Periudha e zbatimit të planit të veprimit në qershor ishte zyrtarisht 1 korrik 2016 deri në 31 korrik 2018. Raporti i këtij viti mbulon procesin e hartimit të planit të veprimit dhe vitin e parë të zbatimit, nga 1 korrik 2016 deri në 30 qershor 2017. Që nga viti 2015, MRP nisi botimin e raporteve përfundimtare për progresin e arritur në fund të çdo periudhe 2-vjeçare të planit të veprimit. Çdo aktivitet apo progres i arritur pas vitit të parë të zbatimit (30 qershor 2017) do të vlerësohet në raportin përfundimtar. Qeveria shqiptare nuk e ka publikuar vetëvlerësimin e saj për vitin e parë (1 korrik 2016 – 1 qershor 2017) të zbatimit të planit të veprimit PQH 2016 – 2018.

Në përmbushje të kërkesave të PQH, Mekanizmi i Raportimit të Pavarur (MRP) i PQH bashkëpunoi me z. Gjergji Vurmo nga Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim, i cili realizoi një vlerësim të hartimit dhe zbatimit të planit të tretë të veprimit të Shqipërisë. Për të marrë mendimin e aktorëve të ndryshëm, hulumtuesi MRP organizoi tre diskutime në fokus grupe me qytetarë të zakonshëm nga rajone të ndryshme të vendit dhe me karakteristika të ndryshme demografike si dhe një forum me aktorë nga shoqëria civile, bota akademike, dhe aktorë të tjerë të PQH në Tiranë, diskutim që u realizua sipas modelit të fokus grupeve. Deri në kohën kur u përpilua ky raport (tetor 2017), qeveria shqiptare nuk kishte publikuar asnjë raport vetëvlerësimi. Qëllimi i MRP është të informojë dialogun e vazhdueshëm mbi hartimin dhe zbatimin e angazhimeve të ardhshme në secilin vend pjesëmarrës në PQH. Metodatat dhe burimet shtjellohen në shtojcën metodologjike (Metodologjia dhe Burimet) të këtij raporti.

¹ <http://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/LOI%20Albania%201.png>

II. Konteksti

Që nga viti 2014, kur iu dha statusi i vendit kandidat nga Bashkimi Evropian (BE), Shqipëria vendi ka bërë përpara në zhvillimin e shoqërisë civile dhe në përpjekjet kundër korrupsionit. Megjithatë, PQH vazhdon të mos ketë vëmendjen e duhur nga institucionet përgjegjëse, duke penguar kështu zbatimin e angazhimeve. Fokusi i planit aktual të veprimit është lidhur kryesisht me reformat e qeverisjes elektronike dhe digjitalizimit, ndërkohë që nuk ka trajtuar çështje të rëndësishme që kanë nevojë për më shumë transparencë dhe llogaridhënie publike.

2.1 Konteksti bazë

Shqipëria është një vend në tranzicion ku janë ngritur institucionet bazë demokratike. Megjithatë, vendi karakterizohet edhe nga brishtësia dhe politizimi i lartë i strukturave të qeverisjes. Perspektiva e anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE) ka qenë një shtysë e madhe drejt reformave të zhvillimit dhe demokratizimit në vitet e fundit. Shqipëria mori statusin e vendit kandidatit në BE në vitin 2014 dhe që prej asaj kohe ka ndërmarrë një sërë reformash dhe ndryshimesh ligjore që synojnë forcimin e sundimit të ligjit dhe luftën kundër korrupsionit. Vendi ka bërë përmirësime të konsiderueshme në zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, zhvillimin e shoqërisë civile dhe përpjekjet kundër korrupsionit.

Një arritje e rëndësishme për transparencën ishte miratimi i Ligjit të ri “Për të drejtën e informimit” të vitit 2014, që zëvendësoi aktet e mëparshme ligjore për marrjen e informacionit. Ligji sanksionon krijimin e një organi të ri mbikëqyrës, jep përkufizimet për informacionin publik dhe autoritetet publike që janë subjekt i ligjit, shkurton afatet kohore për ofrimin e përgjigjeve për kërkesat për informacion, përcakton sanksionet për mosrespektimin e dispozitave ligjore dhe mospublikim paraprak të kategorive të caktuara të informacionit.¹ Edhe pse kuadri ligjor është i mirë dhe në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare, zbatimi i tij në praktikë mbetet problematik. Sipas një raporti të vitit 2016 nga Lëvizja MJAFIT, institucionet publike shqiptare iu përgjigjen kërkesave të informimit publik vetëm në 42 për qind të rasteve të përgjithshme. Nga 230 kërkesa për informacion të paraqitura nga kjo organizatë, janë marrë vetëm 98 përgjigje. Vetëm 80 përgjigje kishin informacionin e plotë që kërkohej nga organizata.²

Kushtetuta e Shqipërisë garanton liritë qytetare, përfshirë këtu lirinë e mbledhjes dhe shprehjes. Panorama e medias është e larmishme, me një gamë të gjerë mediash që mbulojnë proceset politike dhe shkeljet nga ana e qeverisë, përfshirë edhe rastet e abuzimit me postin publik. Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative (Balkan Investigative Reporting Network - BIRN), një burim investigativ në mbarë rajonin, ka siguruar informacion shumë të kërkuar të pavarur për disa raste korrupsioni politik të nivelit të lartë. Gjithsesi, shtypi në Shqipëri konsiderohet të jetë pjesërisht i lirë,³ pasi shumica e mediave janë të njëanshme në favor të njëres prej partive kryesore politike. Lidhjet mes politikës, biznesit dhe mediave kanë çuar në rritjen e vetëcensurimit të gazetarëve⁴. Edhe pse pronësia e mediave është formalisht transparente përmes Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, funksionimi i tregut të medias mbetet i errët dhe mungesa e transparencës së financimit të qeverisë përbën ende një shqetësim.⁵

Që nga koha e anëtarësimit në PQH, Shqipëria ka përmirësuar kuadrin e saj institucionale për funksionimin e shoqërisë civile dhe bashkëpunimi me qeverinë dhe organizatave joqeveritare është intensifikuar. Në nëntor 2016, Parlamenti miratoi një ligj për ngritjen e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile, një organ këshillimor që ka për detyrë të ndihmojë qeverinë në hartimin e politikave për zhvillimin e shoqërisë

civile. Përfaqësuesit e shoqërisë civile kanë vendet e tyre edhe në Këshillin Kombëtar për Integrimin Evropian, një strukturë për arritjen e konsensusit kombëtar për integrimin në BE⁶. Qeveria është konsultuar me shoqërinë civile për dokumente dhe reforma të rëndësishme strategjike, siç është strategjia anti-korrupsion (2015-20) dhe plani i veprimit (2015-17), si dhe reforma në gjyqësor. Megjithatë, ende nuk është e qartë se si dhe sa ndikojnë opinionet e OJQ-ve në vendimet përfundimtare politike. OJQ-të në Shqipëri kanë pasur vështirësi që lidhen me qëndrueshmërinë e tyre financiare, veçanërisht ato që varen nga grantet e donatorëve të huaj. Përveç kësaj, përpjekjet e politikanëve për të përfshirë përfaqësuesit e OJQ-ve në programet e partive politike kanë dëmtuar paanshmërinë e shoqërisë civile.⁷

Krahasuar me vitin e kaluar, Shqipëria ka bërë progres për sa i përket transparencës fiskale. Qeveria shqiptare aktualisht publikon shtatë nga tetë dokumentet kryesore të buxhetit në internet.⁸ Që nga Sondazhi për Buxhetin e Hapur në vitin 2015, Shqipëria ka publikuar Raportin e Fundvitit dhe Buxhetin e Qytetarëve.⁹

Në prill të vitit 2017 u miratua Ligji për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive. Ligji i ndryshuar zgjeron rrethin e zyrtarëve publikë që detyrohen të deklarojnë pasuritë, duke u shtrirë edhe tek anëtarët e gjyqësorit, këshillit të lartë të prokurorisë dhe drejtuesit e shoqërive të publike. Ligji i ndryshuar rrit edhe shpeshtësinë e kontrolleve të deklarimit të pasurisë. Deklaratat e deputetëve duhet të kontrollohen çdo dy vjet në vend të tre, dhe të gjithë zyrtarët për të cilët frekuenca specifike e kontrollit nuk mund të përcaktohet duhet të kontrollohet çdo pesë vjet në vend të shtatë. Ligji krijon sfida për ILDKPKI, agjencia përgjegjëse për kontrollin e deklaratave të pasurive, pasi operon me një sistem deklarimi të bazuar në letër dhe mbështetet në kërkesat me shkrim për institucionet e tjera për të marrë informacionin e nevojshëm për verifikim. Ligji i ri për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë ofron mundësinë e dorëzimit të deklaratave elektronike. Po ashtu, ligji i detyron institucionet përkatëse që t'i japin informacione ILDKPKI për verifikim përmes sistemit elektronik, i cili mundëson lidhjen dhe shkëmbimin e të dhënave që gjenden në regjistra ose në bazën elektronike të këtyre institucioneve. Ligji i ndryshuar përcakton se deklaratat janë dokumente zyrtare dhe janë subjekt i drejtës së informimit. Meqenëse baza ligjore për deklarimin e pasurive të zyrtarëve publikë ka qenë e paqartë, kjo dispozitë e re paraqet një ndryshim pozitiv.

Procesi i anëtarësimit në BE ka qenë motivi kryesor i reformave në fushat që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së qeverisë. Në vitin 2016, Komisioni Evropian vuri në dukje se qeveria shqiptare ka vazhduar të bëjë progres në përmbushjen e objektivave të përcaktuara në pesë prioritetet kyçe për hapjen e negociatave: reforma në gjyqësor, reforma në administratën publike, korrupsioni, krimi i organizuar dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut.¹⁰

Në dhjetor të vitit 2015, Parlamenti miratoi të ashtuquajturin ligj të dekriminalizimit, me anë të të cilit pengonte kriminelët e dënuar në kapjen e posteve publike, lëvizje që pritej të nxiste luftën kundër korrupsionit dhe të rivendoste besimin e publikut. Zbatimi i këtij ligji vazhdoi edhe vitin e kaluar, ndonëse rezultatet konkrete të tij u kufizuan për shkak të ritmit të ngadalshëm të procedurave gjyqësore të nisura nga subjektet e këtij ligji. Si rezultat i këtij ligji kanë humbur mandatin deputetë, kryetarë bashkish dhe zyrtarë të tjerë të zgjedhur. Në dhjetor 2016, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u hoqi mandatin dy deputetëve dhe një kryetari bashkie për fshehjen e dënimeve të tyre të mëparshme penale.¹¹

Sipas një raporti të vitit 2016 të Komisionit Evropian, reforma e madhe në gjyqësor bëri përparim të rëndësishëm me miratimin unanim nga Parlamenti të ndryshimeve në Kushtetutën e vendit¹². I ashtuquajturi Ligji i Vetting-ut, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", filloi zbatimin në mesin e vitit 2017 dhe Projektligji "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve që

luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar” pritet të luajë një rol historik në dhënien fund të kulturës së mosndëshkimit, në rritjen e përgjegjshmërisë publike dhe rikthimin e besimit të publikut tek gjyqësori dhe institucionet e tjera shtetërore, nëpërmjet krijimit të një strukture të veçantë të luftës kundër korrupsionit. Në legjislacionin e ri parashikohet të krijohen dy struktura të veçanta: Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit. Krijimi i këtyre strukturave do të bëhet me ngritjen e organeve të reja të gjyqësorit - Këshillit i Lartë i Prokurorisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor. Aktualisht në Shqipëri po zbatohet procesi i verifikimit për gjykatësit dhe prokurorët, me qëllim largimin e anëtarëve të gjyqësorit që kanë pasuri të pajustificueshme, të anëtarëve të korruptuar e me lidhje me të dyshuar të botës së krimit si dhe të anëtarëve të tjerë, të dhënat profesionale të të cilëve ngrenë shqetësime serioze. Zbatimi efektiv i këtyre ligjeve dhe rezultatet konkrete në këtë drejtim janë çelësi për hapjen e negociatave për anëtarësimin në BE.

Edhe pse renditja e Shqipërisë në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International pati një përmirësim të lehtë në 2016 (39 nga 100) në krahasim me vitin e kaluar (33 nga 100)¹³, korrupsioni vazhdon të mbetet një problem serioz, duke penguar përparimin drejt negociatave për anëtarësim në BE dhe duke penguar klimën e investimeve të vendit. Ndonëse në vend ekziston kuadri i nevojshëm ligjor anti-korrupsion, zbatimi i tij ka qenë joefektiv dhe përqindja e dënimeve është shumë e ulët.¹⁴ Raporti i vitit 2016 i KE-së për Shqipërinë vëren se gjatë vitit të kaluar është bërë përparim përmes miratimit të ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve, ligjit për krijimin e një organi të specializuar dhe të pavarur kundër korrupsionit dhe rritjen e aksesit tek regjistrat publikë elektronikë për prokurorët dhe punonjësit e policisë. Megjithatë, raporti përsërit se korrupsioni mbetet tejet i përhapur në shumë fusha dhe vazhdon të jetë një problem serioz.

Hartimi dhe miratimi i ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve ishte angazhim i planit të dytë të veprimit të Shqipërisë. Ligji hyri në fuqi në tetor 2016 për institucionet publike dhe u aplikua edhe për subjektet private më 1 korrik 2017. Deri më tani nuk ka pasur raste të regjistruara sipas këtij ligji. Për të lehtësuar zbatimin e legjislacionit të sapo miratuar, plani aktual i veprimit përmban një angazhim për zbatimin e Ligjit “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” me anë të miratimit të akteve nënligjore, konsultimit me aktorët e interesit, përmirësimit të kapaciteteve të mbikëqyrjes dhe rritjes së ndërgjegjësimit publik për sinjalizimin.

Sektorët e prokurimit dhe të ndërtimit janë më të prekurit nga rrjetet e patronazhit. Dihet që në procesin e dhënies së kontratave dhe licencave bëhen pagesa nën dorë dhe jepen ryshfete. Edhe favorizimi përbën problem në prokurime, pasi zyrtarët shpesh perceptohen se favorizojnë kompani dhe individë me lidhje të forta. Sipas Deklaratës së Klimës së Investimeve 2015 (ICS), kompanitë në Shqipëri përballen me procese jo-transparente kur konkurrojnë për tenderë publikë (p.sh. specifikimet teknike “të fiksuara”), të cilat bëjnë të përjashtohen ofertuesit e mundshëm. Shqipëria tani ka një platformë të detyrueshme të prokurimit elektronik dhe Agjencia e Prokurimit Publik publikon edhe një listë të kompanive që kanë bërë shkelje gjatë prokurimit. Megjithatë, në praktikë, kompanitë e përfshira në korrupsion nuk ndalohen në mënyrë efektive që të mos dorëzojnë ofertat për prokurimet e ardhshme.¹⁵ Plan i veprimit i trajton këto rreziqe korrupsioni në prokurimin publik nëpërmjet një angazhimi për institucionalizimin e kontratave të hapura, por progresi në këtë drejtim ka qenë i kufizuar.

Zgjedhjet e përgjithshme ishin një ngjarje e madhe politike në vitin 2017. Pretendimet e opozitës politike për përdorimin e parave të trafikut të drogës për blerjen e zgjedhjeve çuan në një ngërç tremujor, nga shkurti në qershor 2017, dhe në bojkot të Parlamentit nga Partia Demokratike tashmë në opozitë.¹⁶ Mes qeverisë dhe udhëheqësve të opozitës u arrit një konsensus i minutës së fundit, i cili i hapi rrugën pjesëmarrjes së opozitës në zgjedhjet parlamentare, të cilat u shtynë me një javë,

nga 18 qershori në 25 qershor. Sidoqoftë, ende nuk është bërë ndonjë progres i konsiderueshëm për të trajtuar shqetësimet që lidhen me transparencën dhe kontrollin e financimit të partive politike.

Edhe pse shoqëria civile u përfshi aktivisht në mbrojtjen e ndryshimeve kushtetuese për reformën në drejtësi (korrik 2016) dhe krijimin e presionit mbi partitë politike për miratimin e këtyre ndryshimeve dhe të ligjeve kryesore për zbatimin e reformës (tetor-dhjetor 2016), debatet e nxehta politike dhe kërcënimet e opozitës për bojkotim të zgjedhjeve të përgjithshme dobësuan aftësinë e OSHC-ve për mbrojtjen efikase të këtyre çështjeve.

Në Shqipëri PQH mbetet një temë e panjohur për shumë institucione shtetërore dhe jo-shtetërore, veçanërisht në nivel vendor si dhe për publikun në përgjithësi. Në periudhën e parë të planit aktual të veprimit (2016-2017), pak institucione të pushtetit vendor kanë treguar se e kanë kuptuar mirë PQH. Po ashtu, shumë pak institucione kanë përdorur përvojat e PQH-së. Edhe kur e kanë bërë këtë gjë, shpesh kjo është bërë me mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë dhe OSHC-ve vendase (UNDP, Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, Co-PLAN). Për shembull, Bashkia e Tiranës krijoi një portal të hapur të të dhënave¹⁷ për shërbimet komunale me mbështetjen e PNUD-it. Po në këtë linjë, një projekt i zbatuar nga Co-PLAN ka krijuar një portal të të dhënave të hapura¹⁸ për buxhetet e njësive të qeverisjes vendore.

2.2 Objekti i Planit të Veprimit në lidhje me Kontekstin Kombëtar

Plani aktual i veprimit përfshin disa angazhime të rëndësishme që lidhen me aksesin tek informacioni dhe konsultimet publike. Angazhimet për zbatimin e ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe kontratat e hapura publike kanë rëndësi të veçantë në përpjekjet për luftën kundër korrupsionit. Megjithatë, plani aktual i veprimit i vë theks të veçantë reformave të qeverisjes elektronike dhe dixhitalizimit. Disa angazhime në planin aktual të veprimit, përfshirë këtu ngritjen e sporteleve dixhitale (Angazhimi 12) dhe regjistrimi i recetave elektronike (Angazhimi 15), janë pjesë e reformave më të mëdha për të zgjeruar dhe përmirësuar qeverisjen elektronike. Ndonëse këto angazhime janë të rëndësishme dhe efektive për ofrimin e shërbimeve publike për qytetarët, ato nuk po kontribuojnë në hapjen e qeverisë për të mundësuar më shumë mendime dhe sugjerime nga ana e qytetarëve ose për rritjen e kërkesës së llogarisë ndaj zyrtarëve publikë.

Angazhimet në planin aktual të veprimit të PQH-së nuk kapin ashtu siç duhet përparësitë e Shqipërisë për anëtarësim në BE. Për të hapur bisedimet e procesit të anëtarësimit në BE, Shqipëria duhet të përmbushë pesë prioritetet kryesore: anti-korrupsionin, luftën kundër krimit të organizuar, reformën në administratën publike, reformën në gjyqësor dhe të drejtat e njeriut. Shqipëria miratoi ndryshime të rëndësishme kushtetuese në 2016, duke i hapur rrugën reformën më të madhe në gjyqësor dhe në luftën kundër korrupsionit, të cilat përfaqësojnë përparësitë kryesore të anëtarësimit të vendit në BE. Reforma në drejtësi mbetet çelësi i shtetit ligjor dhe mund të bëhet transformues edhe për fushat e qeverisjes (së hapur), llogaridhënies dhe integritetit. Lufta kundër korrupsionit, mosndëshkimit dhe si dhe reforma në drejtësi mbeten prioriteti themelor për shoqërinë civile, donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë të Shqipërisë. Angazhimi 9 - ose "Zbatimi i Ligjit "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", ngritja e kapaciteteve, ndryshimet dhe aktet nënligjore të këtij ligji" janë një angazhim shumë specifik dhe transformues që mbulon zbatimin e ligjit, rritjen e ndërgjegjësimin, konsultimin dhe trajnimin e personelit përkatës. Gjithsesi, përveçse në këtë angazhim, plani i tanishëm i veprimit nuk trajton më ndonjë nga çështjet e përmendura më sipër.

Së fundmi, çështje të tjera që nuk kanë qenë pjesë e planit të veprimit janë edhe financimi i partive politike dhe nismat për të dhënat e hapura. Zgjedhjet e fundit risollën në vëmendje edhe një herë se reforma zgjedhore dhe transparenca e financimit të partive politike kërkojnë një fokus më të madh në periudhën e ardhshme. Deri tani këto tematika nuk janë përfshirë në asnjë prej planeve të veprimit të PQH (2012-2018). Përveç kësaj, pavarësisht disa përvojave modeste të përdoruesve që hyjnë në portalin e të dhënave të hapura të Bashkisë së Tiranës, të dhënat e hapura në Shqipëri ende mbeten të pazhvilluara. Duhet bërë më shumë përpjekje për t'i dhënë një shtysë agjendës së PQH-së në vend.

¹ IDFI, Ligji i ri për të drejtën e informimit në Shqipëri (New Right to Information Law in Albania), <https://idfi.ge/en/new%E2%80%93freedom%E2%80%93of%E2%80%93information%E2%80%93legislation%E2%80%93albania>

² Balkan Insight, Institucionet shqiptare dështojnë në testin e transparencës, <http://www.balkaninsight.com/en/article/albanian-institutions-difficulties-in-doing-transparency-07-11-2016>

³ Raporti i lirisë së shtypit, <https://freedomhouse.org/report/freedom-press/freedom-press-2017>

⁴ Raporti Kombëtar në Tranzicion, 2016

⁵ Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2016, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf

⁶ Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian, https://www.parlament.al/wp-content/uploads/sites/4/2015/10/perberja_e_k-shillit_komb-tar_t-integrimin_europian_copy_1.pdf

⁷ Bertelsmann Transformation Index 2016, Albania Country Report, https://www.bti-project.org/fileadmin/files/BTI/Downloads/Reports/2016/pdf/BTI_2016_Albania.pdf

⁸ <http://survey.internationalbudget.org/#profile/AL>

⁹ <http://survey.internationalbudget.org/#availability>

¹⁰ Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2016, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf

¹¹ Shih Shqipëria 2017, Raporti Kombëtar në Tranzicion, Freedom House, <https://freedomhouse.org/report/nations-transit/2017/albania>

¹² Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2016, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf

¹³ Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit 2016, https://www.transparency.org/news/feature/corruption_perceptions_index_2016

¹⁴ Business Anti-Corruption Portal, Albania, <http://www.business-anti-corruption.com/country-profiles/albania>

¹⁵ Business Anti-Corruption Portal, Albania, <http://www.business-anti-corruption.com/country-profiles/albania>

¹⁶ Reuters, <https://www.reuters.com/article/us-eu-albania-protests/albanian-opposition-to-boycott-parliament-defying-eu-appeal-idUSKBN1612GL>

¹⁷ Bashkia Tiranë, <http://opendata.tirana.al/>

¹⁸ Co-PLAN, <http://www.financatvendore.al/>

III. Udhëheqja dhe Procesi me Shumë Aktorë

Qeveria dhe OSHC-të punuan bashkërisht për ngritjen e OpenAlb si forum i shumë aktorëve të përfshirë, i cili shërbente si qendër kryesore konsultimi për hartimin e planit të veprimit dhe rritjen e ndërgjegjësimit. Megjithatë, në mungesë të një buxhet nga shteti dhe të burimeve njerëzore për PQH, konsultimet nuk u zhvilluan me të njëjtin ritëm (cilësi dhe sasi) në nivel kombëtar, ashtu siç u realizuan në kryeqytet përmes OpenAlb. Bashkëpunimi midis shoqërisë civile dhe qeverisë gjatë zbatimit të planit të veprimit mungonte pothuajse tërësisht, me përjashtim të një aktiviteti të organizuar bashkërisht përmes OpenAlb

3.1 Udhëheqja

Në këtë nënseksion përshkruhet udhëheqja e PQH dhe konteksti institucional për PQH në Shqipëri. Në Tabelën 3.1 jepet një përmbledhje e kësaj strukture, ndërkohë që në pjesën e përshkrimit (më poshtë) jepen hollësi të mëtejshme.

Tabela 3.1: Udhëheqja PQH

1. Struktura	Po	Jo
A ka një person kontakti të përcaktuar pikërisht për PQH (individi)?	✓	
	E përbashkët	E vetme
A ka një agjenci të vetme që udhëheq përpjekjet PQH?		✓
	Po	Jo
A është kreu i qeverisë ai që udhëheq nismën PQH?		X
2. Mandati ligjor	Po	Jo
A është vendosur angazhimi i qeverisë për PQH nëpërmjet një mandati zyrtar që është bërë i njohur publikisht?	✓	
A është vendosur angazhimi i qeverisë për PQH nëpërmjet një mandati që është detyrim ligjor?	✓	
3. Vazhdimësia dhe paqëndrueshmëria	Po	Jo
A ka pasuri ndryshime në organizatën që drejtonte apo ishte e përfshirë në nismat PQH gjatë ciklit të zbatimit të planit të veprimit?	✓	
A është ndërruar kreu i ekzekutivit gjatë ciklit të planit të veprimit PQH?		X

Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike (MIAP) është zyra kryesore përgjegjëse për angazhimet e Shqipërisë në PQH. Megjithatë, MIAP nuk ka fuqi ligjore për të detyruar zbatimin e ndryshimeve të politikave tek agjencitë e tjera brenda qeverisë. (Shih Tabela 1.1 mbi udhëheqjen dhe mandatin e PQH në Shqipëri). Që nga shtatori 2013, kur MIAP u caktua të ishte Koordinator Kombëtar i PQH për Shqipërinë, mandati i tij ka qenë kryesisht koordinimi i procesit të PQH, por nuk ka asnjë autoritet për të detyruar institucionet shtetërore të ndërmarrin dhe realizojë zbatimin e angazhimeve. Si rezultat i mandatit të kufizuar, plani i veprimit

është tejet i orientuar tek angazhimet e udhëhequra nga ekzekutivi për transparencën, TIK dhe shërbimet publike dhe vetëm me përjashtime përfshin angazhime nga institucionet e tjera jashtë degës së ekzekutivit.

Kufizime të tjera për mandatin dhe performancën e MIAP burojnë nga fakti se MIAP ka burime të kufizuara njerëzore dhe financiare. Financimi i Ministrisë së Shtetit planifikohet me buxhetin e Kryeministrit. Aktualisht janë dy punonjës të MIAP që merren me koordinimin dhe zbatimin e planit të veprimit të PQH-së, që punojnë kryesisht me kohë të pjesshme. Për më tepër, MIAP nuk ka buxhet të dedikuar për aktivitetet e koordinimit të PQH, ndaj edhe bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile ka qenë mjaft i rëndësishëm për trajtimin e mungesës së financimit nga ana e qeverisë.

Bazuar në Urdhër të Kryeministrit, Nr. 37 (5 shkurt 2015) MIAP krijoi Grupin Teknik të Punës (GTP) me përfaqësues (d.m.th., ekspertë, specialistë, drejtorë) të propozuar nga secili institucion pjesëmarrës. Ky grup vepron si mekanizëm bashkërendimi mes agjencive. Në planin e mëparshëm të veprimit si dhe në atë aktual, shoqëria civile nuk ka qenë pjesë e këtij organi, edhe pse Urdhri i Kryeministrit përcakton se përfaqësues nga shoqëria civile mund të marrin pjesë në takimet e GNP. Sekretariati Teknik, i përbërë nga përfaqësues të MIAP dhe AKSHI-t, ka ofruar mbështetje teknike për Grupin Ndërmarrës të Punës për PQH.

Në përgjigje të rekomandimit të MRP për nevojën e përfshirjes së shoqërisë civile në procesin PQH, në mars të vitit 2016 u krijua një forum me shumë aktorë – OpenAlb – ku bëhen bashkë përfaqësues të shoqërisë civile dhe të qeverisë. Ky forum ka luajtur një rol të rëndësishëm në hartimin e planit të veprimit PQH 2016-2018. Në seksionin 3.2 përshkruhen veprimtaritë e institucioneve të qeverisë në forumin shumëpalësh OpenAlb.

Urdhri nr. 37 (2015) i Kryeministrit parashtrohet rregullat për koordinimin e procesit të PQH në Shqipëri. Megjithatë, qeveria dhe agjencitë e tjera shtetërore nuk janë të detyruara ligjërisht të ndërmarrin angazhime.

Është me rëndësi të theksohet se Shqipëria është një demokraci parlamentare ku autoritetet e qeverisjes vendore gëzojnë autonomi të konsiderueshme. Prandaj, qeveria e nivelit kombëtar nuk ka “kërbaçin” për të detyruar autoritetet vendore të ndërmarrin angazhime PQH ose t’u kërkojë llogari atyre për nivelin e zbatimit të këtyre angazhimeve. Edhe pse PQH është proces i hapur në Shqipëri, pak bashki kanë treguar interes për të dhe kanë marrë pjesë në hartimin e planit të veprimit të PQH-së, kryesisht nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit, trajnimit dhe informimit të aktiviteteve të OShC-ve (shih Seksionin II “Hartimi i Planit të Veprimit”).

Në fund, ndryshe nga hartimi i planit të veprimit, zbatimi i tij u ndikua nga zgjedhjet e përgjithshme parlamentare që u zhvilluan në qershor 2017. Në kohën e përpilimit të këtij raporti (tetor 2017), qeveria e re, e cila mori detyrën në shtator 2017, nuk e ka bërë ende të qartë se kush do të jetë Koordinator i ri Kombëtar i PQH-së në Shqipëri. MIAP, zyra drejtuese para zgjedhjeve të përgjithshme, nuk ekziston më në kabinetin e ri. Po ashtu, mbetet e paqartë se cilat kompetenca do të marrin strukturat e reja koordinuese të PQH-së.

3.2 Pjesëmarrja ndërqeveritare

Në këtë nënseksion evidentohet se cila institucione shtetërore u përfshinë në faza të ndryshme të PQH-së. Në seksionin tjetër do të përshkruan organizatat që u përfshinë në PQH.

Tabela 3.2 Pjesëmarrja në PQH nga institucionet e qeverisë

Si morën pjesë institucionet?	Ministritë, Drejtoritë, dhe Agjencitë	Legjislativi	Gjyqësori (përfshirë edhe agjencitë pothuajse gjyqësore)	Të tjera (përfshirë organet kushtetuese të pavarura apo autonome)	Qeveritë vendore dhe qarqet
Konsultim: Këto institucione vëzhguan ose u ftuan të vëzhgonin planin e veprimit, por nuk mund të jenë përgjegjës për angazhimet në planin e veprimit.	26 ¹	0	0	1 ²	2 ³
Propozim: Këto institucione propozuan angazhime për përfshirje në planin e veprimit.	14 ⁴	0	0	1 ⁵	0
Zbatim: Këto institucione janë përgjegjëse për zbatimin e angazhimeve në planin e veprimit edhe nëse ata i propozuan angazhimet ose jo.	17 ⁶	0	0	1 ⁷	0

Në Shqipëri, pjesëmarrja në PQH u kufizua tek agjencitë e qeverisë qendrore (ku MIAP, AKSHI, Ministria e Brendshme dhe MSHÇV qenë më aktivët) dhe një institucion i pavarur (Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale). Edhe pse Shqipëria po zbaton një reformë të madhe gjyqësore, asnjë institucion gjyqësor, as Parlamenti, nuk morën pjesë në procesin e hartimit të planit të veprimit të PQH. Rrjedhimisht, plani aktual i veprimit fokusohet

kryesisht në aktivitetet e ndërmarra nga dega ekzekutive, përfshirë këtu edhe modernizimin e shërbimeve qeveritare. Plani i veprimit nuk përfshin ndonjë angazhim lidhur me gjyqësorin ose parlamentin. Në Tabelën 1.2 më lart jepen detaje se cilat institucione u përfshinë në faza të ndryshme të PQH.

Organizatat e Shoqërisë Civile që morën pjesë në Forumin OpenAlb⁸, një organizëm shumëpalëshe ku bëhen bashkë shoqëria civile dhe përfaqësuesit e qeverisë të përfshirë në procesin e PQH, luajtën një rol të rëndësishme në përfshirjen e autoriteteve të qeverisjes vendore në këtë proces (më konkretisht Bashkinë e Shkodrës dhe atë e Fierit). OpenAlb u iniciua nga OJQ-të, që ishin pjesë e Koalicionit të OSHC-ve për PQH Shqipëri, një strukturë qytetare e ngritur nga vetë organizatat. Edhe pse asnjë qeveri vendore nuk ka propozuar ndonjë angazhim PQH, InfoCip, një organizatë e shoqërisë civile propozoi një angazhim për të publikuar legjislacionin e qeverisë vendore dhe qendrore në sistemet e hapura dhe falas.

Qeveria dhe shoqëria civile kanë bashkëpunuar ngushtë në hartimin e planit të veprimit të PQH. MIAP, në bashkëpunim me Forumin OpenAlb, ftoi përfaqësues të agjencive qeveritare dhe institucioneve të tjera të pavarura për të propozuar angazhimet e tyre. Forumi i OpenAlb shërbeu si një platformë për konsultim të institucioneve të ndryshme në hartimin e planit të veprimit⁹. Rol të rëndësishëm pati ekspertiza e shoqërisë civile për të ndihmuar Qeverinë të hartonte angazhimet përkatëse për PQH. Megjithatë, MIAP kishte fjalën e fundit në miratimin e planit të veprimit, në të cilin u përfshinë 17 nga gjithsej 42 angazhime specifike, që u diskutuan në forumin shumëpalës të OpenAlb gjatë muajve prillit-qershor 2016, duke përfshirë vetëm katër angazhime të propozuara nga OShC. Zyrtarët e MIAP dhe përfaqësuesit e Forumit OpenAlb shpjeguan se një zgjedhje e tillë u bë për dy arsye kryesore: së pari, disa nga angazhimet e propozuara nuk plotësuan kriteret e lidhjes me PQH dhe, së dyti, qeveria duhej të bënte zgjedhje më realiste nga pikëpamja e zbatimit.¹⁰

Ndryshe nga faza e hartimit të planit të veprimit, forumi i OpenAlb ishte më pak aktiv në monitorimin e zbatimit të planit të veprimit të PQH-së dhe nuk u zhvilluan takime të tjera. OShC-të që marrin pjesë në Forumin OpenAlb kanë luajtur një rol të rëndësishëm në promovimin dhe zhvillimin e kapaciteteve tek njësitë e qeverisjes vendore dhe shoqërisë civile jashtë Tiranës në lidhje me zbatimin e PQH.¹¹ OpenAlb organizoi vetëm një aktivitet, më 22 nëntor 2016, për të diskutuar mësimet e nxjerra në lidhje me PQH në 2016, forumin shumëpalës dhe sfidat përpara.¹²

3.3 Angazhimi i shoqërisë civile

Vendet që marrin pjesë në PQH përmbushin një sërë kërkesash për konsultime gjatë hartimit, zbatimit dhe rishikimit të planit të veprimit të PQH. Në Tabelën 3.3 jepet një përmbledhje e punës së Shqipërisë gjatë vitit të parë (2016-2017) të zbatimit të planit të veprimit 2016-2018

Tabela 3.3: Procesi kombëtar PQH

Hapat kryesorë të ndjekur: 5 nga 7						
Para	1. Afati dhe disponueshmëria e procesit			2. Njoftimi paraprak		
	Afati dhe disponueshmëria e procesit ishin online para konsultimit	Po	Jo	Njoftimi paraprak i konsultimit	Po	Jo
		✓			✓	
	3. Rritja e ndërgjegjësimit			4. Kanale të shumta komunikimi		

	Qeveria realizoi aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit	Po	Jo	4a. Konsultime Online:	Po	Jo
		✓			✓	
				4b. Konsultime me persona:	Po	Jo
					✓	
	5. Dokumentimi & Komentet					
	U bë një përmbledhje e komenteve				Po	Jo
Gjatë	6. Forumi i rregullt shumëpalësh					
	6a. A u ngrit një forum?	Po	Jo	6b. A u mblodh rregullisht?	Po	Jo
		✓				X
Pas	7. Raporti i vetëvlerësimit i qeverisë					
	7a. A u publikua raporti i vetëvlerësimit vjetor?	Po	Jo	7b. A është i disponueshëm raporti në anglisht dhe gjuhën administrative?	Po	Jo
			X			X
	7c. A pati një periudhë 2-javore për komente?	Po	Jo	7d. A i përgjigjet raporti rekomandimeve kryesore të MRP-së?	Po	Jo
			X			X

Tabela 3.4: Niveli i ndikimit të publikut

MRP ka përshtatur “Spektrin e Pjesëmarrjes” të Shoqatës Ndërkombëtare për Pjesëmarrje Publike (IAP2) për të aplikuar PQH-në.¹³ Ky spektër tregon nivelin e mundshëm të ndikimit publik në përmbajtjen e planit të veprimit. Në frymën e PQH, shumë vende synojnë të kapin nivelin “bashkëpunim”.

Niveli i ndikimit të publikut		Gjatë hartimit të planit të veprimit	Gjatë zbatimit të planit të veprimit
Fuqizim	Qeveria i jep kompetenca vendimmarrjeje anëtarëve të publikut		
Bashkëpunim	Ka pasur dialogu të vazhdueshëm DHE publiku ndihmoi në përcaktimin e agjendës	✓	
Përfshirje	Publiku mund të jepte opinionin e tij për trajtimin e angazhimeve		
Konsultim	Publiku mund të jepte opinionin e tij.		
Informim	Qeveria i dha publikut informacion për planin e veprimit .		✓
Pa konsultim	Pa konsultim		

Zyrtarët e MIAP dhe Koalicioni i OSHC-ve për PQH Shqipëri¹⁴ (përfaqësuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), Lëvizja MJAF!, REC Albania dhe AIS) zhvilluan disa takime në fillim të vitit 2016 për të koordinuar hapat e ardhshëm në hartimin e planit të veprimit. Më 23 mars 2016, Koalicioni i OSHC-ve për PQH Shqipëri dhe përfaqësues të tjerë të shoqërisë civile dhe institucioneve qeveritare u mbledhën për të krijuar Forumin OpenAlb në kuadër të një projekti të IDM-së të financuar nga Ambasada Amerikane në Tiranë. Nga 200 OSHC të ftuar në aktivitetin e njoftuar publikisht, morën pjesë rreth 45 pjesëmarrës, përfshirë këtu institucionet shtetërore dhe përfaqësues të OSHC-ve, të cilët diskutuan formatin dhe angazhimet e mundshme për t'u përfshirë në planin e veprimit. Po ashtu, ata ranë dakord bashkërisht për një afat kohor (mars-qershor 2016) dhe për qasjen e përgjithshme për hapat e ardhshëm, përfshirë edhe hartimin dhe konsultimin e angazhimeve me palët e interesuara, publikimin online dhe miratimin përfundimtar. Afati i procesit të rënë dakord u publikua në faqen e internetit të OpenAlb (www.openalb.net) dhe u shpërnda gjerësisht përmes listave të postës dhe mediave sociale (nga OSHC-të dhe zyrtarët e MIAP-it). Aktiviteti ku u bë takimi i parë i Forumit OpenAlb shërbeu edhe për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për PQH-në.¹⁵

Nga një projekt i IDM-së u organizuan dy seminare me rreth 25 përfaqësues të qeverisë qendrore dhe shoqërisë civile në Tiranë në prill 2016 për të ndihmuar palët e interesuara të kuptojnë më mirë bashkë-krijimit të planit të veprimit të PQH. Deri në fund të prillit 2016, nga agjencitë qeveritare dhe OSHC-të u propozuan gjithsej 42 angazhime bazuar në modelin e zhvilluar nga IDM dhe që më pas u botuan për komente publike në faqen e internetit të OpenAlb. Përveç katër angazhimeve të OSHC-ve të përfshira në planin e veprimit, Qeveria mori në konsideratë sugjerimet e OSHC-ve për të përmirësuar disa nga angazhimet e propozuara nga qeveria. Nuk u bënë komente publike në faqen e internetit deri në kohën e miratimit të planit të veprimit në korrik 2016.¹⁶

Grupet e përbashkëta të punës të përbëra nga OSHC-të, ministritë përkatëse të qeverisë dhe agjencitë e tjera diskutuan secilin nga angazhimet e propozuara gjatë takimeve të shumta të mbajtura gjatë periudhës prill-qershor 2016.¹⁷ Në këto grupe pune u përfshinë OJQ-të pjesëmarrëse në OpenAlb dhe ato që nuk ishin pjesë e OpenAlb në atë kohë. Diskutimet e grupeve të punës ishin shumë konstruktive. Pjesëmarrësit në këto takime të realizuara në ambientet e MIAP-it ishin kryesisht anëtarë të Koalicionit të OSHC-ve me qendër në Tiranë dhe përfaqësues të ministrive të linjës, të cilët propozuan angazhime për planin e ri të veprimit. OSHC-të në rrethe të tjera të vendit mund të dërgonin komentet e tyre përmes postës elektronike, edhe pse disa prej tyre kishin marrë pjesë më herët në takimin e muajit mars 2016.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile bënë sugjerime për t'u mundësuar angazhimeve lidhje më të fortë me PQH dhe për të reflektuar në to sfidat dhe shqetësimet kryesore për Shqipërinë. Disa nga këto sugjerime u morën parasysh nga Qeveria në planin final të veprimit. Përfaqësuesit e institucioneve shtetërore ishin të hapur për sugjerime, por nga ana tjetër tërhoqën vëmendjen për nevojën për të pasur një plan veprimi sa më realist. Ekspertët e IDM-së bënë një vlerësim të 42 angazhimeve të propozuara dhe i ofruan MIAP-it një sërë rekomandimesh për të përmirësuar më tej planin e veprimit. Sidoqoftë, Qeveria Shqiptare bëri zgjedhjen e vet të angazhimeve që do të përfshiheshin në planin final të veprimit.

Edhe pse projekt angazhimet u publikuan në internet dhe u shpërndanë në më shumë se 200 OSHC në të gjithë vendin që nga muaji prill i vitit 2016, numri i përgjithshëm i OSHC-ve aktive që ofruan komente deri në korrik 2016 ishte i kufizuar në rreth 15 organizata. Qeveria nuk iu përgjigj komenteve të OSHC-ve nëse u morën parasysh apo jo propozimet e tyre. Në anën e aktorëve shtetërorë, rreth 30

institucione (qeveria qendrore dhe pak institucione të pavarura) morën pjesë aktive në hartimin e planit të veprimit.

Edhe pse disa OShC theksuan nevojën për përfshirjen e institucioneve nga degë të tjera të pushtetit (legjislativ, gjyqësor) dhe nga sektori privat, asnjë aktor i tillë nuk u përfshi deri në fund të periudhës së hartimit të planit të veprimit. Një mangësi tjetër e procesit, që ka ndikuar në cilësinë e konsultimit, është se MIAP nuk ndërmori ndonjë aktivitet ndërgjegjësimi apo konsultimi jashtë kryeqytetit. U organizuan vetëm disa takime ndërgjegjëse me shoqërinë civile dhe përfaqësues të qeverisjes vendore nga disa anëtarë të shoqërisë civile të forumit OpenAlb. Këto aktivitete u mbuluan nga mediat lokale.¹⁸

3.4 Konsultime gjatë zbatimit

Si pjesë e pjesëmarrjes së tyre në PQH, qeveritë angazhohen të identifikojnë një forum për të mundësuar konsultime të rregullta shumëpalëshe për zbatimin e phq-së. Ky organizëm mund të jetë ekzistues ose i ngritur rishtazi. Në këtë pjesë jept një përmbledhje e këtij informacioni.

Qeveria shqiptare dhe organizatat e shoqërisë civile punuan së bashku për të krijuar forumin OpenAlb si një si një organizëm shumëpalësh për një proces PQH me pjesëmarrje. Ashtu si në planin e mëparshëm të veprimit, shoqëria civile përmes forumit OpenAlb luajti një rol vendimtar në fazën e hartimit të tij. Megjithatë, ashtu si përvoja e planit të veprimit 2014-2016, shoqëria civile dhe MIAP nuk kanë punuar bashkërisht ose diskutuar rregullisht për zbatimin e planit të veprimit gjatë periudhës korrik 2016 - qershor 2017. Rrjedhimisht, Forumi OpenAlb dështoi në përmbushjen pjesës së dytë të objektivit për të vepruar si një forum i përbashkët i qeverisë dhe përfaqësuesve të OSHC-ve për monitorimin e ecures së zbatimit të planit të veprimit dhe vlerësimin e performancës së institucioneve përgjegjëse.

Gjatë periudhës së raportimit për zbatimin e planit të veprimit, ka pasur vetëm një takim më 22 nëntor 2016 të forumit OpenAlb, i cili mori formën e një aktiviteti publik me pjesëmarrje të gjerë nga OSHC-të dhe përfaqësues të institucioneve qeveritare.¹⁹ Zyrtarët e MIAP-it i raportuan hulumtuesit të MRP se informimi publik dhe konsultimi me shoqërinë civile kanë ndodhur gjatë zbatimit të planit të veprimit. Megjithatë, nuk u ofrua asnjë dëshmi për të mbështetur këtë deklaratë, përveç një liste të postimeve në mediat sociale dhe lajmet nga faqja e MIAP për ngjarje të ndryshme publike, të cilat nuk kualifikohen si “konsultime periodike me OSHC-të për ecurinë e zbatimit të planit të veprimit”.²⁰ Përfaqësuesit e OSHC-ve të intervistuar nga hulumtuesi i MRP konfirmojnë se MIAP nuk ka bërë konsultime të rregullta gjatë zbatimit të planit të veprimit.

Forumit shumëpalësh OpenAlb nuk ka ndonjë procedura e rregullore zyrtare për funksionimin, anëtarësimin, koordinimin dhe raportimin. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) ishte koordinator deri në nëntor 2016, kohë pas të cilit OpenAlb u bë pasiv. Nga vëzhgimi i diskutimeve nga hulumtuesi i MRP-së në fillim të vitit 2016 mes MIAP dhe Koalicionit të OSHC për PQH Shqipëri doli në pah se një zgjedhje e tillë ishte bërë qëllimisht nga OSHC-të në mënyrë që të lehtësonte lidhjen e OSHC-ve me Forumin OpenAlb dhe pjesëmarrjen në të. Megjithatë, kjo solli si rezultat pasivitetin e aktorëve të shoqërisë civile gjatë zbatimit të planit të veprimit, siç ishte rasti në periudhën PQH 2014-2016.

Përfaqësuesit e MIAP-it sugjeruan se Qeveria ka qenë e hapur dhe shumë e përgjegjshme me kontakte dhe shkëmbime informacioni për PQH me anëtarë të interesuar apo aktivë të forumit OpenAlb si IDM, AIS, InfoCip ose Lëvizja Mjaft. Përfaqësuesit e shoqërisë civile pranojnë se ata duhet të ishin më proaktive për të organizuar takime të rregullta të Forumit OpenAlb gjatë zbatimit të planit të veprimit. Megjithatë, edhe OSHC-të sugjerojnë që shoqëria civile është e mbingarkuar me projekte të tjera të advokimit që kanë të bëjnë me reforma të rëndësishme që po

ndërmerren në vend (p.sh., reforma në drejtësi gjatë vitit 2016, afrimi i zgjedhjeve të përgjithshme dhe ngërçi politik në vitin 2017) që kanë bërë të pamundur tërheqjen e vëmendjes së aktorëve shtetërore tek PQH.²¹ Në fakt, shumë OShC kanë organizuar një sërë tubimesh dhe koalicione gjatë gjysmës së dytë të vitit 2016 për miratimin e reformës në drejtësi.

Një mangësi tjetër e periudhës së zbatimit lidhet me faktin se aktivitetet publike që kanë të bëjnë me rritjen e ndërgjegjësimit për PQH kanë qenë shumë të kufizuara dhe krejtësisht të varura nga financimi i projekteve të OSHC-ve. Qeveria nuk ka përcaktuar ndonjë buxhet specifik për koordinimin, monitorimin, raportimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me aktivitetet që janë përcaktuar në planin e veprimit të PQH-së, gjë që do të mundësonte një qasje më të mirë dhe proaktive për përfshirjen e sa më shumë aktorëve të ndryshëm në fazën e zbatimit.

Rrjedhimisht, në monitorimin dhe raportimin për zbatimin e planit të veprimit gjatë 2016-2017 janë përfshirë vetëm institucionet shtetërore. Kryeministria nuk u përfshi në promovimin e PQH dhe planit të veprimit të Shqipërisë, siç sugjerohet nga raporti i MRP i vitit 2016, ndërkohë që fushatat e informimit publik u mbështetën tërësisht në financimet e projekteve të OSHC-ve.

Për periudhën e ardhshme të procesit të PQH-së në Shqipëri është me rëndësi të madhe të trajtohen mangësitë në lidhje me përfshirjen e Forumit OpenAlb në monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të planit të veprimit. Në këtë drejtim, qeveria shqiptare duhet të ofrojë mbështetje dhe të lehtësojë veprimet e OSHC-ve. Progresi në zbatimin e planit të veprimit, rishikimi periodik, raportimi dhe monitorimi duhet të jetë më gjithëpërfshirës dhe rezultatet e tyre duhet t'i vihen në dispozicion publikut.

3.5 Vetëvlerësimi

Nenet PQH për Qeverisjen përcaktojnë që vendet pjesëmarrëse të publikojnë një raport vetëvlerësimi çdo tre muaj përfundimit të vitit të parë të zbatimit. Raporti i vetëvlerësimi duhet të bëhet i disponueshëm për komente nga publiku për një periudhë 2-javore. Në këtë seksion vlerësohet përmbushja e këtyre detyrimeve dhe cilësia e raportit.

Në kohën e përpilimit të këtij raporti (tetor 2017), qeveria shqiptare nuk kishte publikuar asnjë raport vetëvlerësimi.

3.6 Trajtimi i rekomandimeve të mëparshme të MRP-së

Tabela 3.5: Rekomandimet kryesore të raportit të mëparshëm MRP

Rekomandimi		U trajtua?	U përfshi në planin tjetër të veprimit?
1	1. Të krijohet një forum i vazhdueshëm me pjesëmarrjen e shumë aktorëve dhe të hartohet një kuadër i plotë menaxhimi dhe raportimi (minimalisht me monitorim tremujor) për zbatimin e planit të veprimit.	✓	✗
2	2. Të ndërmerren angazhime më ambicioze të lidhura me PQH, të cilat i japin qytetarëve dhe grupeve të interesit një rol ndërveprues në fushat e anti-korrupsionit, luftës kundër pandëshkueshmërisë, rritjes së transparencës dhe përgjegjshmërisë. Qeveria mund të ofrojë më shumë mundësi	✓	✗

	për të orientuar kontributin e qytetarëve dhe monitorimin duke u bazuar në modelet e portaleve të denoncimit të korrupsionit dhe komisaritit dixhital.		
3	3. Të promovohen përjasje të qeverisjes së hapur në zhvillimin e reformave dhe nismave kryesore sektoriale, përfshirë reformën në gjyqësor, financimin e partive politike, debatin e vazhdueshëm për integritetin e zyrtarëve publikë të zgjedhur dhe atyre të nivelit të lartë.	X	X
4	4. Shoqëria civile duhet të vlerësojë procesin PQH dhe të kanalizojë më mirë përmbajtjen e PQH në programin e saj.	X	X
5	5. Të caktohet një buxhet specifik dhe burime njerëzore për Koordinatorin Kombëtar, i cili merret me hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të veprimit PQH si dhe promovimin në nivel kombëtar të Agjendës PQH të Shqipërisë tek publiku, aktorët e interesuar, administrata publike dhe komuniteti i donatorëve.	X	X

Rekomandimet e MRP-së (Raporti i Progresit për Shqipërinë 2015) kishin si qëllim përmirësimin e përmbajtjes dhe procesit të zbatimit të planit të veprimit të PQH-së në Shqipëri. Si të tilla, ato u trajtuan si nga ana e qeverisë ashtu edhe nga shoqëria civile. Nga pesë rekomandimet, aktorët nga qeveria dhe shoqëria civile në Shqipëri trajtuan vetëm njërin prej tyre, ndonëse edhe këtë e trajtuan pjesërisht. Në mënyrë specifike, në rekomandimin e parë të MRP-së i bëhej thirrje Qeverisë dhe OShC-ve në Shqipëri të krijonin “një forum të vazhdueshëm me pjesëmarrjen e shumë aktorëve dhe të hartohej një kuadër i plotë menaxhimi dhe raportimi (minimalisht me monitorim tremujor) për zbatimin e planit të veprimit si dhe një kuadër raportimi për zbatimin e planit të veprimit”. Edhe pse një forum i tillë u krijua për planin e veprimit 2016-2018, ai nuk kishte një kuadër menaxhimi dhe raportimi, që do t’u bënte të mundur aktorëve të monitoronin zbatimin e planit të veprimit gjatë periudhës 2016-2017.

Edhe pse plani i veprimit 2016-2018 përmban angazhime të rëndësishme që rrisin aksesin tek informacionet ose përmirësojnë shërbimet publike, vetëm njëri prej tyre - zbatimi i Ligjit “Për sinjalizimet dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, ngritja e kapaciteteve, ndryshimet ligjore dhe aktet nënligjore – i vendos qytetarët dhe grupet e interesit një rol interaktiv në fushën e anti-korrupsionit. Plani i veprimit 2014-2016 përfshinte angazhime të rëndësishme, të cilat mbështeteshin në rolin e qytetarëve për të denoncuar korrupsionin. Ndonëse Shqipëria po zbaton një nga reformat më të rëndësishme në luftën kundër korrupsionit dhe për t’i dhënë fund mosndëshkimit e për të përmirësuar besimin e publikut në sistemin gjyqësor, asnjë angazhim nuk është përfshirë në planin aktual të veprimit.

Në vitin 2016 u propozuan disa angazhime nga institucionet shtetërore dhe shoqëria civile me fokus të veçantë në luftën kundër korrupsionit, për krijimin e integritetit, llogaridhënien, etj. Disa prej tyre përfshijnë: Vazhdimin e angazhimit “Stop-Korrupsionit”; financimi i partive politike; angazhimet lidhur me Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI); dhe publikimi proaktiv i deklaratave vjetore të pasurive nga zyrtarët publikë. Qeveria nuk i ka përfshirë këto angazhime,

të cilat mund të kishin adresuar edhe rekomandimin e tretë të MRP në vitin 2015 - të promovimi i qasjes PQH në reformat e tjera sektoriale.

Për sa i përket dy rekomandimeve të fundit, hulumtuesi i MRP konstaton se ato nuk janë trajtuar ose integruar në planin e ardhshëm të veprimit. Angazhimi i shoqërisë civile u kufizua tek anëtarët aktivë të forumit OpenAlb dhe tek disa OShC të tjera. Po ashtu, qeveria vazhdoi ta linte agjendën PQH jashtë fokusit të saj financiar. Përfundimisht, Qeveria nuk realizoi asnjë aktivitet të rritjes së ndërgjegjësimit për PQH me aktorë të mundshëm apo me publikun e gjerë.

¹ Këshilli i Ministrave; Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit, Ministria e Financave, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Mjedisit, Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Zhvillimit Urban, Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, MIAP, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, AKSHI, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, Instituti i Transportit, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

² Komisioneri për Lirinë e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

³ Bashkia Fier, Bashkia Shkodër.

⁴ Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit, Ministria e Financave, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Mjedisit, Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Zhvillimit Urban, Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, MIAP, AKSHI.

⁵ Komisioneri për Lirinë e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

⁶ Agjencia për Kërkim, Teknologji dhe Inovacione, Agjencia për Ofrimin e Shërbimeve të Integruara, Arkivi Teknik Qendror i Ndërtimit, Agjencia për Trajtimin e Koncesionit, Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit dhe Sipërmarrjes, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Mjedisit, Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Zhvillimit Urban, Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve.

⁷ Komisioneri për Lirinë e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

⁸ OSCH pjesëmarrëse aktive në forumin OpenAlb janë: IDM, InfoCip, European Movement Albania, Barazi në vendimmarrje, CSDS Durrës, Instituti për Studime Politike, Auleda vlore, Lëvizja Mjaft, Qendra Rajonale Mjedisore, OSFA (Fondacioni Soros), OpenAda Albania (AIS), dhe Partnerë Shqipëri. Ka edhe OSHC të tjera që kanë rënë dakord të bëhen pjesë e OpenAlb, por ato të përmendura më sipër janë më aktivet.

⁹ Forumi OpenAlb, <http://www.inovacioni.gov.al/al/newsroom/lajme/forumi-i-aktoreve-te-interesit-per-zbatimin-e-partneritetit-per-qeverisje-te-hapur&page=3>. Data e referimit qershor 2017. Faqja ueb e MIAP u hoq në kohën që po përpilohej ky raport.

¹⁰ Intervistë me Jona Josifin (MIAP) dhe Artela Mitrushin (IDM), qershor 2016.

¹¹ Në kuadër të projektit, IDM organizoi dy seminare për PQH dhe shërbimet e qeverisjes vendore në bashkitë Shkodër dhe Fier, qershor 2016, <http://rozafa.tv/2016/07/perceptimi-qytetareve-mbi-sherbimet-ne-nivel-lokal/> dhe <https://www.youtube.com/watch?v=WCP3iotlGiU>. Lëvizja MJAFT, InfoCip, AIS, CSDC Durrës dhe organizata të tjera kanë rritur ndërgjegjësimin për PQH në nivel vendor nëpërmjet projekteve të tyre për çështje që lidhen me transparencën, aksesin e informacionit, të dhënave të hapura, dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile.

¹² Forumi OpenAlb, <http://www.inovacioni.gov.al/al/newsroom/lajme/nisma-ogp-rezultate-konkrete-per-me-shume-transparence-ne-qeverisje&page=1>. Data e referimit qershor 2017. Faqja ueb e MIAP u hoq në kohën që po përpilohej ky raport.

¹³ Spektri IAP 2 për pjesëmarrjen e publikut, http://c.ymcdn.com/sites/www.iap2.org/resource/resmgr/foundations_course/IAP2_P2_Spectrum_FINAL.pdf

¹⁴ Anëtarë të Koalicionit nga shoqëria civile ishin IDM, Lëvizja MJAFT, Instituti për Politikën dhe Studimet Ligjore (IPLS), Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), AULEDA, Instituti për Studime Parlamentare (IPS), INFOCIP, Instituti Shqiptar i Shkencave (AIS), BIRN Shqipëri, REC Shqipëri, Rrjeti i Studentëve Shqiptarë Jashtë Vendlindjes (ASAN), Partnerë Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, Lëvizja Evropiane në Shqipëri (EMA), Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile (CSDC). Koalicioni i OSHC-ve për PQH Shqipëri krijuan OpenAlb dhe janë bërë pjesë e tij.

¹⁵ Raportim qytetar dhe nga media (në anglisht) i forumit, <http://www.balkanicsd.net/albania-launches-the-ogp-multi-stakeholder-forum/> dhe <http://www.albaniannews.com/index.php?idm=5104&mod=2>

¹⁶ Konsultimet e mëposhtme u mbajtën në kuadër të forumit OpenAlb, Takimi Konsultativ për draftin e parë të planit të veprimit në 29 prill 2016, <http://openalb.net/mc-events/takim-mbi-konsultimin-e-draftit-pas-reflektimit-te-komenteve/>; takime tematike me aktorët në 10 maj 2016, <http://openalb.net/mc->

[events/takime-paralele-tematike/](http://openalb.net/mc-events/takime-paralele-tematike/); tre seanca të ndara në 6 qershor 2016, <http://openalb.net/mc-events/grupet-tamatike-angazhimet-per-hartimin-e-plan-veprimit-per-pqh-2016-2018/>; katër seanca në 7 qershor 2016, <http://openalb.net/mc-events/grupet-tamatike-per-angazhimet-per-hartimin-e-plan-veprimit-per-pqh-2016-2018/>. Po ashtu, u transmetua live një seminar online në internet (webinar) nga OpenAlb at <http://openalb.net/mc-events/webinar-mbi-partneritetin-per-qeverisje-te-hapur-pqh/>

¹⁷ Takimet u përqendruan në angazhimet tematike të PQH si Krijimi i komuniteteve më të sigurta; mbrojtja e mjedisit; aksesit tek informacioni dhe modernizimi i shërbimeve publike.

¹⁸ Bashkia Shkodër, <http://www.starplus-tv.com/aktualitet-star-plus-tv-shkoder/item/14637-sherbimet-ne-nivel-vendor-tryeza-e-diskutimit-ge-u-mbajit-ne-shkoder> dhe <http://rozafa.tv/perceptimi-qytetareve-mbi-sherbimet-ne-nivel-lokal/>. Bashkia Fier, <http://idmalbania.org/sq/raport-mbi-perceptimin-e-qytetareve-mbi-ofrimin-e-sherbimeve/>

¹⁹ Aktivitet publik i OpenAlb, <http://www.inovacioni.gov.al/al/newsroom/lajme/nisma-ogp-rezultate-konkrete-per-me-shume-transparence-ne-qeverisje&page=1>. Data e referimit qershor 2017. Faqja ueb e MIAP u hoq në kohën që po përpilohej ky raport.

²⁰ Komunikimi me Email, 24 korrik 2017.

²¹ Intervistë me Aldo Merkoçi – Lëvizja Mjaft, Artela Mitrushi – IDM, korrik 2017.

IV. Angazhimet

Të gjitha qeveritë pjesëmarrëse në PQH hartojnë plane veprimi PQH ku përfshihen angazhime konkrete gjatë një periudhe dyvjeçare. Qeveritë fillojnë planin e veprimit PQH duke evidentuar përpjekjet ekzistuese në lidhje me qeverinë e hapur, përfshirë këtu strategjitë specifike dhe programet në vazhdim.

Angazhimet PQH duhet të përshtaten me rrethanat unike dhe sfidat e secilit vend. Ato duhet të duhet të kenë të bëjnë me vlerat PQH të përcaktuara nga Nenet PQH të Qeverisjes dhe në Deklaratën e Qeverisë së Hapur të nënshkruar nga të gjitha vendet pjesëmarrësve.¹

Çfarë e bën të mirë një angazhim?

Duke pranuar se arritja e angazhimeve të qeverisjes së hapur kërkon proces shumëvjeçar, qeveritë duhet të caktojnë afate kohore dhe objektiva për arritjen e këtyre angazhimeve, ku të përcaktohet se çfarë do të arrihet atë çdo vit, sa herë që të jetë e mundur. Në këtë raport jepen detaje për secilin nga angazhimet që vendi ka përfshirë në planin e veprimit dhe analizohet viti i parë i zbatimit të tij.

Treguesit e përdorur nga MRP për vlerësimin e angazhimeve janë si më poshtë:

- **Detajimi:** Ky variabël vlerëson nivelin e detajimit dhe matshmërisë së secilit angazhim. Opsionet janë:
 - I lartë: Gjuha e angazhimit përcakton aktivitete të qarta, të verifikueshme dhe rezultate të matshme për arritjen e objektivit të angazhimit.
 - Mesatar: Gjuha e angazhimit përshkruan aktivitete që është objektivisht i verifikueshëm dhe përfshin rezultate, por këto rezultate nuk janë të qartësisht matshme ose të rëndësishme për arritjen e objektivit të angazhimit.
 - I ulët: Gjuha e angazhimit përshkruan aktivitetin që mund të interpretohet si i verifikueshëm, por që kërkon një interpretim nga ana e lexuesit për të identifikuar se çfarë aktiviteti përcakton për t'u realizuar si dhe për të përcaktuar se cilat do të jenë rezultatet.
 - Nuk ka: Gjuha e angazhimit nuk përmban asnjë aktivitet të matshëm, rezultat apo objektiv.
- **Lidhja:** Kjo variabël vlerëson lidhjen e angazhimit me vlerat PQH. Sipas një leximi të kujdesshëm të tekstit të angazhimit siç përshkruhet në planin e veprimit, pyetjet udhëzuese për të përcaktuar lidhjen janë:
 - Aksesit tek informacioni: A do të bëjë publike qeveria më shumë informacion ose a do të përmirësojë cilësinë e informacionit të publikuar?
 - Pjesëmarrja qytetare: A do të krijojë apo përmirësojë qeveria mundësitë dhe aftësitë për publikun që ky i fundit të përcaktojë apo ndikojë tek vendimet?
 - Llogaridhënia publike: A do të krijojë apo përmirësojë qeveria mundësitë që zyrtarët publikë të japin llogari për veprimet e tyre?
 - Teknologjia dhe inovacioni për transparencë dhe përgjegjshmëri: A do të përdoren risitë teknologjike në lidhje me një nga tre vlerat e tjera PQH për të forcuar edhe më shumë transparencën apo llogaridhënien?²
- **Ndikimi i mundshëm:** Ky variabël vlerëson *ndikimin e mundshëm* të angazhimit, nëse përfundohet siç është shkruar. Hulumtuesi MRP përdor tekstin nga plani i veprimit:
 - Për të evidentuar problemin social, ekonomik, politik ose mjedisor;

- Për të përcaktuar status quo-në në fillim të planit të veprimit; dhe,
- Për të vlerësuar shkallën në të cilën angazhimi, nëse është zbatuar, do të ndikonte në performancën dhe në trajtimin e problemit.

Angazhimet me yje konsiderohen angazhime tipike PQH . Për të marrë një yll, angazhimi duhet të plotësojë disa kritere:

- Angazhimet me yje kanë detajim “mesatar” ose të “lartë”. Angazhimi duhet të përcaktojë qartë aktivitetet dhe hapat për të mundësuar gjykim për ndikimin e mundshëm.
- Gjuha e angazhimit duhet të bëjë të qartë lidhjen e tij me hapjen e qeverisë. Në mënyrë specifike, ajo duhet të lidhet me të paktën një nga vlerat PQH të qasjes tek informacioni, pjesëmarrjes publike, apo llogaridhënies tek publiku.
- Angazhimi duhet të ketë Ndikim të mundshëm “transformues” nëse zbatohet plotësisht.³
- Qeveria duhet të bëjë progres të konsiderueshëm për këtë angazhim gjatë periudhës së zbatimit të planit të veprimit, ku të zbatimi i tij të renditet si “i përfunduar” ose “i konsiderueshëm”.

Duke u bazuar në këto kritere, plani i veprimit i Shqipërisë kishte një angazhim me yll – zbatimi i Ligjit “Për sinjalizimet dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, ngritje kapacitetesh, dhe ndryshimet ligjore e aktet nënligjore (Angazhimi 9).

Së fundi, tabelat në këtë seksion japin një pjesë të shkëputur nga larmia e madhe e të dhënave që MRP mbledh gjatë procesit të raportimit të progresit. Për të gjithë setin e të dhënave për Shqipërinë dhe për vendet pjesëmarrëse në PQH, shih “OGP Explorer”.⁴

Përmbledhje e angazhimeve

Plani i tretë i veprimit i PQH-së i Shqipërisë ka 17 angazhime të ndara në katër tematika kryesore: Qeveria e hapur për rritjen e aksesit tek informacioni, qeveria e hapur për krijimin e komuniteteve më të sigurta, qeveria e hapur për modernizimin e shërbimit publik dhe qeveria e hapur për mbrojtjen e mjedisit. MRP nuk e ka ndryshuar organizimin e angazhimeve, por i ka rinumëruar ato për qartësi. Për shembull, Përmirësimi i bazës së të dhënave/portalit me të dhënat e koordinatorëve për të drejtën e informimit dhe programeve të transparencës ka numrin '1' dhe jo '1.1'.

¹ Partneriteti i Qeverisjes së Hapur: Neni i Qeverisjes, qershor 2012 (përditësuar në mars 2014 dhe prill 2015), https://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/attachments/OGP_Articles-Gov_Apr-21-2015.pdf

² Manuali i Procedurave të MRP-së. Gjetet tek adresa:

http://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/IRM-Procedures-Manual-v3_July-2016.docx

³ Paneli i ekspertëve ndërkombëtarë e ndryshoi këtë kriter në vitin 2015. Për më shumë informacion vizitoni <http://www.opengovpartnership.org/node/5919>

⁴ OGP Explorer: bit.ly/1KE2Wil

1. Përmirësimi i portalit për akses tek informacioni

Teksti i angazhimit:

Titulli: Përmirësimi i bazës së të dhënave/portalit me të dhënat e koordinatorëve për të drejtën e informimit dhe programet e transparencës

Aktualisht Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale ka krijuar një portal qendror për të aksesuar informacionin në mënyrë që qytetarët të jenë në gjendje të bëjnë kërkesa për informacion online dhe nëse kjo e drejtë nuk përmbushet, ata do të kenë mundësinë të ankohen edhe në internet . Në këtë portal do të ketë një bazë të zgjeruar të dhënash të programeve të transparencës të autoriteteve publike nëpërmjet të cilave informacionet publike ofrohen pa pasur nevojë për kërkesë si dhe të dhëna për koordinatorët për të drejtën e informimit dhe regjistrimin e kërkesave dhe përgjigjeve përkatëse.

Sipas këtij plani veprimi, portali do të përmirësojë modulën e tij për publikimin e ankesave dhe përgjigjeve që qytetarët u drejtohen institucioneve sipas programit të transparencës; portali do të vazhdojë të përditësohet me informacionet më të fundit për këta koordinatorë në secilin institucion.

Ky angazhim nënkupton ofrimin e mundësisë për të gjurmuar informacionin dhe ankesat në mënyrë elektronike nga vetë palët e interesuara.

Institucioni përgjegjës: Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Institucion(et) mbështetës(e): Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA)

Data e fillimit: 2016

Data e mbarimit: 2018

Shënim redaksional: Për të lexuar të gjithë tekstin e angazhimit, lutemi referojuni https://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_NAP3_ENG.pdf.

Përmbledhje e angazhimit	Detajimi				Lidhja me vlerën PQH				Ndikimi i mundshëm				Në kohë?	Zbatimi			
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi në Informacion	Pjesëmarrja qytetare	Llogaridhënia publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues		Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar
1. Përmirësimi i portalit për aksesin tek informacioni			✓		✓			✓			✓		Po				✓

Konteksti dhe Objektivat

Portali <http://pyetshtetin.al> u krijua nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) në vitin 2015 pas miratimit të Ligjit për të drejtën e informimit në vitin 2014.¹ Portali është një platformë online e ndërtuar për të lehtësuar procedurat e marrjes së

informacionit nga publiku. Ai u projektua dhe koordinua në bashkëpunim të ngushtë me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.²

Megjithatë, Ligji për të Drejtën e Informacionit u miratuar kohët e fundit dhe janë ngritur shqetësime për mungesën e një regjistri qendror të aplikimeve për marrje informacioni dhe për mungesën e një baze të përditësuar të dhënash me emrat e punonjësve dhe informacione kontakti (p.sh., numri i telefonit dhe email), të cilat do të lehtësonin zbatimin e ligjit. Ky angazhim trajton këto shqetësime duke përmirësuar portalin aktual për t'u bërë të mundur qytetarëve të ndjekin në mënyrë elektronike kërkesat e tyre për informacion si dhe ankesat që kanë bërë në këtë drejtim (nëse e drejta e tyre për informacion nuk është përmbushur). Portali do të përditësohet për të përfshirë edhe një bazë të zgjeruar të dhënash mbi programet e transparencës dhe informacionin e kontaktit për koordinatoret.

Ky angazhim zgjeron të dhënat që u vihen në dispozicion qytetarëve dhe po përmirëson një modul për gjurmimin e ankesave; prandaj, angazhimi ka lidhje me vlerat PQH të aksesit tek informacioni dhe teknologjia e inovacioni.

Edhe pse shpreh qartë qëllimin e synuar, ky angazhim nuk përcakton formën a mënyrën se si institucioni zbatues do të ndërmarrë hapa të matshëm dhe të verifikueshëm për të arritur objektivin e tij (d.m.th., krijimin e një mekanizmi të ankesave, zgjerimin e bazës së të dhënave aktuale, etj.). Prandaj, hulumtuesi MRP e konsideron këtë angazhim të jetë me detajim të mesëm.

Ndonëse publikimi dhe përditësimi i rregullit i programeve të transparencës dhe i të dhënave të koordinatoreve për të drejtën e informimit është detyrim ligjor, shumë institucione shtetërore, veçanërisht ato të nivelit vendor, nuk e përmbushin plotësisht këtë detyrim. Ligji krijon parakushtet bazë, por ai nuk ofron akses proaktiv kur boton informacione. Prandaj, ndikimi i mundshëm i këtij angazhimi është i moderuar duke qenë se ai lehtëson zbatimin e ligjit. Gjithsesi, një angazhim më transformues do të përfshinte garancinë e përgjigjes së qeverisë ndaj ankesave publike. Është e rëndësishme të përmendet se ndikimi i zbatimit të plotë të këtij angazhimi varet shumë nga shkalla në të cilën palët e interesuara - qytetarët dhe aktorët jo-shtetërorë - e përdorin atë dhe në masën në të cilën institucionet përgjegjëse i përgjigjen kërkesave dhe ankesa.

Zbatimi

Ky angazhim u zbatua plotësisht brenda vitit të parë të planit të veprimit të OGP-së, në sajë të mbështetjes së dhënë nga Projekti i Fondacionit Soros (OSFA) në Shqipëri.

Gjatë vitit 2016 në portal u instalua funksioni i gjurmimit, i cili u mundëson palëve të interesuara të kontrollojnë statusin e kërkesës së tyre për informacion ose të ankesës nëse kërkesa e tyre nuk ishte përmbushur.³ Portali përfshin një rubrikë për regjistrin e kërkesave që lidhen me regjistrin e çdo institucioni shtetëror në nivel qendror ose vendor.⁴ Pjesë e portalit është edhe një regjistër ankesash dhe të dy instrumentet kanë motor kërkimi.⁵ Pak institucione publikojnë në regjistër se për çfarë bënte fjalë kërkesa. Në portal gjendet edhe një regjistër vjetor ankesash (i kërkueshëm me motor kërkimi).

Portali përmban edhe informacion të përditësuar për koordinatoret e të drejtës së informimit dhe programeve të transparencës të institucioneve shtetërore. Përmes këtij portali ofrohet për publikun informacion i thjeshtë për t'u kuptuar (manuale, video, etj.) për mënyrën e përdorimit të platformës dhe të ushtrimit të së drejtës së tyre për akses të lirë tek informacioni.

Rezultatet e para (nëse ka)

Nga një analizë krahasuese e numrit të ankesave nga viti 2015 deri në gjysmën e parë të vitit 2017 evidentohet se numri i personave që paraqesin kërkesa dhe/ose ankesa përmes portalit pyetshtetin.al po rritet. Në vitin 2016 u paraqitën tek autoritetet publike gjithsej 684 ankesa, ndërsa në pesë muajt e parë të 2017 ka pasur rreth 270 ankesa, që është pothuajse i njëjtë me numrin e atyre në 2015 për tërë vitin. Shumica e ankesave janë zgjidhur me ndërmjetësim, që do të thotë se Komisioneri është në kontakt me institucionin përkatës dhe më pas i ofron informacion personit që paraqet ankesën.

Hapat e mëtejshëm

Në planin tjetër të veprimit, qeveria duhet të hartojë një angazhim për të siguruar që organi përgjegjës të përgjigjet jo më vonë se 30 ditë pas marrjes së një komenti në lidhje me arsyen e pranimi ose refuzimit. Për më tepër, ligji thotë se organi publik përgjegjës duhet të marrë masa korigjuese të menjëhershme pas shkeljeve ligjore. Gjithsesi, nuk parashikohen sanksione administrative për personat përgjegjës që mund të shkelin ligjin. Neni 21 duhet të ndryshohet për të përcaktuar në mënyrë specifike masat administrative që duhet të ndërmerren nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për të trajtuar në mënyrën e duhur shkeljen në fjalë.

¹ Raporti vjetor 2015 i Komisionerit se janë realizuar një sërë aktivitete me OSFA gjatë vitit 2015, si trajnime të koordinatorëve për të drejtën e informimit në administratën publike, konferenca rajonale në Korçë, Vlorë, Shkodër, etj. Edhe krijimi i portalit u raportua si në ndërtim e sipër. Shih Raportin Vjetor 2015: http://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/10/Raporti_Vjetor_2015.pdf.

² Informacioni u dha nga përfaqësuesi i OSFA Klodian Seferaj.

³ Për të aksesuar kërkesat për informacion qytetarët mund të përdorin këtë adresë: <http://pyetshtetin.al/kerko-informacion/>, ndërsa për ankesat, <http://pyetshtetin.al/ankohuni-tek-komisioneri/>.

⁴ Portali OSFA, <http://pyetshtetin.al/rregjistri-i-kerkesave/>

⁵ Portali OSFA, <http://pyetshtetin.al/rregjistri-i-ankesave/>

2. Transparenca e buxhetit

Teksti i angazhimit:

Transparenca në financat publike është një element kyç i qeverisë, kështu që informacioni për buxhetin të publikohet në kohë, të jetë lehtësisht i kapshëm dhe i qartë për qytetarët. Ky angazhim rrit më tej stabilitetin makroekonomik dhe fiskal si dhe mundëson normat më të larta të rritjes ekonomike. Përveç kësaj, ai ndihmon në përmirësimin e efikasitetit të shpenzimeve publike. Ministria e Financave i ka kushtuar vëmendje të madhe transparencës buxhetore, duke e vendosur atë në krye të prioritetëve të saj, të materializuar në Strategjinë e Financave Publike 2014-2020.

Përmirësimi i transparencës së buxhetit nëpërmjet këtij angazhimi do të arrihet me anë të:

- Përgatitjes së të gjitha dokumenteve të nevojshme për buxhetimin, në një format të tillë që struktura e tyre të jetë e qartë dhe e kuptueshme për qytetarët;
- Publikimit në kohë të këtyre dokumenteve;
- Publikimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe në media i të gjitha aktiviteteve të kryera nga Ministria, përfshirë këtu dëgjuesat për programin e buxhetit afatmesëm për arritjen e pjesëmarrjes aktive të përfaqësuesve nga organizata të ndryshme, si qytetarë, OJQ, shoqëria civile, qeveria qendrore dhe vendore e të gjitha niveleve.

Institucioni përgjegjës: Ministria e Financave

Institucion(et) mbështetës(e): Partnerët Shqipëri, Instituti Shqiptar i Shkencave, etj.

Data e fillimit: 2016

Data e mbarimit: 2018

Shënim redaksional: Për të lexuar të gjithë tekstin e angazhimit, lutemi referojuni https://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_NAP3_ENG.pdf.

Përmbledhje e angazhimit	Detajimi				Lidhja me vlerën PQH				Ndikimi i mundshëm				Në kohë?	Zbatimi			
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi në Informacion	Pjesëmarrja qytetare	Llogaridhënia publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues		Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar
2. Transparenca e buxhetit			✓		✓	✓					✓		Po			✓	

Konteksti dhe Objektivat

Raporti i vitit 2015 i Partneritetit Ndërkombëtar për Buxhetin për Shqipërinë vinte në dukje se qeveria i ofron publikut shumë pak informacione për buxhetin dhe ka performancë të dobët për sa i përket angazhimit të publikut në procesin e hartimit të buxhetit. Për të përmirësuar transparencën dhe pjesëmarrjen, raporti sugjeron botimin e një numri dokumentesh buxhetore, përfshirë këtu edhe Raportin Vjetor dhe Analizën 6-mujore si dhe "Buxhetin e Qytetarëve". Ai rekomandon që të jepen më shumë informacione për klasifikimin e shpenzimeve. Për të përmirësuar

pjesëmarrjen, raporti i rekomandon qeverisë të krijojë mekanizma të besueshëm dhe efektivë për kapjen e një sërë perspektivash publike për çështjet buxhetore. Qeveria kohët e fundit ka filluar të ndërmarrë hapa për të përmirësuar transparencën e buxhetit. Në një shkallë të konsiderueshme, përmirësimet e fundit i detyrohen reformave dhe detyrimeve që Shqipëria po përmbush në kuadër të procesit të integritetit evropian, veçanërisht në fushën e menaxhimit të financave publike.

Qeveria po kërkon të rrisë numrin e dokumenteve buxhetore të publikuara dhe po kërkon të zgjerojë pjesëmarrjen qytetare, duke krijuar mundësi që qytetarët dhe aktorë të tjerë të marrin pjesë në hartimin e dokumenteve buxhetore.

Angazhimi tregon qartë rezultatet e matshme në lidhje me përgatitjen dhe publikimin e dokumenteve specifike të buxhetit. Megjithatë, nuk është e qartë se cilat aktivitete të Ministrisë së Financave (MF) do të publikohen dhe, po ashtu, nuk është e qartë as si do të zhvillohen takimet me shoqërinë civile dhe cili do të jetë niveli i përfshirjes së saj në të. Në përgjithësi, detajimi i këtij angazhimi është e mesëm.

Nëse zbatohet plotësisht, ky angazhim mund të ketë ndikim të moderuar të mundshëm për rritjen e transparencës së buxhetit. Qeveria po ndërmerr hapa të rëndësishëm jo vetëm për të publikuar informacionin e buxhetit, por për ta bërë atë të kuptueshme për qytetarët. Për më tepër, konsultimi buxhetor me grupet e interesit ka ndodhur historikisht pas hartimit të buxhetit dhe gjatë procedurave parlamentare për miratim. Kjo procedurë konsultimi shpesh ndodh në afate të shkurtra kohore, duke kufizuar kohën për ndryshimin e buxhetit. Përfshirja e grupeve të interesit gjatë procesit të hartimit të buxhetit do të rriste ndikimin e tyre në procesin e vendimmarrjes.

Zbatimi

Buxheti i qytetarëve i vitit 2016 dhe lista e investimeve në programin afatmesëm buxhetor janë publikuar. Edhe pse personi i kontaktit i qeverisë për këtë angazhim nuk ka dhënë informacione për ecurinë e zbatimit të këtij program, hetimi nga MRP evidenton se ky angazhim është zbatuar në kohë.

Ndonëse angazhimi synon të përfshijë shoqërinë civile dhe grupet e tjera të interesit në procedurën e hartimit të buxhetit me Ministrinë e Financave, një gjë e tillë nuk ndodhi. Përkundrazi, konsultimi publik u realizua gjatë procedurës parlamentare të miratimit të buxhetit, gjë që ka qenë praktikë e zakonshme e qeverisë.

Të gjitha dokumentet që lidhen me projekt buxhetin janë përgatitur dhe gjenden në internet në adresën e Ministrisë së Financave.¹ Për vitet 2016 dhe 2017 u përgatit dhe publikua Buxheti i qytetarëve, ndërsa projekt buxhetet janë publikuar në adresën e Ministrisë së Financave.² Ministria ka publikuar buxhetin gjinor për programin buxhetor afatmesëm.³ Në faqen e internetit të kësaj ministrie publikohen çdo tre muaj edhe raportet e monitorimit.⁴

Për buxhetin e vitit 2016, qeveria nuk bëri analizën 6-mujore të buxhetit, që rekomandohej nga raporti vjetor i buxhetit të hapur.⁵ Megjithatë, mbetet ende e paqartë nëse informacioni i publikuar është aksesuar nga publiku dhe aktorët e interesuar dhe në ç'masë. Bizneset dhe media reagojnë ndaj çështjeve të ndryshme të buxhetit (kryesisht në lidhje me taksat dhe klimën e biznesit) vetëm gjatë shqyrtimit të buxhetit në Parlament. Nuk ka metoda apo instrumente për matjen e sasisë së informacionit që përdoret nga aktorët dhe palët e interesuara.

Pavarësisht përmirësimeve dhe zbatimit të aktiviteteve të caktuara të këtij angazhimi, monitorimi nga shoqëria civile për vitet 2016⁶ dhe 2017⁷ sugjeron se ka ende vend për përmirësim për sa i përket performancës së qeverisë, në mënyrë të veçantë në lidhje me konsultimin për projekt buxhetin. Më konkretisht, për projekt buxhetin e vitit 2017 që është brenda afatit kohor të këtij angazhimi në planin e veprimit të PQH, ekspertët nënvizuan se qeveria nuk respektoi afatin ligjor për paraqitjen e projekt

buxhetit në 15 tetor 2017, duke kufizuar kështu kohën që nevojitej për konsultime me shoqërinë civile dhe grupet e interesit në komisionet e përhershme parlamentare.⁸ Duke qenë se në konsultime nuk u përfshinë shoqëria civile dhe grupet e tjera të interesit në procedurën e hartimit të buxhetit, hulumtuesi MRP nuk mund ta kodonte zbatimin e përgjithshëm të këtij angazhimi më lartë se “i konsiderueshëm”.

Rezultatet e para (nëse ka)

Edhe pse veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij angazhimi evidentojnë zhvillime pozitive për transparencën e buxhetit në Shqipëri, ato nuk mjaftojnë për të siguruar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve. Së pari, ato nuk garantojnë që informacionet e thjeshta në lidhje me buxhetin të arrijnë tek publiku i gjerë. Asnjë nga pjesëmarrësit në diskutimet e fokus grupeve të realizuara nga hulumtuesi MRP nuk kishte dijeni për broshurat e buxhetit të qytetarëve të publikuar në faqen në internet të Ministrisë së Financave.⁹ Së dyti, pjesëmarrja e shoqërisë civile dhe grupeve të tjera të interesit në komisionet e përhershme parlamentare që shqyrtojnë projekt buxhetin mbetet e kufizuar. Për më tepër, ekspertët e shoqërisë civile sugjerojnë se ata duhet të thirren më herët për konsultime, para se projekt buxheti t'i paraqitet Kuvendit për miratim, me qëllim që të jenë në gjendje të sigurojnë një tjetër kanal konsultimi. Shpesh, grupet e interesit thirren për konsultime vetëm gjatë seancave dëgjimore për projekt buxhetin në parlament ose sugjerimet e tyre nuk merren parasysh.¹⁰

Hapat e mëtejshëm

Hulumtuesi MRP sugjeron që ky angazhim të vazhdohet për të përfshirë masa proaktive të cilat të nxisin pjesëmarrjen dhe veprimet që realisht të përfshijnë qytetarët dhe grupet e interesit në hartimin e buxhetit. Për më tepër, ka shumë rëndësi të trajtohen rekomandimet e raportit të Buxhetit të Hapur për Shqipërinë,¹¹ veçanërisht në lidhje me pjesëmarrjen dhe mbikëqyrjen:

- Si në ligj ashtu edhe në praktikë, të sigurohet që legjislativi të konsultohet para lëvrimit të fondeve në Buxhetin e Miratuar dhe shpenzimit të fondeve të paparashikuara të cilat nuk janë identifikuar në Buxhetin e Miratuar; dhe
- Të organizohen seanca legjislative për gjendjen e ekonomisë, ku të marrë pjesë ekzekutivi dhe të jenë të hapura për publikun.

Po ashtu, qeveria dhe shoqëria civile duhet të bëjnë më shumë përpjekje për përmirësimin e përdorimit të informacionit të buxhetit, që mbështetet kryesisht në kapaciteteve të përdoruesve fundorë (publikut) dhe ndërmjetësuesve që ndihmojnë publikun të kuptojë më mirë buxhetin –media, OSHC, grupet e tjera të interesit. Në këtë kontekst, duhet të merren masat e mëposhtme për të ndihmuar në rritjen e ndikimit të transparencës së buxhetit:

- Prezantimi i informacioneve të thjeshta për t'u kuptuar në shkolla dhe kurse të arsimit të mesëm;
- Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimi publik “të kuptojmë buxhetin”;
- Trajnimi i gazetarëve për çështje të financave shtetërore dhe buxhetit të shtetit.

¹ MF, <http://www.financa.gov.al/al/raportime/buxheti/buxheti-ne-vite>

² MF, <http://www.financa.gov.al/al/raportime/buxheti/buxheti-i-qytetarit>

³ MF, <http://www.financa.gov.al/al/raportime/buxheti/buxhetimi-gjinor>

⁴ MF, <http://www.financa.gov.al/al/raportime/buxheti/raporte-monitorimi/viti-20171507096197>

⁵ <http://www.internationalbudget.org/budget-work-by-country/findgroup/group-data/?country=al>

⁶ Raporti i OSFA, <http://www.osfa.al/publikime/fondacioni-prezanton-analizen-e-projektbuxhetit-2016-dhe-monitorimin-e-buxhetimit-te-prioriteteve-te-integritit-ne-projektbuxhetin-2016>

⁷ Raporti i OSFA, <http://www.osfa.al/publikime/fondacioni-prezanton-analizen-e-projektbuxhetit-2017-dhe-monitorimin-e-buxhetimit-te-prioriteteve-te-integritit-ne-projektbuxhetin-2017>

⁸ Monitorimi i Financave Publike: Analiza e projekt buxhetit të 2016, f. 4, https://www.osfa.al/sites/default/files/osfa_monitorimi_i_projekt-buxhetit_2017_0.pdf

⁹ Fokus grupe MRP me të rinj dhe pjesëmarrës nga zonat e largëta, gusht-shtator 2017.

¹⁰ Java News, <http://www.javanews.al/dhoma-e-tregtise-kunder-paketes-fiskale-nuk-u-thirrem-per-konsultime/>

¹¹ Sondazhi i buxhetit të hapur 2015, www.internationalbudget.org/wp-content/uploads/OBS2015-CS-Albania-English.pdf

3. Regjistri i integruar i banesave të shtetasve¹

Teksti i angazhimit:

Mungon një regjistër i integruar i banesave të shtetasve.

Regjistrimi i shtetasve në banesat e tyre do të bëjë të mundur që shumë shërbime të ofrohen për qytetarët nga shtëpitë e tyre; këto shërbime do të ridimensionohen pas krijimit të kësaj baze të dhënash.

Një aspekt i rëndësishëm i këtij shërbimi është regjistrimi i banesave të emigrantëve shqiptarë. Kjo do të mundësojë informacione të rëndësishme me përdorim të gjerë nga institucionet shtetërore dhe private (vota e emigrantëve, gjobat në shtëpi dhe shumë përdorime të tjera).

Në të gjithë procesin do të përfshihen qytetarët për të verifikuar saktësinë dhe integritetin e të dhënave; një shembull për këtë është që të dhënat për regjistrimin e emigrantëve do të merren përmes vetëdeklarimit. Po ashtu, opinionet e qytetarëve do të merren përmes zyrave të bashkisë dhe zyrave të gjendjes civile në të gjithë vendin.

- Rritja e cilësisë së shërbimeve për qytetarët nëpërmjet regjistrimit të banesave
- Shkrija e Regjistrat Kombëtar të Adresave me Regjistrin e Gjendjes Civile
- Popullimi i adresave të qytetarëve

Institucioni përgjegjës: Ministria e Brendshme

Institucion(et) mbështetës(e): N/A

Data e fillimit: 2016

Data e mbarimit: 2018

Përmbledhje e angazhimit	Detajimi				Lidhja me vlerën PQH				Ndikimi i mundshëm				Në kohë?	Zbatimi			
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi në Informacion	Pjesëmarrja qytetare	Llogaridhënia publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues		Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar
3. Regjistri i integruar i banesave të qytetarëve		✓			E paqartë					✓			Po		✓		

Konteksti dhe Objektivat

Sipas regjistrat civil të shtetasve shqiptarë, popullsia e Shqipërisë është afërsisht 4.3 milionë banorë, ndërsa numri aktual i banorëve shqiptarë përafrohet në 2.88 milionë nga janari 2017.² Gjatë 25 viteve të fundit, vlerësohet se rreth 1.4 milionë shqiptarë kanë emigruar, kryesisht në vendet e Evropës Perëndimore (Itali, Greqi, Gjermani, Francë, Mbretëri e Bashkuar, etj.), si dhe në Shtetet e Bashkuara, Kanada e

Australi.³ Përveç kësaj, migrimi i brendshëm ka qenë një fenomen i përhapur dhe i përhershëm: prej 1992-2000 rreth 1.3 milion njerëz migruan brenda vendit drejt qendrave urbane, si dhe drejt zonave rurale duke përfshirë zonat periferike të Tiranës, Durrësit, Shkodrës, Fierit dhe Korçës.⁴

Këto lëvizje migratore nuk janë regjistruar në regjistrin civil të shtetasve shqiptarë, duke shkaktuar konfuzion për një sërë shërbimesh publike që ofrohen nga shteti dhe për të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve të tjerë, siç janë të drejtat e votimit dhe mirëqenia sociale.

Regjistri i integruar i vendbanimit të qytetarëve synon të krijojë një bazë të saktë të dhënash të integruar me regjistrin civil, i cili përmban të gjitha të dhënat e qytetarëve (emrin, ditëlindjen, numrin e identifikimit, etj.) duke përfshirë adresën e tyre të banimit. Sipas planit të veprimit, kjo bazë të dhënash do të ofrojë akses online për shërbimet për qytetarët. Një shërbim që synon të arrijë ky angazhim është regjistrimi i emigrantëve, përmes regjistrit të integruar të banesave të shtetasve. Në fund të fundit, plani i veprimit sugjeron që regjistri i gjendjes civile të integrohet në regjistrin e Adresave Kombëtare dhe do të përmbajë të gjithë informacionin për shtetasit shqiptarë në një vend të vetëm, përfshirë këtu edhe vendbanimin e tyre të përditësuar. Edhe pse ky angazhim trajton një shqetësim shumë të rëndësishëm në Shqipëri, lidhja e tij me vlerat OGP është e paqartë. Regjistri i banesave të shtetasve do të jetë i aksesueshëm vetëm për autoritetet publike.

Ndonëse ky angazhim parashtron qartë rezultatin e synuar (dhe shërbimet e mëvonshme të ofruara), vetë teksti i angazhimit nuk specifikon hapat e matshëm që do të ndërmarrë Ministria e Brendshme për të krijuar një regjistër të integruar të vendbanimit të qytetarëve. Nga ana tjetër, nuk është e qartë se si regjistri do të rriste cilësinë e shërbimeve për qytetarët dhe, më konkretisht, se si qeveria do të realizonte kryerjen e një regjistrimi të migrantëve. Detajimi i këtij angazhimi është i ulët, për arsyt e mësipërme.

Nëse zbatohet plotësisht, ndikimi i mundshëm i këtij angazhimi është i vogël. Krijimi i një regjistri të integruar lehtëson punën e qeverisë për verifikimin e saktësisë së lëvizjeve migratore dhe të të dhënave agregate të qytetarëve të vendit. Megjithatë, për shkak të detajimit të ulët të angazhimit, hulumtuesi i MRP nuk mund mendon se ndikimi i mundshëm mund të jetë ndonjë gjë më e madhe se një hap i vogël në regjistrimin e lëvizjeve migratore.

Zbatimi

Pas sqarimit të detajeve të aktiviteteve të këtij angazhimi, hulumtuesi i MRP-së konstatoi se qeveria kishte parashikuar tre hapa: 1) ndryshimin e Ligjit nr. 9270, "Për sistemin e adresave", 2) hapjen e procesit të popullimit të bazës së të dhënave, dhe 3) pilotimin e regjistrit të banesave. Në procesin e popullimit të bazës së të dhënave përfshihen vendosja e kodeve të reja për familjet dhe më pas futjen e të dhënave (p.sh. numri i banorëve të familjeve, profesionet) në bazën e të dhënave. Regjistri i integruar i vendbanimit të qytetarëve u njoftua nga Ministri i Brendshëm në nëntor 2015.⁵

Në shtator 2016, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin nr. 89/2016 "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9270, datë 29.07.2004, "Për sistemin e adresave", të ndryshuar".⁶ Në tetor 2016, filloi procesi i popullimit të bazës së të dhënave.⁷ Deri në dhjetor 2016, sistemi i ri i adresave kishte filluar në bashkitë pilot. Qytetarëve në bashkitë pilot (Tiranë, Vlorë, Durrës) iu kërkua të raportnin adresat e tyre të banimit dhe ato alternative në zyrat e gjendjes civile në njësitë e qeverisjes vendore deri në korrik të vitit 2017. Megjithatë, ky afat nuk ishte realist: shumë qytetarë nuk ishin në dijeni të kërkesës dhe u përballën me gjopa prej 10,000 lekësh, pas së cilës autoritetet propozuan shtyrjen e afatit.⁸

Përfaqësuesi i qeverisë për këtë angazhim raportoi se pilotimi i Regjistrisë është në proces. Në fazën pilot, afërsisht 600,000 adresa banesash ishin verifikuar deri në kohën e përgatitjes së këtij raporti dhe ka edhe 800,000 të tjerë që do të verifikohen⁹. Faza pilot po kryhet në bashkëpunim me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.¹⁰ Megjithatë, mbetet e paqartë se kur projekti do të përfundojë në nivel kombëtar.

Rezultatet e para (nëse ka)

Në të tre fokus grupet e organizuara nga hulumtuesi i MRP-së, shumica e të anketuarve (qytetarë të zakonshëm) ishin në dijeni të këtij angazhimi¹¹. Përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe qytetarët pjesëmarrës në diskutimet e fokus grupeve theksuan rëndësinë e këtij projekti për shërbime më të mira publike, kontrollin e territorit dhe sigurinë publike, proceset zgjedhore etj.

Megjithatë, të dhënat e Regjistrisë do të përdoren vetëm nga autoritetet publike. Përfaqësuesit e shoqërisë civile sugjerojnë se mungesa e aksesit të publikut tek regjistri e vë në diskutim lidhjen e këtij angazhimi me vlerat PQH, pavarësisht rëndësisë së tij.

Hapat e mëtejshëm

Ashtu siç është shkruar, angazhimi trajton një çështje të rëndësishme për vendin dhe mund të përmirësojë ndjeshëm aktivitetet e institucioneve shtetërore në ofrimin e shërbimeve publike. Sidoqoftë, angazhimi aktualisht nuk ka lidhje me asnjë vlerë PQH. Hulumtuesi i MRP rekomandon që ky angazhim të kalohet në veprimin e mëtejshëm, me një ndryshim që të përfshijë edhe një nismë të të dhënave të hapura. Kjo do të sigurojë aksesin e publikut tek regjistri i integruar. Për të respektuar legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, disa nga informacionet që mund të bëhen publike janë: numri i vendbanimit dhe i zgjedhësve për zonën e banimit, qendrat e votimit dhe listat e votuesve, raporti i popullsisë rezidente dhe i emigrantëve sipas zonës (fshati, qyteti, qarku), etj. Ky informacion mund të jetë i dobishëm jo vetëm për qëllime të planifikimit vendor dhe të komunitetit, por edhe për monitorimin e zgjedhjeve.

¹ Përshkrimi i këtij angazhimi përdor të njëjtën terminologji si në planin e veprimit.

² INSTAT, <http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografikë-dhe-socialë/popullsia/publikimet/2017/popullsia-e-shqipërisë-1-janar-2017/>

³ Raporti i Komisionit Evropian, <http://ec.europa.eu/social/BlobServlet?docId=8835&langId=en>

⁴ Po aty.

⁵ Ministria e Brendshme, <http://www.punetebrendshme.gov.al/al/newsroom/fjalime/prezantohet-projekti-i-regjistrimit-te-adresave-dhe-shtetasve-popullimi&page=2>

⁶ Ligji Nr. 89/2016, <https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2016/07/liqi-nr-89-dt-15-9-2016.pdf>

⁷ Shih deklaratën e Ministrit të Brendshëm për nisjen e procesit, <http://www.punetebrendshme.gov.al/al/te-rejat/lajme/vlore-tahiri-nis-procesi-i-popullimit-punesohen-1200-te-rinj-per-regjistrimin-e-shqiptareve>

⁸ Si rezultat u kërkua të shtyhej afati, <http://www.panorama.com.al/adresat-e-reja-kaos-ne-zyrat-e-gjendies-civile-nga-sot-nis-vendosja-e-gjobave/>

⁹ Intervistë me Loran Sevi, Ministria e Brendshme, tetor 2017.

¹⁰ Projekti zbatohet nga Ministria e Brendshme dhe detyra e Operatorit në këtë kontekst ishte të ndihmonte me informacione për banesat/ndërtesat me të cilët kompania ka kontratë për furnizimin me energji elektrike. Intervistë telefonike me Adri Kola, tetor 2017.

¹¹ Diskutimet në fokus grupe u realizuan me të rinj (30 gusht 2017), femra (31 gusht 2017) dhe pjesëmarrës nga zonat e largëta dhe rurale (4 shtator 2017).

4. Regjistri i njoftimeve dhe konsultimeve publike

Teksti i angazhimit:

Titulli: Krijimi i një regjistri elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike

Krijimi i regjistrit për njoftimet dhe konsultimet publik i përket zbatimit të Ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik".

Në këtë kontekst, ky sistem është hartuar si seksion në formën e një forumi unik virtual interaktiv në portalin e shërbimeve qeveritare e-Albania.al. Çdo institucion vendimmarrës dhe ligjvënës, nëpërmjet një përdoruesi që do të veprojë si koordinator i institucionit, do të publikojë për konsultim me qytetarët dhe grupet e interesit çdo projekt ose draft para miratimit të tij.

Përfshirja e këtij regjistri unik qeveritar tek portali e-Albania.al dhe përfshirja e sistemit të konsultimit publik brenda tij do të rrisë familjarizimin dhe aksesin e qytetarëve në sistem.

Ky investim synon të rrisë transparencën dhe angazhimin e publikut në qeverisje për të përmbushur nevojat për krijimin e sistemit funksional për njoftim dhe konsultim publik.

Përmes këtij regjistri do të sigurohen aksesin dhe mundësia e komunikimit të të gjitha palëve të interesuara. Kjo formë siguron dhe forcon barazinë për sa i përket aksesit në informacion dhe shërbime, duke marrë parasysh nevojat specifike të individëve ose grupeve të caktuara. Ky angazhim synonte edhe rritjen e transparencës dhe të angazhimit të publikut në qeverisje.

Institucioni përgjegjës: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)

Institucion(et) mbështetës(e): Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike; Ministrinë e linjës

Data e fillimit: 2016

Data e mbarimit: 2018

Përmbledhje e angazhimit	Detajimi				Lidhja me vlerën PQH				Ndikimi i mundshëm				Në kohë?	Zbatimi			
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi në Informacion	Pjesëmarrja qytetare	Llogaridhënia publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues		Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar
4. Regjistri i njoftimeve dhe konsultimeve publike		✓			✓	✓		✓			✓		Po				✓

Konteksti dhe Objektivat

Përfshirja e qytetarëve në politikë dhe vendimmarrje është njëkohësisht sfidë dhe mundësi e rëndësishme për demokracinë me pjesëmarrje në Shqipëri. Në vitet e fundit vendi ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të përfshirë qytetarët në qeverisjen qendrore dhe vendore. Ligji "Për njoftimin dhe konsultimin publik" u

kërkon të gjitha autoriteteve publike që të konsultohen me qytetarët për projektligjet ose dokumente strategjike dhe të caktojnë koordinatorët për konsultimet publike. Miratimi i ligjit për ngritjen e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (nëntor 2015) siguroi kuadrin për konsultime më të strukturuar me organizatat e shoqërisë civile (OSHC). Sidoqoftë, në kohën e përgatitjes së këtij raporti, Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile i duhet ende kohë për t'u bërë një forum proaktiv.

Raporti i Komisionit Evropian (KE) për Shqipërinë, i botuar në vitin 2016, arriti në përfundimin se zbatimi efektiv i ligjeve për të drejtën e informimit dhe i konsultimeve publike mbetet një sfidë, veçanërisht në nivel vendor.¹ Në vitin 2016, vetëm 22 për qind e shqiptarëve kanë raportuar se kanë qenë pjesë e konsultimeve publike në nivel vendor.² Përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe publiku në përgjithësi mbeten skeptikë rreth konsultimeve publike, të cilat ata i konsiderojnë si procese formale të kryera nga institucionet shtetërore dhe që nuk marrin parasysh opinionet e tyre në fazën përfundimtare. Në vitin 2015 u krijua një portal për konsultime publike, pas miratimit të Ligjit "Për njoftimin dhe konsultimin publik". Ky portal është monitoruar nga aktorët e shoqërisë civile, të cilët kanë evidentuar një sërë shqetësimesh. ResPublica, një organizatë joqeveritare me qendër në Tiranë, raporton se gjatë periudhës nëntor 2015 - maj 2016 vetëm 5 për qind e autoriteteve publike të monitoruara kishin emëruar Koordinatorin e Konsultimit Publik dhe vetëm 8 për qind e autoriteteve publike të monitoruara kishin përgatitur regjistra publikë për projektligje apo akte të tjera nënligjore që janë subjekt i konsultimeve publike. Në portalin www.konsultimipublik.gov.al/, ResPublica raportoi se faqja e internetit ishte online, por asnjë regjistër nuk funksiononte.³

Përfshirja e një portali të ri të konsultimeve publike në këtë kontekst paraqet një masë të rëndësishme për rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje duke përdorur teknologjinë e informacionit dhe komunikimit. Nëse zbatohet plotësisht, ky angazhim do të përmirësonte ndjeshëm transparencën e institucioneve dhe proceseve të tyre duke rritur angazhimin publik, të cilin hulumtuesi MRP mendon se do të ketë ndikim të mundshëm të moderuar. Përveç kësaj, portali do të mundësonte edhe aksesin e publikut tek informacioni për projektligjet në faza të ndryshme përpara se ato të arrijnë në Parlament dhe, rrjedhimisht, të përmirësojë pjesëmarrjen qytetare duke i ofruar publikut një sistem konsultimi. Ky forum interaktiv është i rëndësishëm për vlerat OGP për aksesin tek informacioni, pjesëmarrja qytetare, teknologjia dhe inovacioni.

Angazhimi identifikon qartë qëllimin e tij për të krijuar një portal për njoftimet dhe konsultimet publike të projektligjeve; megjithatë, ai nuk liston hapat e matshëm që do të çonin në krijimin përfundimisht tek ky regjistër elektronik. Prandaj, detajimi i këtij angazhimi është i ulët.

Zbatimi

Regjistri për njoftim publik dhe konsultimi u përditësua dhe u integrua në portalin e-Albania, në kohë, në vitin e parë të planit të veprimit. Portali përfshin një seksion për konsultimet me qytetarët dhe një seksion të veçantë për konsultime me ekspertë. Hulumtuesit MRP nuk u iu dha informacione për numrin e përdoruesve të regjistruar në portalin.

Ndërlidhja me e-Albania shërben si për regjistrimin dhe identifikimin e përdoruesve për portalin. Nuk kërkohet regjistrim për të aksesuar aktet sipas procedurës së konsultimit publik në www.konsultimipublik.gov.al. Megjithatë, regjistrimi është i detyrueshëm nëse viziton dëshiron të bëjë komente për aktet nën konsultim.

Rezultatet e para (nëse ka)

Edhe pse zbatimi i këtij angazhimi u krye në kohë, rezultatet e tij janë zhgënjyese. Nga qytetarët apo ekspertët nuk u bë asnjë koment nëpërmjet këtij portali për asnjë

nga 15 projektligjet dhe projekt strategjive, të cilat u publikuan për konsultime publike gjatë vitit 2017. Ka disa arsye për nivelin e ulët të komenteve: shumë pjesëmarrës në fokus grupet e organizuara nga Hulumtuesi MRP nuk ishin në dijeni të portalit. Ata pak vetë që ishin të informuar (përfaqësuesit e OShC-ve vendore) sugjeruan se arsyet kryesore për mangësinë e komenteve kufizuar ishin kushti për t'u regjistruar në portalin e-Albania dhe mungesa e ndërgjegjësimit publik për portalin.

Hapat e mëtejshëm

Pavarësisht rezultateve dhe ndikimit që mungojnë gjatë vitit të kaluar, portalin www.konsultimipublik.gov.al mbetet një mundësi e rëndësishme e konsultimit publik online. Sidoqoftë, nevojitet të ndërmerren disa hapa të tjera për të rritur përdorimin dhe dobinë e portalit.

- Që portalin të jetë më i suksesshëm, ai duhet të promovohet më shumë tek qytetarët. OSHC-të kanë përdorur mediat sociale për të informuar qytetarët për portalin. Megjithatë, Hulumtuesi MRP rekomandon që në fushatat publike të përdoren edhe mediat tradicionale.
- Për të përmirësuar kuadrin e konsultimit publik, qeveria duhet të bëjë më shumë përpjekje duke hartuar procedura ligjore që rregullojnë angazhimin publik në hartimin e politikave. Kur publikon projektligje, qeveria duhet të ofrojë afate të përshtatshme kohore për konsultime, të krijojë rregulla të qarta për të orientuar konsultimet dhe të reagojë ndaj komenteve të qytetarëve.

¹ Raporti i KE për Shqipërinë, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf

² "Analizë e Angazhimit Politik në Shqipëri" (IDM 2016) faqe 24, [https://www.ndi.org/files/IDM%20Audit%20of%20Political%20Engagement%20\(Shqip\).pdf](https://www.ndi.org/files/IDM%20Audit%20of%20Political%20Engagement%20(Shqip).pdf)

³ "Konsultimi publik, sfidat e vitit të parë të zbatimit të ligjit -" (Res Publica qershor 2016), <http://www.respublica.org.al/wp-content/uploads/2016/07/konsultimi-publik-sfidat-e-vitit-te-pare-te-zbatimit-te-ligjit.pdf>

5. Arkiva Dixhitale

Teksti i angazhimit:

Angazhimi i propozuar nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit ka si objektiv të përgjithshëm monitorimin e respektimit të zhvillimit të Axsendës Dixhitale në Shqipëri dhe standardeve të pranuar teknologjike të referuara nga organe të ngjashme në vendet e tjera të BE-së si dhe nga institucionet homologe në vend. Arkivi duhet të kthehet në një aset me bazë teknologjike për akses tek informacioni, i konvertueshëm dhe i krahasueshëm me arkivat e ngjashme evropiane, duke përmirësuar efektivitetin e shërbimit që u ofrohet qytetarëve përmes:

- Ofrit të shërbimeve në internet/intranet nëpërmjet aksesit për qytetarët/subjektet dhe palët e tjera të interesuara që i kërkojnë këto shërbime, akses tek mundësitë materiale në internet.
- Krijimit të mundësive për publikimin e shërbimeve teknologjike dhe infrastrukture, përfitimeve në kohë reale në uljen e kostove të shërbimeve, proceseve njerëzore të automatizuara për kursimin e energjisë.
- Reduktimit të përdorimit të dokumenteve dhe materialeve të tjera arkivore të origjinalit duke rritur shkallën e përdorimit të tyre në formë elektronike.

Institucioni përgjegjës: Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit/Ministria e Zhvillimit Urban

Institucion(et) mbështetës(e): N/A

Data e fillimit: 2016

Data e mbarimit: 2018

Shënim redaksional: Për të lexuar të gjithë tekstin e angazhimit, lutemi referojuni https://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_NAP3_ENG.pdf.

Përmbledhje e angazhimit	Detajimi				Lidhja me vlerën PQH				Ndikimi i mundshëm				Në kohë?	Zbatimi			
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi në Informacion	Pjesëmarrja qytetare	Llogaridhënia publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues		Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar
5. Arkiva Dixhitale		✓			E paqartë					✓			Jo		✓		

Konteksti dhe Objektivat

Zhvillimi i sektorit privat mbetet prioritet për qeverinë shqiptare. Në prill të vitit 2015, qeveria miratoi "Axsendën Dixhitale", ku përfshihen hapa për rritjen e inovacioneve të biznesit, krijimin e inkubatorëve për TIK, rritjen e IHD-ve dhe rritjen e konkurrueshmërisë dhe zhvillimin ekonomik në vend¹. Qëllimi kryesor i kësaj mase ishte ulja e shpenzimeve përmes bashkëpunimit, ndarjes së infrastrukturës dhe sinergjive. Ky angazhim ndërtohet mbi këtë punë dhe ka si objektiv të përgjithshëm

monitorimin e përputhjes me Axiendën Dixhitale dhe standardet e tjera të njohura teknologjike në vendet e Bashkimit Evropian.

Aktualisht, Arkivi Teknik Qendror i Ndërtimit, një nga agjencitë kryesore të zbatimit, është i vetmi institucion në Shqipëri që mbledh dhe menaxhon dokumentet teknike të ndërtimit. Baza e saj e të dhënave nuk është e kompjuterizuar, gjë që çon në rritjen e shpenzimeve për qytetarët (që shkojnë në Tiranë për të aplikuar dhe marrë dokumentacion në Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit) dhe vonesat në marrjen e materialit të kërkuar (sepse qytetarët do të duhet të udhëtojnë personalisht).

Ky angazhim zhvillon një arkiv dixhital si aset të bazuar në teknologji për akses informacioni, të konvertueshme dhe të krahasueshme me arkivat e ngjashme evropiane. Plani i veprimit sugjeron që ky angazhim do të përmirësojë efektivitetin e shërbimeve publike në tri mënyra: së pari, do të sigurojë akses tek shërbimet dhe materialet online (përmes Internetit/Intranetit) për qytetarët, subjektet dhe palët e tjera të interesuara që kërkojnë këto shërbime. Së dyti, do të ulë shpenzimet për institucionet shtetërore dhe bizneset e përfshira në dhënien e lejeve të ndërtimit të cilët, deri në këtë pikë, u duhej të printonin të gjitha dokumentet e nevojshme. Së treti, do të zvogëlojë përdorimin e dokumenteve dhe materialeve të tjera arkivore duke rritur shkallën e përdorimit të tyre në formë elektronike. Megjithatë nga përshkrimi i angazhimit sugjerohet se do të përmirësohen shërbimet ndaj qytetarëve, aty nuk shpjegohet se si qytetarët do të kenë akses tek arkivin dixhital dhe nëse ai është i destinuar për përdorim publik. Detajimi i këtij angazhimi është i ulët, sepse kërkon interpretim nga ana e Hulumtuesit MRP për të identifikuar se çfarë aktiviteteve do të ndërmerren për të zhvilluar dhe zbatuar arkivin siç përshkruhet në angazhim.

Pavarësisht rezultateve ambicioze, siç thuhet nga qeveria, MRP e konsideron këtë angazhim si me ndikim të mundshëm të vogël. Përveç detajimit të tij të ulët, ky angazhim do të sjellë ndryshime të vogla në mënyrën se si funksionojnë bizneset. Kompanitë e ndërtimit do të jenë në gjendje të aplikojnë më lehtë për një leje ndërtimi dhe individët do të jenë në gjendje të kenë akses tek harta online të pronave të tyre, edhe pse fokusi i këtij angazhimi është i kufizuar.

Ndonëse ky angazhim përbën një hap përpara në përmirësimin e shërbimeve qeveritare, përmes dixhitalizimit të arkivit teknik të ndërtimit, lidhja e tij me vlerat PQH është e paqartë. Arkivi dixhital nuk ka një element të ballafaqimit me publikun. Megjithatë arkivi nuk zbulon publikisht informacione ose nuk rrit cilësinë e informacionit, nuk ka lidhje me aksesin tek informacioni.

Zbatimi

Hulumtuesi MRP nuk mund të merrte asnjë informacion zyrtar për përfundimin e këtij angazhimi. Në kohën e përgatitjes së këtij raporti (gusht - tetor 2017) Qeveria shqiptare pësoi një proces ristrukturimi dhe, që nga shtatori 2017, Ministria e Zhvillimit Urban nuk ekziston më. Intervistat e Hulumtuesit MRP me ish stafin e Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe zyrtarët aktualë të Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit konfirmuan planet për të ndërtuar një arkiv digjital, por ata nuk ishin në dijeni se projekti ishte një angazhim PQH². Po ashtu, asnjë pjesëmarrës në fokus grupet MRP nuk ishte në dijeni të këtij angazhimi apo aktiviteteve të tij.

Në kohën e shkrimit të këtij raporti, niveli i përfundimit të këtij angazhimi ishte i kufizuar dhe prapa afatit. Hulumtuesit MRP munda të gjurmonte vetëm një vendim të Këshillit të Ministrave nr. 365, datë 26 prill 2017 "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore 'arkivi digjital i Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit'". Vendimi i KM miraton aktet nënligjore për të mundësuar krijimin e arkivit dixhital dhe tregon bazën e të dhënave si të ndërlidhur me bazat e të dhënave të tjera shtetërore dhe ofron të dhëna parësore dhe dytësore, siç përshkruhet në këtë angazhim, për palët e

interesuara (p.sh. institucionet shtetërore, qytetarët, bizneset dhe Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit).

Hapat e mëtejshëm

Ashtu siç është shkruart, ky angazhim nuk ka lidhje me vlerat PQH. Megjithatë, hulumtuesi MRP rekomandon që ai të vazhdohet më tej në planin e ardhshëm të veprimit, me kusht që të sigurojë akses të hapur për publikun dhe jo vetëm përmes kërkesës së një pale të interesuar. Përveç kësaj, Arkivi Dixhital duhet të jetë i ndërlidhur me portalin e-Albania përmes një shërbimi elektronik të nivelit të katërt, ndërkohë që siguron akses edhe për publikun. Aktualisht, portali e-Albania përfshin (tre) shërbime informative në lidhje me Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit³. Së fundi, nëse ky angazhim vazhdon më tej me synimin për të siguruar akses tek informacioni, duhet bërë më shumë punë për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe punonjësve të qeverisë për aktivitetet e këtij angazhimi dhe lidhjet e tij me PQH.

¹ Axhenda Dixhitale, <http://ec.europa.eu/docsroom/documents/22382/attachments/1/translations/en/renditions/native>

² Intervistat u kryen në shtator 2017.

³ Si portali e-Albania, <https://e-albania.al/SherbimiADISA.aspx?kodi=AL031021>; <https://e-albania.al/SherbimiADISA.aspx?kodi=AL031019>; dhe <https://e-albania.al/SherbimiADISA.aspx?kodi=AL031018>

6. Baza e të dhënave të kërkimeve shkencore

Teksti i angazhimit:

Titulli: Krijimi i një baze të dhënash për arkivimin dhe publikimin e fondeve dhe programeve të kërkimit në Shqipëri

Në Shqipëri ka fare pak (ose aspak) bashkëpunim mes komunitetit shkencor dhe sektorit privat si dhe mes komunitetit shkencor dhe institucioneve publike në lidhje me hartimin e politikave të bazuara në dëshmi. Një nga pasojat kryesore negative është mungesa e rezultateve të hulumtimeve të prodhuara në Shqipëri. Aktualisht, ka një sërë programesh në vend (me financim publik ose nga fondet e donatorëve) që mbështesin kërkimet. Por mungesa e një portali unik, i cili të përmbajë të gjitha rezultatet e kërkimeve dhe thirrjeve, pengon zhvillimin e këtij bashkëpunimi.

Qeveria shqiptare do të angazhohet që të maksimizojë aksesin tek informacionet lidhur me hulumtimet e financuara nga fondet publike dhe private për të nxitur një bashkëpunim më të madh mes komunitetit shkencor, institucioneve publike dhe sektorit privat. Aktivitetet e propozuara në këtë kontekst janë si më poshtë:

- Hartimi, miratimi dhe promovimi i standardeve të hapura për shkencën në Shqipëri.
- Zbatimi i legjisllacionit nëpërmjet një akti nënligjor për të mundësuar kërkimin me një ndalesë për botimet dhe të dhënat që rezultojnë nga puna shkencore e ndërmarrë nga institucionet dhe studiuesit shqiptarë (të mbështetur nga burime shqiptare dhe burime të tjera financimi).

Institucioni përgjegjës: Ministria e Arsimit dhe Sportit

Institucion(et) mbështetës(e): Agjencia për Kërkime, Teknologji dhe Inovacion (ARTI); Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)

Data e fillimit: 2016

Data e mbarimit: 2018

Përmbledhje e angazhimit	Detajimi				Lidhja me vlerën PQH				Ndikimi i mundshëm				Në kohë?	Zbatimi			
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi në Informacion	Pjesëmarrja qytetare	Llogaridhënia publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues		Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar
6. Baza e të dhënave të kërkimeve shkencore				✓	✓			✓			✓		Jo	✓			

Konteksti dhe Objektivat

Sipas Dokumentit të UNESCO-s për Programimin e Vendit, shkenca në Shqipëri ka nevojë për zhvillim¹. Ka mungesë bashkëpunimi mes komunitetit shkencor (d.m.th., sektorit privat dhe institucioneve publike) në lidhje me vendimet e politikave të bazuara në shkenca në Shqipëri. Pasojë negative e bashkëpunimit të

pamjaftueshëm është se hulumtimet e realizuara në Shqipëri rrallë ndikojnë në hartimin e politikave. Nga ana tjetër, politikat shtetërore të bazuara në dëshmi mbështeten në përfshirjen aktive të aktorëve të informuar, në cilësinë e hulumtimit dhe në aksesin e lirë tek produktet kërkimore.

Gjatë vitit të kaluar janë ndërmarrë disa iniciativa që fokusohen tek shkenca e hapur dhe krijimi i bazave të të dhënave me të dhëna të aplikuara e kërkimore shkencore. Në këto nisma bëjnë pjesë programi i inovacionit të kërkimit i financuar nga Bashkimi Evropian (BE) “Horizon 2020” për ngritjen e kapaciteteve dhe për rritjen e investimeve për kërkimet shkencore². Një tjetër nismë është “Shërbimet e të Dhënave të Evropës Juglindore”, nismë që synon të krijojë shërbime të reja të të dhënave për të kuruar dhe ruajtur të dhënat dixhitale të shkencave sociale dhe t’i bëjë ato të disponueshme pa pagesë për komunitetin kërkimor për analiza dytësore³. Grupi i punës i Këshillit për Bashkëpunimin Rajonal për shkencën e hapur me vendet e Ballkanit Perëndimor është një tjetër iniciativë.⁴

Qëllimi i këtyre nismave dhe i këtij angazhim PQH është ta sjellë Shqipërinë më afër standardeve evropiane të shkencës së hapur⁵. Në një vlerësim të vitit 2015 kryer nga Programi për Promovimin e Kërkimit Rajonal dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) në hartimin e programeve sociale duke u bazuar në dëshmi zbuluan mospërputhje mes dëshmimeve dhe politikave, sa i përket kohës, buxhetit dhe përmbajtjes. Përveç kësaj, raporti identifikon disa shqetësime serioze, përfshirë këtu saktësinë e të dhënave të prodhuara nga aktorë të ndryshëm dhe vështirësinë në përkthimin e dëshmimeve të programeve dhe zbatimin e tyre në terren.⁶

Pavarësisht numrit të programeve në vend dhe nismave shumëpalëshe, Shqipëria ende nuk ka një portal unik, ku të jepen të gjitha rezultatet e studimeve dhe thirrjeve. Kjo pengon bashkëpunimin mes komunitetit shkencor dhe institucioneve që hartojnë politikat. Ky angazhim synon të nxisë një kulturë politikash të bazuara në evidenca duke angazhuar burime kërkimore, duke ndarë rezultatet e hulumtimit dhe duke zhvilluar politika më të mira. Për më tepër, angazhimi nxit bashkëpunimin trepalësh (publik-qytetar-privat) për politika efikase dhe promovon standardet kërkimore shkencore. Ky angazhim synon ta përmbushë objektivin e tij nëpërmjet realizimit të dy hapave: e para është të hartojë, miratojë dhe të promovojë standarde të hapura për shkencën. E dyta është të hartojë legjislacionin për të mundësuar një portal kërkimesh me një ndalesë për të dhënat shkencore dhe botimet, dhe rrjedhimisht për të krijuar portalin. Të dyja aktivitetet janë të qarta dhe të verifikueshme dhe angazhimi i përgjithshëm konsiderohet shumë i detajuar.

Nëse zbatohet plotësisht, ky angazhim do të kishte një ndikim të moderuar tek kapacitetet dhe cilësia e hulumtimit në Shqipëri, në hartimin e politikave të bazuara në evidencave dhe në zbatimin efikas të politikave. Duke vendosur standarde të hapura shkencore dhe duke mundësuar krijimin e një portali me një ndalesë për botimet dhe të dhënat, Shqipëria po bën një hap të rëndësishëm drejt forcimit të aftësive dhe realizimit të hulumtimeve. Sidoqoftë, për një ndikim të mundshëm transformues duhet të bëhet më shumë për rritjen e cilësisë dhe integritetit të hulumtimeve nga aktorët publikë dhe privatë të shoqërisë civile.

Së fundi, ky angazhim ka lidhje me vlerat PQH të aksesit tek informacionet dhe teknologjia dhe inovacioni, sepse krijon një portal agregat për palët e interesuara për të aksesuar të gjitha hulumtimet shkencore të ndërmarra nga institucionet dhe studiuesit shqiptarë.

Zbatimi

Bazuar në Ligjin “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor” dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave të gushtit 2016⁷, “Për krijimin, përbërjen dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit dhe Inovacionit Shkencor” (AKKISH), Agjencia për Kërkime, Teknologji dhe Inovacione (AKTI) u riemërua si “Agjencia Kombëtare e Kërkimit dhe

Inovacionit Shkencor” dhe u transferua nën varësinë e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Gjatë vitit të kaluar, AKTI i transformuar u përball me sfida serioze sa i përket burimeve njerëzore dhe infrastrukturës, duke e bërë të vështirë përmbushjen e detyrave të veta.⁸

Përveç kësaj, ndërkohë që Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) është listuar si institucion mbështetës, IDM nuk u përfshi në këtë angazhim. Qeveria mendonte se OShC-ja që propozonte angazhimin do të ishte përgjegjëse edhe për zbatimin e tij. Ndonëse Hulumtuesit MRP nuk iu ofrua asnjë informacion për ecurinë e këtij angazhimi, edhe kërkimet e tjera nuk mund të evidentonin ndonjë përparim në zbatimin e asnjërit prej objektivave të angazhimit.

Hapat e mëtejshëm

Ashti si është përcaktuar edhe në planin aktual të veprimit të PQH, ky angazhim ka për qëllim të krijojë kuadrin e nevojshëm ligjor dhe institucional për një bazë të dhënash kombëtare me të dhëna kërkimore shkencore dhe aplikative si dhe për krijimin e portalit aktual. Megjithatë, duhet bërë më shumë punë për të ngritur plotësisht një portal funksional, që duhet të jetë vazhdim i këtij angazhimi.

Riformulimi i këtij angazhimi duhet të nisë nga autoriteti përgjegjës, duke marrë parasysh ndryshimet dhe kompetencat e fundit të AKKISH-it. Në vend që të mbështetet tek projektet e donatorëve të huaj, Ministria e Arsimit dhe AKKISH duhet të veprojë për miratimin e dokumenteve ligjore dhe të politikave për shkencë të hapur në përputhje me rekomandimin e Komisionit Evropian (KE) 2012, që përfshin miratimin e një kuadri institucional, i cili do të mundësojë në internet një bazë të dhënash me të dhëna kërkimore shkencore dhe aplikative të prodhuara në Shqipëri. Për më tepër, angazhimi duhet të identifikojë dhe të kërkojë bashkëpunimin dhe përfshirjen e institucioneve përkatëse, si universitetet, shoqatat dhe organizatat kërkimore, etj.

¹ UNESCO Country Programming, <http://unesdoc.unesco.org/images/0023/002330/233036E.pdf>

² Raporti i KE, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf

³ Shërbimet e të Dhënave të Evropës Juglindore, http://seedsproject.ch/?page_id=2

⁴ Programet KBR për aftësitë dhe lëvizshmërinë, <http://www.rcc.int/flagships/3/skills-and-mobility> dhe seminari për “Lëvizshmëria e hulumtuesit shkencor e hapur që kontribuon në ekselencën e hulumtimit” <http://www.rcc.int/news/203/researcher-mobility-and-open-science-contributing-to-research-excellence>

⁵ Në mënyrë të veçantë, rekomandimi i KE-së për aksesin dhe ruajtjen e informacionit shkencor (2012, https://ec.europa.eu/research/science-society/document_library/pdf_06/recommendation-access-and-preservation-scientific-information_en.pdf

⁶ Raport për tryezën e rrumbullakët “Përdorimi i evidencave shkencore në hartimin e politikave të mbrojtjes sociale në Shqipëri” (mars 2015), http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2014/10/Evidence-based-Policymaking-Roundtable_report.pdf

⁷ Këshilli i Ministrave, <http://www.kryeministria.al/al/newsroom/vkm/vendime-te-miratuara-ne-mbledhjen-e-keshillit-te-ministrave-date-31-qusht-2016>

⁸ Intervistë me ish punonjës dhe zyrtarë aktualë të ish AKTI-t gjatë 2016/2017.

7. Publikimi në internet i legjislacionit të qeverisë

Teksti i angazhimit:

Titulli: Publikimi në internet i legjislacionit në nivel qendror dhe vendor në sistemet e hapura dhe falas

Organizata Infocip mendon se aksesit tek legjislacioni qendror dhe vendor është një shërbim publik që nuk ka nevojë për përmirësime, pavarësisht kërkesave të qarta ligjore.

Angazhimi për publikimin në internet në sisteme të hapura dhe falas të legjislacionit kombëtar dhe vendor përfshin:

- Në lidhje me legjislacionin qendror, qeveria është e angazhuar për publikimin e legjislacionit në faqet zyrtare të ministrive të linjës, pa pagesë, në rubrikën “Legjislacioni”
- Në lidhje me legjislacionin vendor, Infocip ofron vendime.al si një platformë kombëtare online, unike në llojin e vet, që mund të përshtatet si mekanizëm raportimi.

Institucioni përgjegjës: Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore (MSHÇV)

Institucion(et) mbështetës(e): InfoCip

Data e fillimit: 2016

Data e mbarimit: 2018

Shënim redaksional: Për të lexuar të gjithë tekstin e angazhimit, lutemi referojuni https://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_NAP3_ENG.pdf.

Përmbledhje e angazhimit	Detajimi				Lidhja me vlerën PQH				Ndikimi i mundshëm				Në kohë?	Zbatimi			
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi në Informacion	Pjesëmarrja qytetare	Llogaridhënia publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues		Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar
7. Publikimi në internet i legjislacionit të qeverisë			✓		✓						✓		Jo		✓		

Konteksti dhe Objektivat

INFOCIP, një organizatë e shoqërisë civile me qendër në Tiranë, e konsideron aksesin tek legjislacioni i qeverisë qendrore dhe vendore si një shërbim publik. Edhe pse aksesit tek legjislacioni ofrohet dhe kërkohet sipas ligjit, legjislacioni i qeverisjes vendore nuk është në dispozicion të publikut tek të gjitha 61 bashkitë në Shqipëri. Një raport monitorimi i vitit 2016 i Lëvizjes MJAFT evidenton se gati 58 për qind e institucioneve të qeverisjes qendrore dhe vendore nuk iu përgjigjën kërkesave për informacion të bëra nga organizata. Për legjislacionin e qeverisjes vendore, sfidat

janë edhe më të ngutshme duke pasur parasysh faktin se shumë bashki, sidomos ato të vogla dhe të mesme, nuk kanë faqe zyrtare në internet.¹

Nga ana tjetër, sistemi aktual i ofrimit të legjislacionit të qeverisë është i fragmentuar dhe joefikas. Sipas legjislacionit në fuqi, legjislacioni kombëtar dhe aktet nënligjore të miratuara nga Qeveria duhet të publikohen në Fletore Zyrtare. Po ashtu, këto akte publikohen elektronikisht në portalin <http://www.qbz.gov.al>. Nga ana tjetër, pika 3 e nenit 18 të Ligjit "Për vetëqeverisjen vendore në Shqipëri" përcakton se aktet e miratuara nga këshillat bashkiakë duhet të publikohen në faqet e internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik, si dhe me mjete të tjera. Por për shkak se shumë bashki nuk kanë faqe zyrtare në internet, praktika e publikimit të legjislacionit vendas është e fragmentuar.

Gjatë hartimit të planit të veprimit 2016-2018, INFOCIP propozoi që qeveria shqiptare të angazhohet në publikimin e legjislacionit të qeverisë qendrore dhe vendore në internet tek të dhëna të hapura në sisteme të lira ose të hapura siç përcaktohet edhe në planin e veprimit. Ky angazhim përbëhet nga dy hapa. Së pari, për qeverinë qendrore, angazhimi përcakton se aktet nënligjore dhe akte të tjera ligjore të miratuara nga institucionet do të publikohen online në faqet e internetit të çdo ministrie, nën një titull të veçantë (legjislacioni). Së dyti, për qeverinë vendore, angazhimi ofron portalin vendime.al si një mekanizëm të mundshëm raportimi. [Vendime.al](http://vendime.al) është nismë e INFOCIP mbështetur nga donatorë të ndryshëm (p.sh. Ambasada Amerikane në Tiranë, National Endowment for Democracy, Projekti CIVILISC i financuar nga Bashkimi Evropian).

Nëse zbatohet plotësisht, ky angazhim do të ketë ndikimi të mundshëm të moderuar. Për legjislacionin e qeverisjes vendore, portalin vendime.al, i kombinuar me faqet e internetit të bashkive, adreson plotësisht nevojën për aksesin online të publikut tek vendimet e këshillave bashkiakë. Megjithatë, për legjislacionin e qeverisë qendrore, angazhimi nuk i kap të gjitha institucionet e këtij niveli qeverisës. Po ashtu, angazhimi është i paqartë për sa i përket përcaktimit të llojit të ligjeve, akteve nënligjore, vendimeve, rregulloreve, urdhrave, etj. që duhet të bëhen publike. Përveç kësaj, teksti i angazhimit i referohet vetëm publikimit të legjislacionit të qeverisë qendrore në faqet e internetit të Ministrisë, dhe jo në Fletoren Zyrtare. Është e paqartë se ku janë të angazhuara ministratë për publikimin e legjislacionit të tyre.

Ky angazhim trajton vlerën PQH të aksesit tek informacioni. Aktivitetet e angazhimit përqendrohen në miratimin e legjislacionit, i cili do të mundësojë rritjen e sasisë së informacionit dhe përmirësimin e cilësisë së informacionit. Megjithatë, për shkak se ky angazhim nuk ofron një mekanizëm për konsultim publik për legjislacionin e qeverisë qendrore apo vendore, ai nuk ka lidhje me pjesëmarrjen qytetare apo llogaridhënien publike.

Zbatimi

Është me rëndësi të theksohet se Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore (MSHÇV), institucioni drejtues, nuk ishte në dijeni të përgjegjësive të tij për këtë angazhim. INFOCIP, institucioni mbështetës në këtë angazhim, veprimi si organizmi kryesor i zbatimit. Përveç kësaj, MSHÇV nuk ishte në dijeni se ata ishin angazhuar të publikonin legjislacionin qendror në faqet zyrtare të ministrive të Linjës dhe në Fletoren Zyrtare. Ky keqkuptim e bëri të vështirë vlerësimin e zbatimit të këtij angazhimi, por bashkërendimi i dobët mes institucioneve nuk ka pasoja të drejtpërdrejta në kodifikimin e detajimit.

MSHÇV nuk ofroi informacion për ecurinë e këtij angazhimi dhe zbatimi u shënua si "nuk ka filluar" për aktivitetin e parë të angazhimit. Ecuria e zbatimit të këtij angazhimi nuk është e njëjtë për legjislacionin e qeverisë qendrore dhe asaj vendore. Edhe përpara se të ndërmerrej ky angazhim, shumica e faqeve të internetit të ministrive të qeverisë kanë pasur një rubrikë të titulluar "legjislacioni", që

përmbante informacione për aktet ligjore dhe nënligjore që rregullonin sektorët e autoritetit të tyre. Megjithatë, jo të gjitha faqet e internetit të ministrive e kishin këtë informacion. Ministritë e tjera përfshinin informacion të pjesshëm (p.sh. ligjet, por jo informacion të përditësuar për aktet e miratuara, siç janë urdhrat e ministrave, vendimet ose rregulloret).²

Për sa i përket legjislacionit të qeverisjes vendore, një raport monitorimi i 2017 nga INFOCIP konstaton se 41 nga 61 njësitë e qeverisjes vendore në Shqipëri (rreth 67 për qind) kanë publikuar vendimet e këshillit bashkiak, krahasuar me 12 NJQV (20 për qind) në vitin 2016. Plot 17 bashki publikojnë legjislacionin e qeverisjes vendore në faqen e tyre të internetit dhe tek vendime.al. Një tjetër grup prej 15 bashkish e publikojnë legjislacionin vendor vetëm tek adresa vendime.al. Shtatë bashki rrallë i publikojnë aktet e tyre në internet, ndërsa dy bashki publikojnë në internet vetëm titullin e vendimeve të këshillave bashkiakë.

INFOCIP ka raportuar se vendime.al e ka zgjeruar numrin e bashkive që publikojnë vendimet e tyre në këtë portal. Për më tepër, INFOCIP ka raportuar gjithashtu se portali kishte rreth 2.500-3.000 vizitorë unik në muaj në gjysmën e parë të vitit 2017 dhe një mesatare të përgjithshme prej 200,000 klikimeve në muaj.³

Rezultatet e para (nëse ka)

Hulumtuesit MRP nuk iu ofrua Informacion për përdorimin e rubrikës “legjislacion” në faqet e internetit të ministrive të linjës. Sidoqoftë, INFOCIP ka ofruar të dhëna të dobishme dhe të besueshme për përdorimin e portalit vendime.al.

OSHC-të dhe ekspertët e qeverisjes vendore janë në dijeni dhe po përdorin portalin vendime.al. Sidoqoftë, asnjë qytetar që mori pjesë në diskutimet në fokus grupe të kryera nga hulumtuesi MRP nuk kishte dijeni për angazhimin apo portalin e vendime.al.

Hapat e mëtejshëm

Ndërkohë që Shqipëria është ende në kohë për të publikuar legjislacionin e qeverisë qendrore deri në qershor 2018, realisht nuk ka kohë të mjaftueshme për të gjitha 61 bashkitë që të publikojnë aktet e qeverisjes vendore me të gjitha aktet e tjera ligjore në fuqi⁴. Hulumtuesi MRP rekomandon vazhdimin e këtij angazhimi në planin e ardhshëm të veprimit. Përveç kësaj, angazhimi duhet të riformulohet për të mundësuar përkufizime më të qarta të veprimeve dhe institucion/et përgjegjës(e) për zbatimin e tij. Në mënyrë të veçantë, qeveria e re që mori detyrën në shtator 2017 duhet të merren parasysh hapat në vijim:

- Të merren masa për të bashkuar të gjitha faqet e internetit të ministrive në një rubrikë të veçantë “legjislacioni”. Përveç kësaj, e njëjta duhet të aplikohet edhe për agjencitë e tjera shtetërore në nivel qendror.
- Institucioni përgjegjës të identifikojë llojet e akteve ligjore që do të publikohen. Aktualisht, mbetet e paqartë se cilat institucione qeveritare janë përgjegjëse për këto angazhime, duke qenë se MSHÇV nuk ekziston në kabinetin e ri të qeverisë.
- T’u bëhet kujtesë bashkive që të koordinohen me vendime.al dhe të shfrytëzojnë burimet tashmë të pasura të legjislacionit të qeverisjes vendore. INFOCIP po ndërmerr veprime për t’u bashkërenduar me qeverinë dhe donatorët (PNUD Shqipëri) që mbështet zbatimin e reformës territoriale dhe administrative.
- Të përfshihen mekanizma për konsultime publike gjatë hartimit të akteve nënligjore.
- Të ndërmerren veprime për ta bërë angazhimin të ketë më shumë lidhje me grupet e interesit (p.sh. bizneset, OSHC-të, mediat) përmes qartësisë më të

madhe për llojin e akteve nënligjore që do të publikohen në faqet e internetit të ministrive; dhe

- Të bashkërendohet puna me donatorët që mbështesin publikimin e legjislacionit vendor, një element i reformës territoriale dhe administrative (në fuqi që nga viti 2015) dhe të merret parasysh nevoja për përdorim më të përcaktuar portalit vendime.al.

¹ “Sfidat e njësive të qeverisjes vendore në luftën kundër korrupsionit”, Raport vlerësimi i IDM 2016, <http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2016/08/LGU-Anticorruption-English.pdf>

² Faqja e internetit e Ministrisë së Punëve të Jashtme nuk kishte një rubrikë të veçantë për "legjislacionin"; Ministria e Arsimit dhe Sportit përfshinte "legjislacionin" që lidhej vetëm me sportet, Data e referimit qershor 2017.

³ Intervista, raporte dhe aksesit tek skedarët u mundësua nga INFOCIP gjatë periudhës korrik-shtator 2017.

⁴ Projekti STAR 2 (Mbështetje për Reformën Territoriale dhe Administrative) mund të përdoret në këtë drejtim. Gjatë periudhës 2017 - mars 2019 projekti STAR 2 do të mbështesë publikimin e legjislacionit në internet (nga 2015 e tutje) për 31 bashkitë që nuk publikojnë akte e tyre në internet në bashkëpunim me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Informacioni i marrë nga zyrtarët e STAR 2 (shtator 2017).

8. Regjistri Elektronik i Koncesioneve

Teksti i angazhimit:

Titulli: standarde të hapura për kontraktimin, kontratat publike të publikohen në format të dhënash të hapura

Organizata “Instituti Shqiptar i Shkencave” (ISHSH) është organizatë që promovon të dhëna të hapura dhe transparencë, e angazhuar njëkohësisht edhe si anëtare e Koalicionit për Partneritetin e Qeverisjes së Hapur për Shqipërinë. Në këtë aspekt, ISHSH propozoi disa angazhime për qeverinë dhe partnerët e saj për t’u përfshirë në planin kombëtar të veprimit 2016-2018, përfshirë këtu publikimin online të kontratave të koncesionit dhe PPP në të cilat bën pjesë edhe Qeveria.

Institucioni shtetëror i përfshirë në këtë angazhim është Ministria e Ekonomisë, Zhvillimit, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes.

Qeveria shqiptare është e angazhuar për përdorimin e standardeve të hapura për kontraktim. Shtetet dhe aktorët kryesorë janë aktualisht të prirur për të bërë përpjekjeve për të pasur akses tek informacionet në lidhje me kontratat publike dhe për ecurinë e tyre deri në përfundimin e këtyre kontratave. Regjistri i Koncesionarëve duhet të ndërtohet në bazë të Ligjit “Për Koncesione dhe PPP”, dhe VKM vlerësohet të ofrojë një format të hapur të dhënash duke siguruar kështu edhe sekretin tregtar apo intelektual. Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve ka ndërmarrë këtë angazhim për të krijuar Regjistrin Elektronik të Koncesioneve dhe Partneritetit Publik-Privat sipas Ligjit nr. 125/2013, i ndryshuar, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 211, datë 16.03.2016 “Për krijimin dhe administrimin e Regjistrit Elektronik të Koncesioneve/PPP”.

Ky institucion është aktualisht në procesin e mbledhjes së të dhënave për të gjitha kontratat dhe koncesionet PPP nga të gjitha autoritetet kontraktuese në Republikën e Shqipërisë. Baza e të dhënave që do të krijohet si rezultat i këtij angazhimi do të jetë publik dhe i aksesueshëm për të gjithë.

Institucioni përgjegjës: Ministria e Ekonomisë, Zhvillimit, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes/Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve

Institucion(et) mbështetës(e): Instituti Shqiptar i Shkencave

Data e fillimit: 2016

Data e mbarimit: 2018

Përmbledhje e angazhimit	Detajimi				Lidhja me vlerën PQH				Ndikimi i mundshëm				Në kohë?	Zbatimi			
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi në Informacion	Pjesëmarrja qytetare	Llogaridhënia publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues		Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar
8. Regjistri Elektronik i Koncesioneve			✓		✓			✓			✓		Po		✓		

Konteksti dhe Objektivat

Korrupsioni është një problem serioz në Shqipëri dhe mbi dy të tretat e publikut besojnë se asgjë nuk mund të bëhet për të ulur korrupsionin¹. Gjatë disa viteve të fundit, media dhe organizatat e shoqërisë civile kanë ngritur disa akuza për korrupsion në lidhje me partneritetet publikeprivate (PPP) dhe koncesionet (p.sh. koncesionet për hidrocentralet, industrinë minerare, shërbimet e kujdesit shëndetësor)². Mungesa e transparencës dhe integritetit lidhur me koncesionet dhe PPP-të janë bërë shqetësime serioze. Publikimi i kontratave për koncesione dhe informacione të lidhura në një format të hapur të të dhënave do të përmirësojë ndjeshëm aksesin tek informacionet, mbikëqyrjen nga publiku dhe integritetin e institucioneve të përfshira në miratimin dhe menaxhimin e koncesioneve dhe PPP-ve.

Ky angazhim synon të përdorë standarde të hapura për kontraktimin për sa i përket krijimit nga Agjencia për Trajtimin e Koncesionit të një regjistri të koncesioneve, bazuar në Ligjin për Koncesione dhe PPP (d.m.th., Ligji nr. 125/2013, i ndryshuar, dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave 211, datë 16.03.2016 “Për krijimin dhe administrimin e Regjistrimit Elektronik të Koncesioneve/PPP”). Agjencia është aktualisht në procesin e mbledhjes së të dhënave për të gjitha kontratat dhe koncesionet PPP nga të gjitha autoritetet kontraktuese në Republikën e Shqipërisë. Baza e të dhënave që do të krijohet do të ketë standardet e të dhënave të hapura dhe do të jetë publik dhe i aksesueshëm për të gjithë. Për shkak se ky angazhim përshkruan objektivin e tij dhe një rezultat të verifikueshëm, detajimi i tij është i mesëm.

Nëse zbatohet plotësisht, ky angazhim mund të ketë ndikim të moderuar. Regjistri është një hap para drejt përmirësimit të transparencës, llogaridhënies dhe integritetit publik. Aktorët e shoqërisë civile të intervistuar nga hulumtuesi MRP kanë raportuar pritshmëri të mëdha nga ky angazhim, veçanërisht në luftën kundër korrupsionit dhe në përmirësimin e transparencës së qeverisë. Përveç kësaj, regjistri ndihmon në reformat e integritetit në Bashkimin Evropian (BE), duke e sjellë vendin më pranë anëtarësimit në BE.

Duke përdorur mjetet e TIK (regjistrin elektronik) për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, ky angazhim çon më tej vlerat PQH për akses tek informacioni duke bërë publike të dhëna kryesore dhe informacione rreth koncesioneve dhe PPP-ve të miratuara. Megjithatë, ky angazhim nuk përfshin një mekanizëm llogaridhënieje publike. Përveç rritjes së sasisë së të dhënave në dispozicion për koncesionet, nuk ka fakte që tregojnë se ky regjistër do të garantojë monitorimin e procedurave, koncesioneve dhe përfitimeve publike nga PPP-të. Angazhimi me të vërtetë transformues përfshin domosdoshmërisht një element të llogaridhënies ose dhënies së informacioneve për pronësinë e përfituesit ndaj proceseve koncesionare dhe kontraktuese gjatë kohës që ato po ndodhin dhe jo thjesht kur të ketë përfunduar gjithçka.

Zbatimi

Regjistri i Koncesioneve dhe PPP-ve nisi në fund të vitit 2016 nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve³. Nuk u bënë konsultime me shoqërinë civile, median, apo grupet e tjera të interesit në zbatimin e këtij angazhimi PQH. Në kohën e përgatitjes së këtij raporti, jo të gjitha kontratat ishin publikuar në regjistër dhe informacioni i dhënë nuk ishte në formatin e të dhënave të hapura. Rrjedhimisht, Regjistri nuk ka sjellë rezultatet e dëshiruara dhe as nuk ka bërë të mundur më shumë transparencë mbi koncesionet e dhëna. Burime të ndryshme të medias dhe grupe të shoqërisë civile, si Open Data Albania, vazhdojnë të ngrenë shqetësime lidhur me mungesën e informacioneve për koncesionet dhe PPP-të⁴. Ndonëse është ende brenda afatit, nuk ka gjasa që qeveria të jetë në gjendje ta zbatojë plotësisht këtë angazhim deri në

qershor të vitit 2018. Së fundi, është e rëndësishme të theksohet se Instituti Shqiptar i Shkencave, si institucion mbështetës në planin e veprimit, nuk u përfshi në këtë angazhim.

Rezultatet e para (nëse ka)

Regjistri i Koncesioneve dhe PPP-ve nuk publikon informacione në formatin e të dhënave të hapura, siç parashikohet në këtë angazhim. Drejtori i ISHSH, Aranita Brahaj thekson se nuk ka një metodologji për Regjistrin dhe një i interesuar duhet të vizitojë shumë portale. Për shembull, duhet të shkojë tek Regjistri i Prokurimeve Publike për të marrë informacione për procedurën e ndjekur për një PPP apo koncesioni të caktuar. Ose, duhet të shkojë në Regjistrin Kombëtar të Biznesit për të marrë informacione për ndryshimet e statusit të koncesionarëve ose institucioneve të tjera qeveritare me qëllim marrjen e informacionit për realizimin e koncesioneve (tatimet e paguara, fitimi i realizuar, etj.).⁵

Hapat e mëtejshëm

Në Regjistër nuk publikohen të gjitha kontratat dhe informacionet nuk publikohen në formatin e të dhënave të hapura. Përveç vazhdimit të zbatimit, publiku duhet të ketë dijeni për ecurinë e koncesioneve, sa paguan shteti, sa paguan koncesionari, cili është përfitimi i publikut dhe informacione të tjera. Me fjalë të tjera, duhet të zgjerohet fusha e informacionit të publikuar. Për të ardhmen, hulumtuesi MRP rekomandon që Agjencia e Prokurimit Publik (APP) të shqyrtojë hapat në vijim, në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave:

- Të rrisë numrin dhe cilësinë e të dhënave për secilin koncesion dhe PPP;
- Të kryejë konsultime me shoqërinë civile, mediat dhe grupet e tjera të interesit për të përmirësuar Regjistrin aktual dhe në vazhdimësi;
- Të përmirësojë Regjistrin e Koncesioneve dhe PPP-ve duke publikuar të gjitha kontratat në formatin e të dhënave të hapura në përputhje me Standardin e të Dhënave të Hapura për Kontratat;
- Ta lidhë Regjistrin me procesin e ankimit të Komisionit të Prokurimit Publik;
- Të forcojë sistemin e performancës dhe monitorimit të prokurimit elektronik dhe respektimin e tij si dhe të ofrojë raportimin për publikun dhe monitorimin e performancës.

Hulumtuesi MRP sugjeron që edhe rekomandimet e raportit të progresit të Komisionit Evropian (KE) të vitit 2016 të përfshihen në planin e ardhshëm të veprimit. Raporti prek çështjet e mëposhtme:

- Shqipëria duhet të harmonizohet më shumë me rregullat e prokurimit publik të BE-së, duke përfshirë rekomandimet për një regjistër kontratash për të gjitha kontratat publike dhe përmirësimet në proceset e dhënies së koncesioneve dhe menaxhimit dhe prokurimit të mbrojtjes;
- Ka mungesë të burimeve njerëzore të nevojshme në agjencinë e trajtimit të koncesioneve në Ministrinë e Ekonomisë dhe Tregtisë (vetëm 12 punonjës).⁶
- Me përafrimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor dhe me përmirësimin e akteve nënligjore që rregullojnë Regjistrin duhet të trajtohen shqetësimet e shoqërisë civile mbi dobinë e informacionit të Regjistrit dhe sasinë e informacionit që ofrohet në portal. Ndryshime të tilla duhet të përfshijnë aspekte që lidhen me formatin e informacionit (në të dhëna të hapura), llojin e informacionit (p.sh. të ardhurat, taksat e mbledhura) dhe aspekte të tjera që nuk janë të përcaktuara dhe të cilat do të bënin ndryshimin e vërtetë.⁷

¹ Shadow Power, http://seldi.net/fileadmin/public/PDF/Publications/RAR_2016/SHADOW_POWER_EN_FINAL.pdf

² Akuza për korrupsion, <https://www.reporter.al/prokuroria-nis-hetimet-per-koncesionet-multimilioneshe-te-begait/>

³ Për të aksesuar regjistrin, http://www.atrako.gov.al/?page_id=112

⁴ Të dhënat e hapura, <http://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/sq/id/1953/titull/>

[Pesekoncesionetefshehtategeveriseqjatekohessezgjedhieve/Pese-koncesionet-e-fshehta-te-geverise-giate-kohes-se-zgjedhieve](#)

⁵ Intervistë me Aranita Brahaj, Tetor 2017.

⁶ Raporti i KE për Shqipërinë 2016, faqe 37, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf

⁷ Në tetor 2017 në Regjistër ishin publikuar rreth 15 koncesione ku mbi 2/3 e tyre ishin të periudhës para vitit 2015.

9. Zbatimi i Ligjit për Sinjalizimet dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve

Teksti i angazhimit:

Titulli: Zbatimi i Ligjit për Sinjalizimet dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve, ngritje kapacitetesh, ndryshime ligjore dhe aktet nënligjore

Në maj të vitit 2014, Koordinatori Kombëtar i Anti-korrupsionit dhe Ministria e Drejtësisë, me ndihmën e qeverisë holandeze që u kanalizua përmes Universitetit të Utrehtit, filloi hartimin e ligjit "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve". Ky ligj shërben për të rritur transparencën e institucioneve publike dhe private duke krijuar një ambient më të mirë që punonjësit të denoncojnë rastet e korrupsionit.

Ligji përcakton veprat e lidhura me korrupsionin, përcakton kompetencat e mekanizmave të brendshëm si dhe përcakton se cili organ duhet të shërbejë si mekanizëm i raportimit të jashtëm dhe se si duhet të sigurohet mbrojtja e sinjalizuesve. Përveç kësaj, ligji zbatohet si për sektorin publik ashtu edhe për atë privat. Ai u miratua në Kuvend më 2 qershor 2016. Me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 9647, datë 20.06.2016, ligji u botua në Fletoren Zyrtare Nr. 115 më 23 qershor 2016 dhe hyri në fuqi më 8 korrik 2016. Efektet e tij ligjore zgjasin nga 1 tetori 2016 me përjashtim të efekteve juridike për keqtrajtimin e brendshëm për subjektet private, të cilat fillojnë më 1 korrik 2017 (Shënim: Ky ishte një angazhim i planit të dytë kombëtar të veprimit 2014-2016).

Objektivat për këtë angazhim në planin kombëtar të veprimit:

- *Hartimi i akteve nënligjore, udhëzimeve përkatëse dhe formave të raportimit për ndjekjen dhe hetimin nga ana e ILDKPKI-së për zbatimin e suksesshëm të këtij ligji;*
- *Konsultimet me palët e interesuara në Tiranë dhe rrethe të tjera për futjen e akteve nënligjore, konsultimet dhe rekomandimet e tyre;*
- *Ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve dhe asistencës teknike për stafin e ILDKPKI-së dhe të personelit tjetër të administratës publike për zbatimin e suksesshëm të ligjit, akteve nënligjore dhe rregulloreve, përgatitjen e përkrahjes së vendeve të punës për personelin përgjegjës për marrjen e sinjalizimeve dhe ndjekjes së tyre;*
- *Fushata ndërgjegjësimi dhe edukimi në media për ligjin dhe rëndësinë e zbatimit të tij në luftën kundër korrupsionit.*

Institucioni përgjegjës: Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore (MSHÇV)

Institucion(et) mbështetës(e): Partnerët Shqipëri, media, bizneset

Data e fillimit: 2016

Data e mbarimit: 2018

Shënim redaksional: Për të lexuar të gjithë tekstin e angazhimit, lutemi referojuni https://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_NAP3_ENG.pdf.

Përmbledhje
e angazhimit

Detajimi

Lidhja me vlerën PQH

Ndikimi i
mundshëm

Në
kohë?

Zbatimi

	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi në Informacion	Pjesëmarrja qytetare	Llogaridhënia publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues		Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar
★9. Implement Whistleblower Protection Law				✓	✓	✓	✓					✓	Po				✓

Shënim redaksional: Ky angazhim është i matshëm, me lidhje të qartë me vlerat PQH ashtu siç është shkruar, ka ndikim të mundshëm transformues, dhe zbatimi i tij është i konsiderueshëm ose i përfunduar.

Konteksti dhe Objektivat

Ligji për Sinjalizimet dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve, i cili ishte angazhim në planin e mëparshëm të veprimit të PQH, u miratua në qershor të vitit 2016¹. Ligji përcakton veprat e lidhura me korrupsionin, identifikon se cili organ duhet të shërbejë si mekanizëm i raportimit të jashtëm dhe përcakton mënyrën e sigurimit të mbrojtjes së sinjalizuesve. Ligji zbatohet si për sektorin publik ashtu edhe për atë privat. Ai hyri në fuqi në tetor 2016, me përjashtim të efekteve juridike për sinjalizimin e brendshëm për subjektet private, të cilat hynë në fuqi më 1 korrik 2017. Ligji ofron mbrojtje ligjore për punonjësit për të denoncuar rastet e korrupsionit.

Objekti i angazhimit, siç përcaktohet në planin e veprimit, është i dyfishtë: të rrisë numrin e denoncimeve për rastet e korrupsionit tek autoritetet publike dhe të mbrojë sinjalizuesit. Për të arritur këtë qëllim angazhimi parashikon katër aktivitete: miratimin e akteve nënligjore për të siguruar zbatimin e ligjit, konsultimin me grupet e interesit, përmirësimin e kapaciteteve të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktëve të Interesit (ILDKPKI), institucionit mbikëqyrës dhe ngritjen e ndërgjegjësim për sinjalizimet. Këto aktivitete krijojnë mjedisin e nevojshëm dhe mekanizmat institucionalë për zbatimin e ligjit. Nëse zbatohet plotësisht, ky angazhim i përgjithshëm mund të ketë ndikim të mundshëm transformues. Hartimi i akteve nënligjore, trajnimi i nëpunësve publikë dhe rritja e ndërgjegjësimit publik do të ndihmojnë në sigurimin e zbatimit efektiv të këtij ligji të rëndësishëm kundër korrupsionit.

Ky angazhim është shumë specifik. Me përjashtim të aktiviteteve dy dhe katër (d.m.th., konsultimi me grupet e interesit dhe rritjen e ndërgjegjësimit), të gjitha aktivitetet përcaktojnë qartë rezultate të matshme, qofshin ato që lidhen me hartimin e akteve nënligjore apo edhe me planifikimin e trajnimeve për ngritjen e ngritje e kapaciteteve.

Ky angazhim ka lidhje të veçantë me vlerat e PQH-së për aksesin tek informacioni, pjesëmarrje qytetare (përmes konsultimeve për projekt-aktet nënligjore) dhe llogaridhënien publike (përfundimisht, nëpërmjet rritjes së numrit të sinjalizimeve për korrupsionin dhe vepra të tjera penale në sektorin publik dhe privat).

Zbatimi

Angazhimi është zbatuar. Të gjitha aktivitetet e parashikuara në këtë angazhim janë përmbushur. Aktet nënligjore janë hartuar dhe miratuar pas mbajtjes së konsultimeve publike². Deri në nëntor 2016, të gjitha aktet nënligjore - përfshirë edhe Vendimin e Këshillit të Ministrave, Direktivat e ILDKPKI dhe Direktivën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale - u miratuan për të siguruar zbatimin e ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve.

Në gusht të vitit 2016 një OJQ lokale, Partnerët Shqipëri, nisi një ftesë publike për komentet dhe rekomandimet në lidhje me aktet nënligjore për Ligjin “Për sinjalizimet dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”³. Projektligjet u shpërndanë nëpërmjet faqes së internetit të Partnerëve Shqipëri, medias sociale dhe email-it. Në total, projektligjet u dërguan tek 1,100 organizata të shoqërisë civile, 250 biznese, 61 bashki, 120 institucione publike në nivel qendror dhe agjenci shtetërore, 165 përfaqësues të medias dhe 150 përfaqësues të donatorëve dhe agjencive ndërkombëtare të zhvillimit në Shqipëri. Partnerët Shqipëri organizoi konsultime publike në Tiranë. Konsultimet e kryera me institucionet e qeverisjes qendrore ishin të ndara nga ato të kryera me përfaqësuesit e sektorit privat, mediat dhe shoqërinë civile. Rreth 240 pjesëmarrës morën pjesë në konsultimet e mbajtura në Tiranë, Fier, Shkodër, Korçë dhe Elbasan në shtator 2016. Pjesëmarrësit vinin nga bashkitë dhe institucionet e tjera shtetërore, shoqëria civile, bizneset, mediat dhe aktorë të tjerë.⁴ Ngjarjet e konsultimit publik u koordinuan me ILDKPKI, Koordinatorin Kombëtar Anti-Korrupsion dhe Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Partnerët Shqipëri dhe ILDKPKI zhvilluan një sërë aktivitetesh për ngritjen e kapaciteteve. Raporti vjetor i vitit 2016 i ILDKPKI deklaroi se kurrikula për një seri Trajnimesh të Trajnerëve u përgatit në vitin 2016⁵. Ekspertët e Partnerëve Shqipëri zhvilluan trajnime për stafin e ILDKPKI në vitin 2017. Ky trajnim u organizua në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (SHSHAP). Pjesëmarrja e trajnerëve të kësaj shkolle u mundësoi pjesëmarrësve që të përmirësojnë aftësitë dhe kapacitetet e tyre për të vazhduar trajnimet për nëpunësit civilë në njësitë përgjegjëse për sinjalizimet në institucionet publike dhe në subjektet private.⁶

Në vitin 2017, Partnerët Shqipëri organizoi dy trajnime me rreth 80 punonjës nga njësitë përkatëse të institucioneve qendrore dhe vendore. Përveç kësaj, në përputhje me Memorandumin e Mirëkuptimit (MM) të nënshkruar në korrik 2016, Partnerët Shqipëri vazhdimisht ka ofruar asistencë teknike për ILDKPKI dhe institucionet e tjera shtetërore në të gjitha hapat institucionalë. U organizua edhe një udhëtim studimor në Holandë nga stafi i ILDKPKI në kuadër të projektit të Partnerëve Shqipëri. Kjo vizitë lehtësoi dialogun me institucionet kryesore holandeze përgjegjëse për zbatimin e ligjit të sinjalizimit. Gjatë kësaj vizite disa institucione qeveritare dhe kompani private ndanë përvojën e tyre në zbatimin e kuadrit ligjor dhe sfidat, duke përdorur një sërë rastesh ilustruese.

Për sa i përket angazhimit të katërt dhe përfundimtar të aktivitetëve, MSHÇV organizoi dy fushata - nisi fushatën për ngritjen e ndërgjegjësimit në mediat tradicionale dhe sociale dhe krijoi postera të informimit publik në qytetet kryesore shqiptare deri në korrik 2017. Aktivitetet e ndërgjegjësimit filluan në tetor 2016, paralelisht me hyrjen e ligjit në fuqi.⁷ Në mediat sociale dhe tradicionale u transmetua një spot televiziv informativ⁸ Ai ofron informacione për ligjin, cilat institucionet janë të detyruara ta zbatojnë atë, cilat janë dënimet për mosrespektimin e kërkesave të ligjit, përfitimin që ligji sjell në luftën kundër korrupsionit dhe të tjera. Në internet dhe në qendrat kryesore urbane, institucionet dhe hapësirat publike u shpërndanë materiale të tjera promovuese (p.sh. broshura, billborde dhe postera, reklama me video në YouTube dhe mediat sociale). Një fushatë tjetër sensibilizuese (e përbërë nga Spot 2, CTL, reklama video etj.) nisi në maj të vitit 2017 dhe aktualisht ofron informacione

për punonjësit institucional përkatës dhe popullatën në përgjithëso duke përfshirë procedurat, format konkrete të sinjalizimit në institucione, çfarë duhet bërë në raste të tilla, etj. Transmetimi i fushatës u realizua plotësisht gjatë periudhës qershor-korrik 2017.⁹

Në përgjithësi, hulumtuesi i IRM dëshiron të theksojë se organizata Partnerët Shqipëri ka luajtur një rol vendimtar në zbatimin e këtij angazhimi përmes një projekti të mbështetur nga Ambasada e Holandës në Tiranë.¹⁰

Rezultatet e para (nëse ka)

Angazhimi ka krijuar infrastrukturën e nevojshme ligjore dhe institucionale për zbatimin e ligjit, duke përfshirë trajnimet dhe aktivitete të tjera për ngritjen e kapaciteteve për njësitë që merren me sinjalizimet në institucionet publike. Megjithatë, është shumë shpejt që të presim raste konkrete të sinjalizimeve. Ekspertët e shoqërisë civile sugjerojnë se përparimi i mëtejshëm në zbatimin e reformës gjyqësore ka të ngjarë të inkurajojë denoncimin e rasteve të tilla për shkak të rritjes së besimit tek institucionet gjyqësore (dhe të tjera) që do të trajtojnë rastet e sinjalizuesve.

Zbatimi i këtij angazhimi në vitin e parë është mjaft inkurajues, veçanërisht në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar midis institucioneve shtetërore (MSHÇV, ILDKPKI) dhe organizatës së shoqërisë civile (Partnerët Shqipëri).¹¹

Zbatimi i këtij angazhimi në vitin e parë është mjaft inkurajues, veçanërisht në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar midis institucioneve shtetërore (MSHÇV, ILDKPKI) dhe organizatës së shoqërisë civile (Partnerët Shqipëri).

Hapat e mëtejshëm

Në vitin e dytë të zbatimit, hulumtuesi i MRP rekomandon Qeverisë të vazhdojë aktivitetet e ndërgjegjësimit dhe trajnimit për zbatimin e ligjit.

Përfundimi i planit aktual të veprimit (qershor 2018) përkon me fazat më të avancuara të reformës gjyqësore në Shqipëri, e cila pritet të rrisë besimin e publikut dhe integritetin e institucioneve. Duke pasur parasysh potencialin e lartë të ndikimit transformues, ky raport MRP rekomandon me këmbëngulje veprimet pasuese në planin e ardhshëm të veprimit. Institucionet përgjegjëse shtetërore, në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe aktorët e tjerë (p.sh. mediat), duhet të përqendrohen në monitorimin dhe zbatimin praktik të ligjit për sinjalizuesit në institucionet publike dhe private.

¹ Ligji për sinjalizimet dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, <https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2016/06/liqi-nr.-60-dt.-2.6.2016.pdf>

² Deri në nëntor 2016, ishin miratuar të gjitha aktet nënligjore dhe rregulloret për të siguruar zbatimin e Ligjit “Për sinjalizimet dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, si vijon: Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 816 datë 16 nëntor 2016 “Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe çështjet e punësimit të të punësuarve në njësitë e institucioneve publike përgjegjëse për zbatimin e Ligjit “Për sinjalizimet dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”; Direktiva e ILDKPKI “Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe trajnimin e punonjësve në njësitë e institucioneve private përgjegjëse për zbatimin e Ligjit “Për sinjalizimet dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”; Rregullorja e ILDKPKI mbi hetimin administrativ të kërkesës së paditësit për mbrojtje nga hakmarrja; Rregullorja e Brendshme e ILDKPKI mbi hetimin administrativ të rastit të sinjalizuesve dhe mbrojtjen e konfidencialitetit; Direktiva e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për kushtet, kriteret për përpunimin e të dhënave personale dhe afatin kohor në zbatimin e ligjit nr. 60/2016”.

³ Partnerët Shqipëri, <http://partnersalbania.org/News/konsultime-mbi-aktet-nenligjore-per-zbatimin-e-ligjit-per-sinjalizimin-dhe-mbrojtjen-e-sinjalizuesve/>.

⁴ Faqja në Facebook e Partnerëve Shqipëri, https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=10154488726133955&id=46227243954

⁵ Raporti 2016 i ILDKPKI, f. 12, www.hidaa.gov.al/raportet/Raporti%20Vjetor%202016-%20ILDKPKI.docx

⁶ U krijuan gjithsej 155 njësi në institucionet e qeverisë qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore gjatë periudhës së raportimit, Intervistë me Arjola Agolli, Shtator 2017.

⁷ Intervistë me zyrtar të ILDKPKI, Shtator 2017.

⁸ Spoti televiziv, <https://youtu.be/HzHMUgdQF0s>

⁹ Spot u transmetua nga mediat kombëtare dhe lokale (TV Klan; ABC News, Top Channel, Ora News, TVSH, Vizion Plus) dhe në media sociale. Organizata Partnerë Albania ka komunikuar me disa media për të organizuar gjatë kësaj periudhe zbatimi intervista televizive dhe pjesëmarrje në programe TV për këtë nismë në kanalet News 24 TV, Scan TV, Vizion Plus TV, Gazeta Shqiptare, etj.

¹⁰ Shqyrtim i dosjes së projektit, mundësuar nga Partnerë Shqipëri.

¹¹ Intervistë me Arjan Dymishi, Koordinator i Koalicionit të Evropës Juglindore për mbrojtjen e sinjalizuesve, gusht 2017.

10. Ofrimi i shërbimeve elektronike

Teksti i angazhimit:

Ky angazhim synon të ofrojë shërbime përmes një sistemi të menaxhimit të formularëve elektronikë (e-forms). Ky system do t'i ndihmojë institucionet e përfshira në këtë angazhim të reduktojnë proceset e punës manuale me letër, gjë që është shumë më e ngadalshme sesa përpunimi elektronik i informacionit duke përdorur mjetet elektronike të komunikimit me qytetarët. Po ashtu, sistemi do t'i ndihmojë qytetarët dhe bizneset të ulin kohën e nevojshme për marrjen e shërbimeve. Koha e përpunimit të formularit reduktohet, sepse formularët elektronikë dorëzohen në format elektronik. Sistemi do të rrisë efikasitetin e punonjësve të qeverisë, të cilët do t'u shërbejnë qytetarëve më shpejt dhe më mirë.

Institucioni përgjegjës: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

Institucion(et) mbështetës(e): Ministritë e linjës dhe institucionet e tyre të varësisë, autoritetet vendore, institucionet e pavarura. Në total, janë mbi 85 institucione që ofrojnë shërbime nëpërmjet portalit e-Albania.

Data e fillimit: 2016

Data e mbarimit: Dhjetor 2017

Shënim redaksional: Për të lexuar të gjithë tekstin e angazhimit, lutemi referojuni https://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_NAP3_ENG.pdf.

Përmbledhje e angazhimit	Detajimi				Lidhja me vlerën PQH				Ndikimi i mundshëm				Në kohë?	Zbatimi			
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi në Informacion	Pjesëmarrja qytetare	Llogaridhënia publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues		Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar
10. Ofrimi i shërbimeve elektronike		✓			E paqartë					✓			Po				✓

Konteksti dhe Objektivat

Ky angazhim bazohet në dy planet e fundit të veprimit. Plani i parë i veprimit (2012) krijoi portalin e-Albania, një portal qeveritar që ofron shërbime elektronike. Ndërsa plani i dytë i veprimit (2014) kishte tre angazhime të veçanta, përfshirë këtu zbatimin e një moduli të shpenzimeve publike dhe përmirësimin e shërbimeve publike. Ky angazhim synon të rrisë numrin e shërbimeve elektronike dhe të përmirësojë shërbimet aktuale në nivelin e tre dhe katër, që do të thotë se shërbimet publike do të ofrohen tërësisht në internet. Po ashtu, ky angazhim synon të zgjerojë funksionin e interoperabilitetit (ndërveprueshmërisë) të ofruar nëpërmjet portalit e-Albania. Me fjalë të tjera, ky funksion do të lejonte sisteme të ndryshme të teknologjisë së informacionit për të komunikuar e shkëmbyer të dhëna dhe për të përdorur informacionin që është shkëmbyer.

Aktualisht, portali e-Albania ofron 248 shërbime elektronike në nivelet tre dhe katër. Institucioni përgjegjës, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), do të ndërtojë një sistem të menaxhimit të formularëve elektronikë (e-forms) për të ndihmuar institucionet publike në uljen e numrit të dokumenteve dhe reduktimit të kohës që u duhet qytetarëve dhe bizneseve për të marrë shërbime. Përveç kësaj, AKSHI do të dixhitalizojë 36 shërbime të Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ) dhe do të sigurojë standardizimin e faqet në internet të çdo konsullate. Duke pasur parasysh numrin e madh të emigrantëve shqiptarë jashtë vendit në Evropë dhe gjetkë (rreth 1.4 milionë), shërbimet konsullore janë një masë e mirëpritur. Një projekt i dytë i AKSHI-t që plotëson këtë angazhim është shërbimi e-leje (lejet elektronike), i cili do të krijojë mundësinë për të aplikuar online për leje ndërtimi përmes portalit e-Albania.

Pavarësisht përmirësimit të aksesit të shërbimeve administrative për qytetarët, ndikimi i mundshëm i këtij angazhimi, siç përshkruhet në planin e veprimit, është i vogël. Aktivitetet e listuara nuk i avancojnë vlerat PQH përtej përgjegjësisë rutinë të institucioneve të ngarkuara me “popullimin” me shërbime të portalit e-Albania.

Ky angazhim ka detajim të ulët. Edhe pse teksti i angazhimit shpjegon se cili është objektivi (d.m.th., dhënia e shërbimeve përmes një sistemi të ri) dhe shtjellon rezultatet e synuara, ai nuk jep detaje lidhur me hapat e ndërmarrë për të arritur angazhimin dhe se si mund të maten këto hapa.

Lidhja e këtij angazhimi me vlerat PQH është e paqartë. Angazhimi nuk përfshin asnjë mekanizëm që do të ofronte informacione të reja për qytetarët ose që do të krijonte mundësi të reja për qytetarët për të ndikuar në vendimmarrje. Fokusi kryesor i këtij angazhimi është përmirësimi i ofrimit të shërbimeve dhe jo qeverisja e hapur.

Zbatimi

Hulumtuesit MRP nuk iu ofrua asnjë informacion për ecurinë e këtij angazhimi. Nga monitorimi i kryer nga hulumtuesi gjatë vitit 2016 u përcaktua se shërbimet elektronike konsullore nuk ofroheshin ende nga MPJ. Në fillim të vitit 2017, të 36 shërbimet e MPJ-së me funksionin e ndërveprueshmërisë ofroheshin në portalin e-Albania¹ dhe në faqen e internetit të MPJ-së në SHKO-Shërbimet Konsullore Online.² Megjithatë, disa shërbime ofroheshin vetëm për shtetasit shqiptarë që jetojnë në Itali. Gjatë muajit gusht të vitit 2017, hulumtuesi MRP konfirmoi se shërbimet ishin funksionale përmes aplikimeve testuese nga emigrantë shqiptarë që banonin në Gjermani dhe Itali. Përveç këtyre shërbimeve, e-Albania ofron edhe katër shërbime informimi (duke mos përfshirë këtu modulën “aplikimi online”).

Gjatë periudhës së raportimit (2016-2017) faqet e internetit të të gjitha përfaqësive diplomatike dhe konsullore shqiptare jashtë vendit u standardizuan³ dhe kishin edhe një video të vendndodhjes virtuale në 3D.⁴ Edhe lidhjet me shërbimet konsullore online u bënë pjesë e faqeve të standardizuara.⁵

Shërbimet e lejeve elektronike u ofruan në portalin e-Albania në kohën e hartimit të planit të veprimit, por kjo ishte vetëm për njësitë e qeverisjes vendore që kanë të miratuar planet vendore urbane.⁶ Raporti vjetor i AKSHI-t për vitin 2016 tregon se nga 1 shtatori 2016, aplikimet për leje ndërtimi bëhen vetëm online.⁷ Gjithsesi, përdorimi në vitin 2016 ishte i ulët, siç raportohet nga subjektet private sidomos në bashkitë e vogla dhe të mesme.⁸ Megjithatë, deri në fund të vitit 2016, ishte arritur objektivi i 390 shërbimeve.⁹

Rezultatet e para (nëse ka)

Pjesëmarrësit në diskutimet e fokus grupeve MRP konfirmuan se në dijeni për disa nga këto shërbime të ofruara në e-Albania. Megjithatë, asnjëri prej tyre nuk i kishte përdorur shërbimet elektronike. Hulumtuesit MRP nuk mund të përcaktonte shpeshtësinë e përdorimit të lejeve elektronike ose informacioneve të tjera që lidhen

me ecurinë e këtij angazhimi. Raporti vjetor 2016 i AKSHI-t jep disa të dhëna për përdorimin e lejeve elektronike, por ato lidhen me muajin dhjetor 2015, përpara fillimit të këtij plani të veprimit. Shërbimi më i përdorur për lejet elektronike është “deklarimi paraprak i fillimit të punimeve” (33 për qind e aplikimeve) dhe leja e zhvillimit (27 për qind e aplikimeve).

Hapat e mëtejshëm

Një nga rekomandimet e raportit të mëparshëm MRP është zgjerimi i vazhdueshëm i shërbimeve të portalit e-Albania. Në rekomandime të tjera përfshihen: hartografimi i përdorimit dhe dobisë së tij dhe shtimi i një elementi për aksesin publik ose element të transparencës për të siguruar lidhjen e angazhimeve PQH të portalit e-Albania në të ardhmen. Një mundësi është zhvillimi i një moduli opinionesh dhe ankesash për t'u bërë të mundur përdoruesve të ngrenë çështje tek zyrtarët qeveritarë dhe të formojnë një komuniteti përdoruesish.

¹ Portali e-Albania, <https://e-albania.al/ekonsullata.aspx>

² SHKO-Shërbime Konsullore Online, <http://www.punetejashtme.gov.al/al/sherbime/sherbimet-konsullore-online>

³ Përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Shqipërisë, <http://www.punetejashtme.gov.al/al/perfaqesite-diplomatike/perfaqesite-shqiptare-ne-bote> dhe <http://www.ambasadat.gov.al>

⁴ Video e vendndodhjes virtuale 3D, <http://www.ambasadat.gov.al/greece/>

⁵ Shërbime konsullore online, <http://www.ambasadat.gov.al/italy/sq/sherbime-te-ambasadës>

⁶ Lejet e ndërtimit online, <http://gazeta-shqip.com/lajme/2016/02/25/lejet-e-ndertimit-online-hapat-per-te-aplikuar-ne-sistemin-e-ri/>

⁷ Shih Raportin Vjetor 2016 të AKSHI-t, f. 12, <http://akshi.gov.al/images/raporti%20vjetor%202016.pdf>

⁸ Intervistë me pronarin e një firme ndërtimit, Tetor 2017.

⁹ Shih <http://akshi.gov.al/images/raporti%20vjetor%202016.pdf>, <https://e-albania.al/esherbimet.aspx>

11. Thjeshtimi i aplikimit për lejet e ndërtimit

Teksti i angazhimit:

Titulli: Krijimi i sistemit shumëfunksional të centralizuar për lejet e ndërtimit

Ky angazhim parashikon krijimin e një sistemi shumëfunksional për të thjeshtuar procedurën e aplikimeve për leje ndërtimi dhe përpunimin e tyre duke u ofruar qytetarëve dhe bizneseve mundësinë për të aplikuar vetëm online për ato leje. Qëllimi i këtij projekti është ngritja e një sistemi shumëfunksional dhe i centralizuar për të thjeshtuar procedurat për aplikimin për licenca zhvillimi e ndërtimi, duke u ofruar qytetarëve dhe bizneseve mundësinë për të aplikuar në internet. Duke qenë një sistem i centralizuar ai ka për qëllim të aksesohet në mënyrë elektronike nga të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore dhe të gjitha institucionet e tjera të përfshira në procesin e vendimmarrjes përmes llogarive përkatëse. Ky projekt ka për qëllim të zbatojë komunikimin elektronik midis regjistrat të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit me të dhënat elektronike të institucioneve të tjera për të kontrolluar dhe/ose automatikisht revokuar të dhënat e aplikantëve përmes platformës së interoperabilitetit të qeverisë; si dhe të evidentojë statusin e aplikimit në çdo fazë të procedurës.

Kjo lloj lejeje ofrohet vetëm “jashtë linje” (offline) duke kërkuar që bizneset të marrin të dokumente shumta nga institucionet e tjera publike dhe të dorëzojnë çdo gjë në ambientet e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (me qendër në Tiranë). Ky proces përfshin përpjekje të mëdha dhe shumë kohë deri në dhënien e lejes.

Ky projekt ka për qëllim krijimin e regjistrat elektronik të komunikimit të AKPT-së me të dhënat elektronike të institucioneve të tjera për verifikimin ose automatizimin e bazës së të dhënave të aplikantëve, përmes platformës së interoperabilitetit të qeverisë dhe evidentimit të statusit të aplikimit në çdo fazë nëpërmjet sistemit eTracking. Po ashtu, ky projekt do të përshtatë regjistrin aktual sipas kërkesave të ndryshimeve të fundit ligjore. Sistemi do të futet për herë të parë në Shqipëri dhe do të përfshijë aplikacionin për aplikimet për leje zhvillimi përmes sistemit në internet. Ka shumë rëndësi bashkëpunimi i ngushtë me autoritetet vendore për të arritur këtë sistem shumëfunksional të centralizuar.

Institucioni përgjegjës: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

Institucion(et) mbështetës(e): Ministria e Zhvillimit Urban/ Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, njësitë e qeverisjes vendore

Data e fillimit: 2016

Data e mbarimit: 2016

Përmbledhje e angazhimit	Detajimi				Lidhja me vlerën PQH				Ndikimi i mundshëm				Në kohë?	Zbatimi			
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi në Informacion	Pjesëmarrja qytetare	Llogaridhënia publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues		Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar
11. Thjeshtimi i aplikimit për			✓		E paqartë						✓		Po				✓

Konteksti dhe Objektivat

Deri në fillim të vitit 2016, lejet e ndërtimit jepeshin vetëm “jashtë linje” (offline). Me qëllim marrjen e një lejeje ndërtimi, bizneseve iu duhej të merrnin shumë dokumente nga institucione të tjera publike dhe të dorëzonin çdo gjë në ambientet e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT) në Tiranë. Ky proces kërkonte shumë përpjekje dhe kohë të pamatë, veçanërisht për bizneset që ndodheshin jashtë Tiranës.

Ky angazhim ka për qëllim të vendosë komunikim elektronik mes regjistrit të AKPT-së dhe të dhënave elektronike të institucioneve të tjera publike. Ky sistem i centralizuar shumëfunksional do të përditësojë automatikisht të dhënat e aplikantëve, do të zhvendosë të dhënat përmes platformës së interoperabilitetit dhe do të evidentojë statusin e një aplikimi në çdo fazë të procedurës. Sipas planit të veprimit të PQH-së, ky projekt do të përshtatë edhe regjistrin aktual në përputhje me ndryshimet më të fundit ligjore. Kjo është hera e parë që në Shqipëri prezantohet një sistem i centralizuar për lejet e ndërtimit dhe që do të përkthejë plotësisht aplikimin për leje në një platformë online. Detajimi i këtij angazhimi, siç është shkruar, është i mesëm. Qeveria në mënyrë eksplicite përmend zhvillimin e një sistemi shumëfunksional dhe përfshin elementë të ndryshëm brenda sistemit, (d.m.th., e-Tracking). Megjithatë, produktet nuk janë qartësisht të matshme dhe është e paqartë se cilat ndryshime ligjore do të zbatohen në regjistrin aktual.

Përfaqësuesit e shoqatës së bizneseve të ndërtimit e kanë mirëpritur këtë projekt, megjithëse kanë ngritur shqetësime lidhur me zbatueshmërinë e tyre në bashki pa plane rregulluese territoriale të miratuara¹. Përfaqësuesit e institucioneve kryesore shtetërore dhe përfaqësuesit e institucioneve që mbështesin zbatimin e këtij angazhimi nuk ofruan ndonjë informacion për hulumtuesin e MRP. Ky angazhim është një hap i rëndësishëm për lehtësimin e operacioneve të kompanive të ndërtimit dhe për reduktimin e kostove gjatë procedurave për leje ndërtimi. Ndikimi i mundshëm i këtij angazhimi është i moderuar: qeveria po përmirëson ofrimin e shërbimeve dhe informatizon përfundimisht procedurën e aplikimit për leje ndërtimi për të reduktuar punën për bizneset.

Lidhja e këtij angazhimi me vlerat OGP është e paqartë. Edhe pse sistemi i centralizuar përmirëson procedurat, ai nuk përmirëson transparencën e tyre dhe as llogaridhënien e institucioneve. Përveç kësaj, sistemi nuk i ofron akses publikut tek informacionet që kanë të bëjnë me lejet e dhëna të ndërtimit dhe procedurat e ndjekura aty.

Zbatimi

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe AKPT e kanë raportuar këtë projekt si të përfunduar.² AKPT ka nxjerrë udhëzime për përdorimin e sistemit nga palët e interesuara.³ Në mars 2017, AKSHI raportoi se “sistemi ofron proces të informatizuar ku përfshihen të gjitha institucionet që kanë për detyrë të trajtojnë aplikimet e lejeve për ndërtim”. AKSHI vazhdoi me raportimin duke deklaruar se sistemi ishte përdorur 25000 herë nga qytetarët dhe bizneset dhe se kishte 1155 përdorues nga institucionet shtetërore (shërbimi civil) gjatë periudhës shtator-dhjetor 2016.⁴ Hulumtuesit MRP nuk iu dha informacion në lidhje me përdorimin e sistemit në gjysmën e dytë të vitit 2017.

Hapat e mëtejshëm

Ky angazhim është zbatuar plotësisht dhe hulumtuesi MRP rekomandon që ai të mos vazhdohet në planin e ardhshëm të veprimit. Ndërkohë që ka ndikuar pozitivisht bizneset që aplikojnë për leje ndërtimi, ky angazhim nuk ka lidhje me vlerat PQH dhe qeverinë e hapur.

¹ Intervistë me përfaqësues të shoqatës së ndërtuesve, qershor 2017.

² Projekti i AKSHI-t dhe AKPT-së i përfunduar, <http://www.azht.gov.al/al/newsroom/lajme/lejet-e-ndertimit-online-sherbimi-e-leje>

³ Manuali aplikimi në e-leje, http://www.azht.gov.al/files/news_files/17-02-28-03-25-26Manual_Aplikimi_ne_e-leje.pdf, manual teknik për nënshkrimin elektronik http://www.azht.gov.al/files/news_files/17-02-28-03-25-28Manual_Teknik_Nenshkrimi_Elektronik.pdf dhe lidhje tek video <https://www.youtube.com/watch?v=dyd1DbXqrTw>

⁴ Faqja 41 e raportit vjetor 2016 të monitorimit të "Strategjisë Ndërsektoriale të reformës në administratën publike", mars 2017, <http://dap.gov.al/images/DokumentaStrategjik/SNRAP%20Raporti%20Vjetor%202016%20Final%2016.03.2017.pdf>

12. Ngritja e sporteleve dixhitale

Teksti i angazhimit:

Titulli: Instalimi dhe shpërndarja e sporteleve dixhitale

Me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike që u ofrohen qytetarëve dhe promovimin e teknologjive më të fundit, AKSHI ka marrë iniciativën për të instaluar sportele (sportele) dixhitale në të gjithë vendin.

Prezantimi për herë të parë i sporteleve dixhitale do të mundësojë rritjen e transparencës në ofrimin e shërbimeve nga administrata. Përmes formës elektronike, AKSHI synon të përmirësojë disponueshmërinë, cilësinë dhe transparencën e shërbimeve publike dhe të zvogëlojë kohën e zbatimit të procedurave dhe shpenzimet e administratës publike.

Përmes shpërndarjes së sporteleve dixhitale, portali e-Albania synon të sigurojë akses dhe lundrim më të lehtë në internet për të gjithë qytetarët shqiptarë, të cilët mund t'i drejtohen në një pike të vetme të aksesit publike tek informacionet ose shërbime publike online që ofrohen përmes portalit unik të e-qeverisjes. Sportele dixhitale do të ofrojnë shërbime publike 24 orë në ditë në 7 ditë të javës.

Institucioni përgjegjës: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)

Institucion(et) mbështetës(e): bashkëpunim i ngushtë me sektorin privat

Data e fillimit: 2016

Data e mbarimit: 2017

Përmbledhje e angazhimit	Detajimi				Lidhja me vlerën PQH				Ndikimi i mundshëm				Në kohë?	Zbatimi			
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi në Informacion	Pjesëmarrja qytetare	Llogaridhënia publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues		Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar
12. Ngritja e sporteleve dixhitale		✓			E paqartë				✓				Po				✓

Konteksti dhe Objektivat

Me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike që u ofrohen qytetarëve dhe promovimin e teknologjive më të fundit, AKSHI ka marrë iniciativën për të instaluar sportele (kioska) dixhitale në të gjithë vendin.

Sportelet ose sportelet do të vendosen në hapësirat publike pranë institucioneve dhe qendrave tregtare. Duke vizituar këto sportele dixhitale, qytetarët do të jenë në gjendje të kenë akses tek portali e-Albania, portali i e-qeverisjes, 24/7. Përmes formës elektronike, AKSHI synon të përmirësojë disponueshmërinë, cilësinë dhe transparencën e shërbimeve publike dhe të zvogëlojë kohën e zbatimit të procedurave dhe shpenzimet e administratës publike. Me t'u futur në sistem, qytetarët do të jenë në gjendje të bëjnë pagesa, të marrin informacion në lidhje me shërbimet publike, certifikata të shtypura, etj.

Edhe pse ky angazhim rrit aksesin tek shërbimet elektronike për qytetarët, lidhja e tij me vlerat PQH është e paqartë. Ndërkohë që ky angazhim synon të rrisë cilësinë e aksesit, sasia aktuale e informacionit që ofrohet nuk ka pandryshuar dhe nuk përmirësohet as aksesin tek shërbimet elektronike për qytetarët që nuk kanë akses në internet (ose mjete të tjera të përdorimit të shërbimeve elektronike) në zonat e largëta apo rurale. AKSHI planifikon që sportelet dixhitale të shpërndahen vetëm në qendrat urbane, pranë bashkive ose institucioneve të tjera.

Detajimi i këtij angazhimi është i ulët. Edhe pse objektivi kryesor dhe rezultatet e synuara të këtij angazhimi janë të qarta, teksti i angazhimit nuk ofron hapa të matshëm që nevojiten për të përhapur sportelet dixhitale dhe për të monitoruar efektivitetin e tyre. Edhe numri i sporteleve dixhitale është i papërcaktuar.

Ky angazhim nuk ka ndikim të mundshëm. Këto sportelet dixhitale kanë për qëllim të ofrojnë akses tek e-Albania për qytetarët që nuk kanë akses në internet ose që kanë akses të kufizuar. Megjithatë, sportelet e planifikuara dixhitale do të instalohen në qendrat kryesore urbane dhe shumica e qytetarëve në këto zona kanë akses në internet. Përfaqësuesit e shoqërisë civile sugjerojnë se sportelet dixhitale mund të përmirësojnë aksesin tek shërbimet elektronike për qytetarët në zonat rurale dhe të largëta të vendit.¹ Ky angazhim do të kishte ndikim më të madh të mundshëm, nëse sportelet dixhitale do të instaloheshin në më shumë zona rurale.

Zbatimi

Instalimi i sporteleve dixhitale për të mundësuar aksesin e qytetarëve tek shërbimet e portalit e-Albania u njoftua në dhjetor të vitit 2015². Raporti vjetor i AKSHI-t i vitit 2016 dhe portali e-Albania njoftoi se 15 sportele dixhitale ishin instaluar në bashkitë Tiranë, Shkodër, Korçë, Vlorë, Malësi e Madhe, Elbasan dhe Sarandë. Sportele të tjera dixhitale u instaluan në Tiranë (katër sportelet) në Fier (qendra tregtare Elkos), në Durrës (Flagship Center), në Fier, në Kavajë dhe në institucione të tjera shtetërore (p.sh., ADISA)³. Në 2016, në portalin e-Albania ofroheshin 465 e-shërbime, 241,621 persona u regjistruan si përdorues dhe 42 institucione publike u lidhën me këtë portal.

Ky proces u shoqërua me disa aktivitete informimi për mënyrën e përdorimit të sporteleve dixhitale dhe përparësitë e tjera të ofruara përmes tyre. Në nëntor të vitit 2016, një ngjarje e tillë u zhvillua në ambientet e Drejtorisë Rajonale të Transportit në Tiranë, me qytetarë që aplikonin për shërbime të ndryshme (p.sh. patentë shoferi, regjistrime automjesh etj.).⁴

Rezultatet e para (nëse ka)

Hulumtuesit MRP nuk iu dha asnjë informacion për zbatimin e këtij angazhimi nga AKSHI në fund të periudhës së raportimit. Prandaj, ky raport nuk mund të përcaktojë shpeshtësinë e përdorimit të sporteleve dixhitale në zonat urbane.

Pjesëmarrësit në fokus grupet me të rinj dhe me qytetarë nga zonat e largëta konfirmuan se kishin dijeni për sportelet dixhitale, por nuk i kishin përdorur ato.

Hapat e mëtejshëm

Hulumtuesi MRP rekomandon që ky angazhim të mos vazhdojë në planin e ardhshëm të veprimit. Siç u përmend më herët, krijimi dhe shpërndarja e sporteleve dixhitale nuk kanë lidhje me vlerat PQH. Megjithatë, është e qartë se ky angazhim synon të sigurojë akses më të mirë tek shërbimet elektronike në e-Albania. Duke pasur parasysh konfuzionin që rrethon portalin e-Albania dhe përdorimin e tij, sporteli dixhital i ndërthurur me aktivitete ndërgjegjësimi dhe informimi mund të jetë shumë i dobishëm për qytetarët. Qeveria duhet të shqyrtojë mundësinë e shpërndarjes e materialeve udhëzuese apo edukative në krah të sporteleve dixhitale, por duhet ta vazhdojë këtë aktivitet jashtë planit të veprimit PQH të vendit. Në vend të kësaj,

hulumtuesi i MRP rekomandon që fokusi i planeve të veprimit të zhvendoset tek veprimet specifike që trajtojnë vlerat PQH.

¹ Intervistë me Dalina Jasharin, Menaxhere e Projektit CIVILISC, Korrik 2017.

² Shpërndarja e sporteleve dixhitale, <https://www.youtube.com/watch?v=RgxL0buUumc>

³ Raporti i AKSHI-t i vitit 2016, faqe 8, <http://akshi.gov.al/images/raporti%20vjetor%202016.pdf>

⁴ Portali e-Albania, <https://e-albania.al/lajmi.aspx?id=68>

13. Standardizimi i shërbimit të pasaportave

Teksti i angazhimit:

Agjencia e Ofritit të Shërbimeve të Integruara (ADISA) është e angazhuar për përgatitjen e pasaportave të shërbimit për çdo shërbim administrativ, bazuar në përvojën me ofrimin e standardeve të shërbimit të klientit në sektorin privat. Ky angazhim vjen si rezultat i reformës në shërbimin publik, bazuar në mungesën e informacionit të nevojshëm, transparencës, llogaridhënies dhe efikasitetit në mënyrën e ofritit të shërbimeve publike në Republikën e Shqipërisë.

Pasaportat e shërbimit do të përdoren për të gjithë qytetarët e Republikës së Shqipërisë për ofrimin, thjeshtimin dhe unifikimin e informacionit për të gjitha shërbimet publike. Kjo do të sjellë një pamje të qartë për qytetarët për sa i përket mënyrës se si ofrohen shërbimet publike. Çdo shërbim ka pasaportën e vet unike të shërbimit, duke deklaruar të dhënat që lidhen me: emrin e institucionit, emrin e shërbimit, kodin, përshkrimin, dokumentacionin e nevojshëm, dokumentin e dorëzuar, vlefshmërinë e dokumentit, përfituesit e shërbimit, kohën e marrjes së shërbimit, tarifën, pagesën, ofrimin e shërbimeve online, bazën ligjore, adresën e zyrës, sistemin e ankesave, përshkrimin e procedurës së aplikimit në zyrën e pritjes, call center.

Objektivat kryesorë të shërbimit të pasaportave janë si më poshtë:

- Thjeshtimi i informacionit për qytetarët se si të përfitojnë shërbimet publike;
- Bashkimi i organizimit të informacionit për shërbimet publike;
- Standardizimi i përdorimit të tij të synuar, jo vetëm në zyra, por edhe në call center dhe portalin e e-qeverisjes

Aktualisht, ADISA është e fokusuar në 10 institucione dhe po punon për përfundimin e 400 pasaportave të shërbimit, të cilat janë në fazën përfundimtare të përshtatjeve dhe koordinimit që do të për t'u bërë gati. Më tej, ADISA do të punojë me standardizimin e 700 pasaportave të shërbimit të miratuara tashmë me institucionet që ofrojnë shërbime publike, të cilat do të përfundojnë deri në fund të vitit 2017.

Institucioni përgjegjës: Agjencia e Ofritit të Shërbimeve të Integruara (ADISA)

Institucion(et) mbështetës(e): Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të gjitha all Ministrinë e linjës

Data e fillimit: 2016

Data e mbarimit: 2017

Shënim redaksional: Për të lexuar të gjithë tekstin e angazhimit, lutemi referojuni https://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_NAP3_ENG.pdf.

Përmbledhje e angazhimit	Detajimi				Lidhja me vlerën PQH				Ndikimi i mundshëm				Në kohë?	Zbatimi			
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi në Informacion	Pjesëmarrja qytetare	Llogaridhënia publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues		Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar

13. Standardizimi i shërbimit të pasaportave			✓		E paqartë		✓		Po			✓	
---	--	--	---	--	-----------	--	---	--	----	--	--	---	--

Konteksti dhe Objektivat

Agjencia për Ofrimin e Shërbimeve të Integruara (ADISA) menaxhon ofrimin e shërbimeve publike duke krijuar dhe administruar dritare shërbimit, ose qendra shërbimi me një ndalesë për qytetarët¹. Po ashtu, ADISA është përgjegjëse edhe për përgatitjen dhe standardizimin e pasaportave të shërbimit. Pasaportat e shërbimit ofrojnë informacione të thjeshta dhe të unifikuara për të gjitha shërbimet publike, dhe secili shërbim do të ketë pasaportën e vet, i cili përfshin informacione të tilla si emri i institucionit, emri i shërbimit, etj. Ky angazhim pason reformën në shërbimin publik dhe synon të vazhdojë standardizimin e pasaportave të shërbimit (rreth 700).

Për të arritur këtë angazhim, ADISA planifikon të bashkëpunojë me institucionet shtetërore për të marrë informacionin përkatës të kërkuar nga procesi i standardizimit. Edhe pse objektivi është i qartë, teksti i angazhimit nuk ofron rezultate të matshme që mund të përdoren nga Hulumtuesi MRP për të vlerësuar zbatimin dhe ndikimin.

Lidhja PQH e këtij angazhimi është e paqartë, sepse nuk ndikon në aksesin tek informacionet, tek transparenca apo llogaridhënia publike. Përkundrazi, është një detyrim i zakonshëm ligjor dhe përgjegjësi institucionale e ADISA për të lehtësuar përdorimin e shërbimeve elektronike duke siguruar informacione të standardizuara për shërbimet elektronike (të ofruara në portalin e-Albania dhe në sportelet dixhitale). Informacioni i standardizuar, si emri i institucionit ose emri i shërbimit, ekzistonin faktikisht para fillimit të këtij plani të veprimit. Për më tepër, ky angazhim është vazhdimi i një procesi të standardizimit që nisi para fillimit të këtij plani veprimi: 10 institucione shtetërore kanë standardizuar tashmë 371 pasaporta shërbimi. Për shkak të kësaj, ndikimi i mundshëm i këtij angazhimi është i vogël.

Zbatimi

Numri i institucioneve që standardizuan pasaportat e shërbimit në vitin 2016 arriti në 18 (nga 10 institucione në fillim të periudhës së zbatimit në korrik 2016). Deri në fund të vitit 2016 u standardizuan gjithsej 481 pasaporta shërbimi². ADISA i raportoi Hulumtuesit MRP se janë zhvilluar gjithsej 548 pasaporta shërbimi nga 20 institucione shtetërore. 475 prej tyre (nga 13 institucione) tashmë janë standardizuar deri në fund të periudhës së raportimit³. ADISA po punon për të standardizuar edhe 42 pasaporta shërbimesh, të cilat janë zhvilluar për shtatë institucione shtetërore⁴. Deri në fund të vitit 2017, ADISA duhet të arrijë objektivin e 700 pasaportave të standardizuara të shërbimit.

Hapat e mëtejshëm

Hulumtuesi MRP e konsideron standardizimin e pasaportave të shërbimit një aktivitet rutinë me qëllim rritjen e nivelit të përdorimit të portalit qeveritar e-Albania. Duke ofruar këto pasaporta shërbimi, qytetarët shpresojnë të kenë një ide më të qartë se si ofrohen shërbimet publike. Pozicioni i ADISA-s për sa i përket vlerës PQH të këtij angazhimi është se ajo rrit aksesin tek informacion dhe transparenca në lidhje me shërbimet e ofruara (p.sh. dokumentet e kërkuara, tarifat, etj.)⁵. Megjithatë, një informacion i tillë duhet të konsiderohet pjesë integrale e shërbimeve elektronike. Prandaj, ky raport rekomandon që ky angazhim nuk duhet të vazhdohet në planin e ardhshëm të veprimit.

¹ ADISA, <http://www.adisa.gov.al/about-us/>

² Raporti Vjetor i Monitorimit 2016 për “STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E REFORMËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE 2015-2020”, faqe 35-36,
<http://dap.gov.al/images/DokumentaStrategjik/SNRAP%20Raporti%20Vjetor%202016%20Final%2016.03.2017.pdf>

³ Në muajin shtator 2017 ADISA raportoi në mediat sociale se numri i pasaportave të shërbimeve të standardizuara kishte arritur 548 për plot 20 institucione.
<https://www.facebook.com/ADISA.ALBANIA/photos/a.1612748952328327.1073741827.1554893621447194/1993724240897461/?type=3&theater>

⁴ Komunikim me email intervistë me telefon me Drejtoren e ADISA-s Anisa Gjika. Tetor 2017.

⁵ Komunikim me email intervistë me telefon me Drejtoren e ADISA-s Anisa Gjika. Tetor 2017.

14. Kartela informative e qytetarit

Teksti i angazhimit:

Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, në bashkëpunim me Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve të Integruara (ADISA) ndërmori nismën për krijimin e një dokumenti publik, i cili, për herë të parë, do të ofrohet për t'u garantuar qytetarëve dhe institucioneve informacione për standardet bazë për ofrimin e shërbimeve publike në sportele. Institucionet dhe qytetarët nuk dinin gjë për këtë lloj informacioni më parë.

Ky angazhim duhet të përmbushet nga ADISA, si autoriteti përgjegjës për standardizimin e metodave të ofritit të shërbimeve publike në sportele, duke krijuar Kartelën informative të Qytetarit, ku do të përfshihen për secilin shërbim/informacion mënyrat/kanalet për marrjen e shërbimit:

- Rregullat e sjelljes në sportelet fizike;
- Rregullat për aplikimin në sportelet fizike të shërbimit;
- Rregullat për marrjen e përgjigjeve nga sportelet fizike;
- Rregullat për ankesë;
- Modele të përfaqësimit vizual në sportelet fizike;
- Elementet e nevojshme të shërbimit në sportelet fizike;
- Rregullat e komunikimit dhe të organizimit të informacionit për shërbimet;
- Rregullat për përdorimin e formave dhe funksionalitetit të kanaleve të ndryshme për ofrimin e shërbimeve publike nga këndvështrimi i personave fizikë dhe juridikë;
- Klasifikimi i shërbimeve;
- Kodifikimi i shërbimeve;
- Formularët për aplikimin e shërbimit

Hartimi dhe publikimi i kartelës informative përgjithësisht në print apo në format elektronik do të sigurojë rritjen e transparencës, shpejtësinë e shërbimit, ofrimin e shërbimit, përmirësimet e vazhdueshme, performancës dhe do të ofronte mjete alternative për luftën kundër korrupsionit.

Institucioni përgjegjës: Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve të Integruara Albania

Institucion(et) mbështetës(e): Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të gjitha ministritë e linjës

Data e fillimit: 2017

Data e mbarimit: 2018

Shënim redaksional: Për të lexuar të gjithë tekstin e angazhimit, lutemi referojuni https://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_NAP3_ENG.pdf.

Përmbledhje
e angazhimit

Detajimi

Lidhja me vlerën PQH

Ndikimi i
mundshëm

Në
kohë?

Zbatimi

	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi në Informacion	Pjesëmarrja qytetare	Llogaridhënia publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues		Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar
14. Kartela informative e qytetarit				✓	✓					✓			Po			✓	

Konteksti dhe Objektivat

Ky angazhim përbën një detyrim ligjor sipas Ligjit “Për ofrimin e shërbimeve publike në sportelet në Republikën e Shqipërisë”. Me fjalë të tjera, ky angazhim ka për qëllim të sigurojë publikimin rutinë të një karte informative të qytetarëve, që është një grafikë informative ku shpjegohen e-shërbime që ofrohen në portalin e-Albania. Pas bisedës me Agjencinë e Ofritit të Shërbimeve të Integruara (ADISA), institucioni kryesor, hulumtuesi i MRP konstatoi se kartela informative duhet të përfshijë informacione bazë për mjetet dhe kanalet për të marrë një shërbim; kërkesat dhe orët e punës; elemente të matshme si kostot dhe afatet; dhe pikave të kontaktit dhe procesit të adresimit të ankesave.¹

Sipas përshkrimit që jepet në planin e veprimit, kartelat informative të qytetarëve synojnë të sigurojnë rritjen e transparencës, ofrimin e shërbimeve dhe performancës si dhe sigurimin e mjeteve alternative për të luftuar korrupsionin. Përfaqësuesit e ADISA sugjeruan se kartela rrit transparencën dhe mundëson përmirësimin e shërbimeve.² Bazuar në informacionet e ofruara nga ADISA, kartela informative e qytetarëve paraqet një detyrim ligjor për ofrimin e shërbimeve cilësore elektronike dhe rrjedhimisht edhe një parakusht dhe “infrastrukturë” e domosdoshme, në bazë të së cilës ADISA do të jetë në gjendje të masë efikasitetin dhe cilësinë e e-shërbimeve. Teksti i angazhimit ofron shumë detaje për sa i përket se çfarë duhet të përfshijë kartela e re informative e qytetarëve. Ky angazhim ka lidhje me aksesin tek informacioni, pasi ofron informacione se si të merren shërbimet dhe rregullat e ankimimit.

Ndikimi i mundshëm i këtij angazhimi është i vogël. Informacioni i e-shërbimit i ofruar në Kartelën informative të qytetarëve është informacioni bazë që do të udhëzojë përdoruesit përmes shërbimeve elektronike, si agjencia, pika e aksesit, si të përdoret shërbimi etj.

Zbatimi

ADISA ka raportuar se zhvillimi i kartelës së qytetarëve ka filluar në vitin 2015 dhe ka vazhduar deri në vitin 2016. Gjatë periudhës raportuese ADISA ka zhvilluar elementët e mëposhtëm të kartelës informative të qytetarëve: informacionet për korrupsionin dhe transparencën, shpejtësinë e shërbimit, ekzekutimin e shërbimit, përmirësimin dhe performancën.³

Në dhjetor të vitit 2016, drafti i kartelës së qytetarëve iu dërgua 18 institucioneve, siç iu raportua hulumtuesit MRP nga ADISA.

Në maj të vitit 2017, ADISA dhe Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike (MIAP) kryen një konsultim me shkollat e mesme dhe më pas krijuan një model duke identifikuar se cilat informacione duhet të përfshihen në kartelën

informative të qytetarëve. Në qershor të vitit 2017 u kryen konsultime shtesë me institucionet përgjegjëse me qëllim që të gjehej gjuha e përbashkët për masat që duhet të ndërmerren për të përmbushur detyrimin për kartelën informative të qytetarëve.⁴

Gjatë realizimit të diskutimeve në fokus grupe, hulumtuesi i MRP konstatoi se pjesëmarrësit nuk kishin dijeni për këtë angazhim, ndonëse shumica e tyre e njihnin portalin qeveritar e-Albania dhe, deri në njëfarë mase, sportelet dixhitale.⁵

Hapat e mëtejshëm

Edhe pse ky angazhim është një hap përpara drejt përmirësimit të shërbimeve publike, Hulumtuesi MRP rekomandon që ky angazhim të mos kalojë në planin tjetër të veprimit.

¹ Informacioni i ofruar nga ADISA, Tetor 2017.

² Komunikim me email intervistë me telefon me Drejtoren e ADISA-s Anisa Gjika. Tetor 2017.

³ Komunikim me email intervistë me telefon me Drejtoren e ADISA-s Anisa Gjika. Tetor 2017.

⁴ Informacioni i ofruar nga ADISA, Tetor 2017.

⁵ Diskutime në fokus grupe me të rinj, gra dhe banorë të zonave të largëta, gusht-shtator 2017

15. Receta elektronike pilot

Teksti i angazhimit:

Titulli: Sistemi elektronik i regjistrimit të e-recetës në Republikën e Shqipërisë

Ky angazhim ka për qëllim të zëvendësojë recetën mjekësore letër me recetën elektronike në të gjithë vendin. Përmbushja e këtij angazhimi sjell rritjen e efikasitetit të fondeve mjekësore të rimbursimit të barnave dhe saktësinë e përcaktimit të barnave mjekësore duke ndikuar kështu drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së shëndetit të pacientëve dhe të kujdesit shëndetësor.

Ndër të tjera, receta elektronike do të sjellë:

- *Uljen e mundësive për gabim që vjen si rezultat i keqkuptimit të shkrimit mes mjekëve dhe farmacistëve*
- *Reduktimin e kohës administrative për komunikimin mes pacientit-mjekut, pacient-farmacistë, farmacistë-Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor*
- *Rriten e nivelit të përputhjes së barnave që i jepen pacientit dhe rritja e rehatisë të pacientit edhe në marrjen e këtyre barnave*
- *Sistemi do të bëjë të mundur mbledhjen e të dhënave historike të mjekimeve që ka marrë pacienti.*

Institucioni përgjegjës: Ministria e Shëndetësisë

Institucion(et) mbështetës(e): Farmacitë

Data e fillimit: 2016

Data e mbarimit: 2017

Shënim redaksional: Për të lexuar të gjithë tekstin e angazhimit, lutemi referojuni https://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_NAP3_ENG.pdf.

Përmbledhje e angazhimit	Detajimi				Lidhja me vlerën PQH				Ndikimi i mundshëm				Në kohë?	Zbatimi			
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi në Informacion	Pjesëmarrja qytetare	Llogaridhënia publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues		Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar
15. Receta elektronike pilot		✓			E paqartë					✓			Po		✓		

Konteksti dhe Objektivat

Një raport i Bankës Botërore i vitit 2014 konstatoi se shqiptarët paguajnë një çmim më të lartë për ilaçe sesa vendet fqinje¹. Dhe në vitin 2015, shumica e shqiptarëve deklaruan se sistemi i kujdesit shëndetësor në Shqipëri është një shqetësim serioz². Ka pasur disa përmirësime në lidhje me besimin e publikut në sistemin e kujdesit shëndetësor, siç raportohet nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) në vitin 2016.³ Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtejshme për të forcuar cilësinë e

kujdesit shëndetësor në Shqipëri. Një nga shqetësimet që shpesh është shfrytëzuar për praktikat korruptive dhe përfitimet e paligjshme është sistemi i recetës.

Gjatë viteve të fundit Shqipëria ka ndërmarrë një sërë reformash për të informatizuar shërbimet shëndetësore. Qëllimi i këtij angazhimi është zëvendësimi i recetave mjekësore të letrës me receta elektronike në të gjithë vendin. Deri më tani, recetat mjekësore janë regjistruar vetëm në letër dhe ka qenë e vështirë të menaxhohej vëllimi i përpunimit të recetave të letrës. Ministria e Shëndetësisë, pasi ka pilotuar me sukses sistemin elektronik të recetave në rrethin e Durrësit, synon të zgjerojë këtë sistem në të gjithë Shqipërinë. Rezultati i synuar i këtij sistemi, siç përshkruhet në planin e veprimit, është i shumëfishtë. Qeveria synon sistemin e recetave për të sjellë këto ndryshime: të krijojë një regjistër me historikun e mjekimit të pacientëve, të rrisë efikasitetin e fondeve të rimbursimit të barnave, të rrisë saktësinë e përcaktimit të ndikimit të barnave mjekësore në shëndetin e pacientit dhe kujdesin shëndetësor, të zvogëlojë numrin e receta të rreme, zvogëlojnë numrin e gabimeve mes mjekëve dhe farmacistëve, të rrisë nivelin e përputhshmërisë së barnave që u jepen pacientëve, dhe të tjera.

Pavarësisht këtij rezultati ambicioz, është e paqartë se si do të rrisë nivelin e përputhshmërisë krijimi i një sistemi elektronik kur mjekët përcaktojnë mjekimin. Detajimi i këtij angazhimi është i ulët. Përderisa rezultati është i verifikueshëm, teksti nuk jep hapat e matshëm që do të ndërmarrë qeveria për të siguruar që sistemi i ri elektronik i recetave të arrijë të gjitha rezultatet që janë përshkruar.

Për shkak të detajimit të ulët, hulumtuesi MRP mendon se ky angazhim do të ketë ndikim të vogël nëse zbatohet plotësisht. Ky angazhim përcakton zëvendësimin e recetave të letrës me një sistem elektronik, i cili është një hap i vogël dhe që nuk trajton praktikën korruptive apo besimin e ulët të publikut tek sistemi i kujdesit shëndetësor. Angazhim më transformues do të detajonte funksionalitete që do të duhej të përfshiheshin në sistemin elektronik në mënyrë që të bënin të mundur gjurmimin e recetave një organ monitorues ose ndryshe të përfshinte një mekanizëm të llogaridhënies publike për të ndihmuar në rritjen e besimit tek qytetarët.

Edhe lidhja e këtij angazhimi me vlerat PQH është e paqartë. Zgjerimi i sistemit të recetës elektronike në të gjithë vendin nuk u mundëson qytetarëve rritje apo përmirësim të aksesit tek informacionet dhe as nuk ofron ndonjë mekanizëm për pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve ose për llogaridhënie publike.

Zbatimi

Hulumtuesit MRP nuk iu ofrua asnjë informacion për këtë angazhim. Ishte e vështirë të vlerësohej nëse angazhimi ishte në kohë ose jo, duke pasur parasysh specifikat e paqarta të angazhimit. Në shtator 2017, qeveria e re e ristrukturoi ministritë dhe agjencitë e ndryshme (duke përfshirë këtu edhe kalimin e mirëqenies sociale në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë). Kështu, Hulumtuesi MRP nuk mund të lidhej dot me pikën e kontaktit të Ministrisë së Shëndetësisë për këtë angazhim.

Nga monitorimi MRP gjatë periudhës së zbatimit u përcaktua se sistemi i recetës elektronike nisi në Tiranë në mars të vitit 2017.⁴ Më parë, në janar 2017, për përdorimin e sistemit recetës elektronike u trajnuan 317 personel nga sistemi shëndetësor.⁵ Aplikacioni për sistemin elektronik të recetës ofrohet nëpërmjet portalit e-Albania.⁶ Përdorimi i aplikacionit shpjegohet nëpërmjet një sërë materialesh ndihmëse (video)⁷ dhe ky aplikacion është e ndërlidhur me kartat e shëndetit të qytetarëve.⁸

Hulumtuesi MRP ishte në gjendje të përcaktonte vetëm përdorimin e sistemit të recetave elektronike në Durrës dhe Tiranë. Nuk u ofruan informacione të tjera nga institucionet përgjegjëse për rezultatet dhe nuk u dha informacion as për planet për zgjerimin e sistemit në nivel kombëtar.

Rezultatet e para (nëse ka)

Pjesëmarrësit në fokus grupet e organizuar nga hulumtuesi MRP ishin në dijeni të recetave elektronike si dhe të kartës së shëndetit, komponentit të tij të ndërlidhur. Edhe pse shumë prej tyre e vlerësuan këto projekte si një hap të rëndësishëm përpara në përmirësimin e shërbimeve publike, disa pjesëmarrës shprehën skepticizëm sa i përket rezultateve të tyre aktuale në luftën kundër korrupsionit. “Ky është një korrupsion i vogël. Qeveria duhet të luftojë korrupsionin e madh në sistemin e prokurimeve në sistemin e kujdesit shëndetësor,” tha një pjesëmarrës.⁹ Operatorët e sektorit privat (p.sh., farmacistët) bien dakord deri në një farë mase, duke theksuar se “receta elektronike përfshin një element monitorimi, i cili do të bëjë të mundur në të ardhmen çrrënjosjen e korrupsionit në marrëdhëniet pacient-personel shëndetësor-farmacist.”¹⁰

Hapat e mëtejshëm

Sistemi i recetës elektronike, karta shëndetësore e qytetarëve dhe shërbimet e tjera elektronike në sistemin e kujdesit shëndetësor ofrojnë një bazë të rëndësishme për masa që synojnë rritjen e transparencës dhe llogaridhënies. Në këtë kontekst, Hulumtuesi MRP sugjeron që duhet të ndërmerren angazhime të tjera të mëtejshme, veçanërisht ato që i sigurojnë akses publikut tek të dhënat dhe informacionet e tjera të mbledhura përmes sistemeve elektronike, në përputhje me kërkesat ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale. Veprime të tilla janë:

- Publikimi i të dhënave për përdorimin e recetës elektronike;
- Publikimi i të dhënave për nivelin e “përmbushjes së pritshmërive të klientëve”
- Publikimi i informacionit për performancën e të gjithë operatorëve të përfshirë në sistemin e recetave elektronike, përfshirë këtu edhe të dhënat financiare.

¹ Konferencë e Bankës Botërore dhe Ministrisë së Shëndetësisë, <http://www.oranews.tv/shendetesi/shendetesia-qogoli-i-ri-korrupsionit-raporti-i-bb-ja-si-vidhen-shqiptaret/>. Data e referimit Shtator 2017. Që nga koha e hartimit të këtij raporti, lidhja me këtë adresë është hequr.

² Kujdesi shëndetësor mbetet ende një problem serioz sipas 67% të shqiptarëve, “Pandëshkueshmëria” faqe 21, IDRA 2015, http://www.idrainstitute.org/files/reports/impunity_2014/impunity_final_report.pdf

³ Nga 2015 deri në 2016 perceptimi i publikut për besimin në sistemin e kujdesit shëndetësor është përmirësuar, Sondazhi i Besimit të Publikut (IDM 2016), faqe 22, <http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2017/02/IDM-OpinionPoll-2016-EN.pdf>

⁴ Sistemi i recetës elektronike, <http://www.shendetesia.gov.al/al/newsroom/lajme/receta-elektronike-begaj-vijon-normalisht-zbatimi-ne-4-ditet-e-para-te-tirane>

⁵ Receta elektronike, <http://www.shendetesia.gov.al/al/newsroom/lajme/receta-elektronike-ne-tirane-nis-trajnimi-i-mjekeve>

⁶ Adresa për aplikacionin e recetës elektronike, http://apps.fsdksh.com.al:7777/PublicIdm/;PublicIdmApp=cs4cJY_ICDeXHVPF3IM0WScNP5eYqULi2ENcfxnHaw6kRltz0Nta!1784821236

⁷ Videos e recetës elektronike, <http://apps.fsdksh.com.al:7777/VideoTutorial/Index.html> dhe https://www.fsdksh.com.al/images/stories/receta_elektronike/Sisitemi_recetes_elektronike.pdf

⁸ Regjistri i kartës së shëndetit të qytetarëve, <https://regjistri.fsdksh.com.al/ahis/faces/Login.jsf>

⁹ Pjesëmarrës në fokus grupe MRP me të rinj.

¹⁰ Intervista me farmacistë në Tiranë, Shtator – Tetor 2017.

16. Sistemi i monitorimit elektronik të pyjeve

Teksti i angazhimit:

Ky angazhim synon të krijojë një sistem të integruar që do të mundësojë monitorimin e aktiviteteve të paligjshme dhe identifikimin në kohë të zjarreve si një nga objektivat strategjike të programit të qeverisë në lidhje me pyjet.

Ky angazhim synon:

- Krijimin e një sistemi të integruar për monitorimin e pyjeve për të parandaluar prerjen e paligjshme të pyjeve;
- Zbulimet në kohë reale të zjarreve që mund të ndodhin në zonat që do të mbulohen nga sistemi;
- Monitorimin gjatë 24/365, përcaktimin e pikave kyçe për të parandaluar dhe kontrolluar transportin e materialit të prerjes së paligjshme të drurit nga pyjet drejt qendrave urbane ku mbledhet dhe tregtohet.
- Përmirësimin e cilësisë së shërbimit për parandalimin e shkeljeve të prerjes së pyjeve.
- Shkëmbimin e informacionit në kohë reale me strukturat e tjera përgjegjëse për monitorimin dhe ndjekjen penale të autorëve të veprave të paligjshme
- Uljen e korrupsionit në këtë fushë.

Institucioni përgjegjës: Ministria e Mjedisit

Institucion(et) mbështetës(e): Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve

Data e fillimit: Gusht 2016

Data e mbarimit: 2017

Shënim redaksional: Për të lexuar të gjithë tekstin e angazhimit, lutemi referojuni https://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_NAP3_ENG.pdf.

Përmbledhje e angazhimit	Detajimi				Lidhja me vlerën PQH				Ndikimi i mundshëm				Në kohë?	Zbatimi			
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi në Informacion	Pjesëmarrja qytetare	Llogaridhënia publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues		Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar
16. Sistemi i monitorimit elektronik të pyjeve				✓	E paqartë					✓			Jo	✓			

Konteksti dhe Objektivat

Prerjet e paligjshme e pyjeve në Shqipëri e kanë zanafillën që me rënien e regjimit komunist në vitin 1991, kur shkëputja e rëndë e furnizimit me energji elektrike çoi në presion të madh për drurin si burim energjie.¹ Zonat pyjore mbulojnë 36 për qind të

sipërfaqes së Shqipërisë, por që janë degraduar shumë gjatë dy dekadave të fundit.² Sipas një studimi të vitit 2005 të Bankës Botërore, vëllimi i drurit industrial të prerë është 5-8 herë më i madh se furnizimi i regjistruar zyrtarisht.³ Ekspertët vendorë thonë se kjo tregti e paligjshme vazhdon përpara syve të autoriteteve dhe problemi i prerjeve të paligjshme lidhet në mënyrë të pashpjegueshme me korrupsionin.⁴

Aktualisht, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave nuk ka sistem të kompjuterizuar për monitorimin dhe regjistrimin e aktiviteteve të paligjshme dhe/ose zjarreve në pyje në secilin prej qarqeve të Shqipërisë.

Ky angazhim synon të krijojë një sistem monitorimi elektronik të pyjeve. Ky sistem do të përfshijë zbulimin në kohë reale të zjarreve, kamera monitoruese, shkëmbim informacioni në kohë reale me strukturat e monitorimit dhe të tjera. Ngritja e këtij sistemi do të ulë edhe kostot e inspektimeve, siç përshkruhet në planin e veprimit. Megjithatë, detajimi i këtij angazhimi është i lartë. Gjuha e angazhimit përcakton numrin e kamerave që do të instalohen, pikat kryesore të instalimit dhe transmetimin e pamjeve tek Policia Pyjore dhe strukturat e tjera kompetente.

Ndikimi i mundshëm i këtij angazhimi, nëse zbatohet plotësisht, është i vogël. Në vitin 2015 u pilotua një sistem mbikëqyrjeje në Tiranë dhe Shkodër.⁵ Edhe pse Inspektorati Shtetëror ka raportuar rezultate pozitive në parandalimin e dëmtimit të pyjeve gjatë vitit 2015, organizatat mjedisore kanë ngritur shqetësime se abuzimi ende vazhdon.⁶ Pa pasur informacionin e detajuar se si do të parandalojë drejtpërsëdrejti abuzimin dhe korrupsionin ky sistem i monitorimit elektronik, Hulumtuesi MRP nuk mund ta përcaktojë ndikimin e mundshëm të këtij angazhimi në nivel më të lartë se “i vogël”.

Përveç kësaj, lidhja PQH e këtij angazhimi, duke pasur parasysh përshkrimin e tij në planin e veprimit, është e paqartë. Ky angazhim nuk identifikon asnjë mekanizëm ose ndërhyrje me të cilën të dhënat e monitorimit do të përkthehen në të dhëna të disponueshme për publikun ose nëse qytetarët do të kenë mundësi të raportojnë rastet e prerjeve të paligjshme. Pa një mekanizëm të tillë, ky angazhim nuk ka lidhje me vlerat e PQH.

Zbatimi

Hulumtuesit MRP nuk iu ofrua informacion për zbatimin e këtij angazhimi. Nga monitorimi i faqeve të internetit dhe i raporteve për punën e institucioneve përgjegjëse (Ministria e Mjedisit dhe Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave) nuk u identifikua ndonjë aktivitet lidhur me këtë angazhim, përveç pilotimit të një sistemi të ngjashëm në qarqet e Shkodrës dhe Tiranës. Pjesëmarrësit në grupet e fokusit të organizuara nga Hulumtuesi MRP nuk kishin dijeni për këtë projekt, megjithëse disa prej tyre (pjesëmarrësit në zonat rurale) preken dhe kanë dijeni për prerjet e paligjshme. Shumë pjesëmarrës e mirëpritën këtë angazhim duke pasur parasysh gjendjen aktuale të mjedisit në përgjithësi dhe të pyjeve në veçanti. Organizatat e shoqërisë civile dhe rrjetet që veprojnë në fushën e mbrojtjes së mjedisit nuk raportuan ndonjë aktivitet nga shteti për këtë angazhim.⁷

Në kohën e shkrimit të këtij raporti, ish Ministria e Mjedisit është integruar në Ministrinë e Turizmit. Nuk ka asnjë informacion në lidhje me pikën e kontaktit për këtë angazhim. Duke pasur parasysh se data e përfundimit të këtij angazhimi është e shënuar si 2017 dhe se ky angazhim nuk ka filluar ende, nuk ka gjasa që ky angazhim të zbatohet brenda afatit.

Hapat e mëtejshëm

Ky angazhim është një masë pozitive por të vogël për trajtimin e shqetësimeve në këtë sektor. Ai ndërmerr hapa për të adresuar menaxhimin efikas të burimeve publike dhe monitorimin e veprimtarisë së firmave private. Ky angazhim është i rëndësishëm dhe Hulumtuesi MRP rekomandon që ai të vazhdojë edhe në planin e

ardhshëm të veprimit, me kusht që ai të riformulohet me qëllim vendosjen e lidhjes me vlerat PQH. Dy mënyra se si mund të riformulohet ky angazhimi janë si më poshtë

- Publikimi i rezultateve të sistemit të monitorimit online ose i rezultateve të tjera përkatëse; dhe
- Përfshirja e shoqërisë civile dhe promovimi i pjesëmarrjes qytetare gjatë hartimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të sistemit.

Si përfundim, Hulumtuesi MRP sugjeron që ky angazhim të riformulohet tërësisht në bashkëpunim dhe konsultim të ngushtë me organizatat mjedisore, operatorët e sektorit privat dhe median.

Po ashtu, Hulumtuesi MRP rekomandon që në planin e ardhshëm të veprimit të merret parasysh Analiza e Tretë e Performancës Mjedisore të Shqipërisë, siç sugjerohet nga Komisioni Ekonomik për Evropën e Kombeve të Bashkuara. Disa nga rekomandimet e hartuara në këtë analizë janë si më poshtë:

- Botimi i rregullt i të dhënave në lidhje me respektimin dhe zbatimin e ligjit
- Funksionimi i një faqeje në internet për rritjen e transparencës dhe nxitja e angazhimit të publikut në zbulimin e shkeljeve.⁸

¹ Sigurimi i qëndrueshmërisë së pyjeve, http://siteresources.worldbank.org/INTFORESTS/Resources/SAVCOR_illegal_logging_ENA_June2005.pdf

² Balkan Insight: Prerjet e paligjshme masakrojnë pyjet e Shqipërisë, <http://www.balkaninsight.com/en/article/illegal-logging-ravages-albania-s-forests>

³ Banka Botërore http://siteresources.worldbank.org/INTFORESTS/Resources/SAVCOR_illegal_logging_ENA_June2005.pdf

⁴ Balkan Insight, <http://www.balkaninsight.com/en/article/illegal-logging-ravages-albania-s-forests>

⁵ Intervistë e Krye-Inspektorit të Mjedisit Ergys Agasi, Gusht 2015, <http://top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=305967>

⁶ Reporter, <https://www.reporter.al/prijeje-te-shfrenuara-te-pyjeve-ne-veri-ne-prag-te-moratoriumit/>

⁷ Intervistë me Rezart Kapedani, Menaxher Programi i Programit ACHIEVE i OSHC-ve mjedisore i Qendrës Rajonale të Mjedisit, Tetor 2017.

⁸ Shqyrtimi i performancës mjedisore, <http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/cep/CEP-23/EPR.Albania.IP.3.e.doc>

17. Sistemi elektronik për aplikimet për licenca profesionale

Teksti i angazhimit:

Titulli: Sistemi elektronik i integruar për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të veprojnë në fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit

Ministria e Zhvillimit Urban është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e legjislacionit, strategjive dhe politikave (ndër të tjera) në fushën e licencimit profesional të individëve dhe personave juridikë që veprojnë në fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit.

Aktualisht, Ministria e Zhvillimit Urban nuk ka një aplikacion të informatizuar për të menaxhuar aplikimet për licencime profesionale në fushat e mësipërme dhe çdo praktikë në këtë kohë bëhet vetëm me letër. Ky projekt do të ofrojë aplikacione online për licencimin profesional përmes një interoperabiliteti të unifikuar të portalit qeveritar dhe ofrimit të tyre në e-albania.al, duke vepruar kështu në përputhje me nismat e Qeverisë Shqiptare për ofrimin e shërbimeve elektronike për qytetarët dhe bizneset.

Objektivi kryesor i këtij angazhimi është përmirësimi i shërbimeve të ofruara për përfutuesit në lidhje me licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që veprojnë në fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit. Në këtë mënyrë, qytetarët, bizneset dhe grupet e interesit do të mund t'i referohen informacioneve thelbësore dhe të vërtetuara në aspektin e individëve dhe personave juridikë që veprojnë në fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit.

Sistemi do të përmirësojë ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, do të lehtësojë procedurat, do të përshpejtojë dhe rrisë më tej transparencën e sistemit brenda ministrisë, mes ministrive dhe institucioneve të tjera publike si dhe me publikun. Ai do të shfrytëzojë të gjithë bazën e të dhënave dhe informacionet dhe do të minimizojë sa më shumë ndërhyrje njerëzore në proces, gjatë kryerjes së kontrollit aritmetik dhe logjik.

Institucioni përgjegjës: Ministria e Zhvillimit Urban

Institucion(et) mbështetës(e): Ministria e Zhvillimit Urban

Data e fillimit: 2016

Data e mbarimit: 2017

Përmbledhje e angazhimit	Detajimi				Lidhja me vlerën PQH				Ndikimi i mundshëm				Në kohë?	Zbatimi			
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi në Informacion	Pjesëmarrja qytetare	Llogaridhënia publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues		Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar
17. Sistemi elektronik për aplikimet për licenca profesionale			✓		E paqartë					✓			Po			✓	

Konteksti dhe Objektivat

Licencimi i profesioneve nuk ka qenë çështje e rëndësishme reformash në Shqipëri, përveç debatit sporadik publik në lidhje me reformat e taksave dhe të mirëqenies sociale.¹ Megjithatë, gjatë dy viteve të fundit, qeveria u është përgjigjur shqetësimeve të mediave lidhur me cilësinë e shërbimeve publike dhe licencimin e disa profesioneve, siç janë ato në sektorin e shëndetësisë.² Kohët e fundit, mediat kanë ngritur shqetësime edhe për institucionet e formimit profesional që japin certifikata të paligjshme trajnimi për njerëzit që synojnë të emigrojnë në vende të ndryshme të Evropës.³

Licencimi profesional në sektorin e ndërtimit është një masë e rëndësishme për përmirësimin e cilësisë së punimeve të ndërtimit, por mbi të gjitha është e rëndësishme për përmirësimin e sigurisë së ndërtimit. Ministrisë së Zhvillimit Urban i mungon një aplikacion i informatizuar për menaxhimin e aplikimeve për licencë profesionale; dosjet e aplikimeve përpunohen me dorë dhe në letër.

Objektivi kryesor i këtij angazhimi është përmirësimi i shërbimeve të ofruara për përfituesit, duke siguruar informacion në lidhje me ofruesit e mundshëm të shërbimeve. Ky angazhim përshkruan tre aktivitete: ngritjen e një shërbimi online për aplikimet për licencë profesionale përmes portalit e-Albania; shkëmbimin e informacionit në kohë reale për të verifikuar statusin e aplikimit; dhe përmirësimin e kapaciteteve të monitorimit. Edhe pse këto aktivitete kanë lidhje me objektivin e përgjithshëm, ato nuk janë qartësisht të matshëm.

Ndonëse ky angazhim përmirëson dukshëm procesin e aplikimit për licencë profesionale, lidhja e tij me vlerat PQH mbetet e paqartë. Nga ana tjetër, përshkrimi i angazhimit nuk specifikon se si do të përmirësohet aksesimi i publikut tek informacioni dhe llogaridhënia publike, siç sugjerohet në planin e veprimit. Edhe pse angazhimi sugjeron që aktorët e interesuar do të marrin emrat e profesionistëve të licencuar, ky informacion nuk i vihet në dispozicion publikut.

Asnjë nga organizata e shoqërisë civile të kontaktuar nga Hulumtuesi MRP dhe asnjë nga qytetarët që morën pjesë në diskutimet në fokus grupe të organizuara nga Hulumtuesi MRP nuk kishin dijeni për këtë angazhim. Në një farë mase, ky angazhim mund të ketë ndikim të caktuar në përmirësimin e sigurisë së punës në ndërtim në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Gjithsesi, duke qenë se ky angazhim është inkuadruar në ciklin dyvjeçar të planit të veprimit, hulumtuesi MRP është i mendimit se ndikimi i tij i mundshëm do të jetë i vogël.

Zbatimi

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 943 (datë 28 dhjetor 2016) përcakton rregullat për përmirësimin e shërbimeve të ofruara për përfituesit në lidhje me licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që veprojnë në fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudit të punimeve të ndërtimit.⁴ Aplikimi për licencë individuale gjendet në portalin e-Albania.⁵ Për një periudhë të ndërmjetme prej gjashtë muajsh nga data e miratimit të VKM-së nr. 943, aplikimet për licencim profesional mund të bëheshin ose nëpërmjet shërbimit postar ose online. Që nga 28 qershori 2017, të gjitha aplikimet dorëzohen online në portalin e-Albania.⁶ Hulumtuesi MRP nuk iu dha ndonjë informacion lidhur me shkëmbimin e informacionit në kohë reale për të verifikuar statusin e aplikimit ose për përmirësimin e kapacitetit për monitorim. Kështu, zbatimi nuk mund të kodohet më shumë se “i konsiderueshëm”.

Hapat e mëtejshëm

Hulumtuesi MRP sugjeron që ky angazhim të mos vazhdohet në planin e ardhshëm të veprimit, pasi lidhet me informatizimin e procesit të aplikimit dhe jo me ndonjë vlerë të caktuar PQH.

¹ Licencimi profesional, <http://shqiptarja.com/m/ekonomi/profesionet-e-lira-pensionistet-do-te-paguajne-kontribute-430279.html>

² "Licencat, rikthehet provimi për 3000 mjekë dhe infermierë" <http://shqiptarja.com/home/1/licensat-rikthehet-provimi-p-r-3-mij--mjek--dhe-infermier--335723.html>

³ Opinion, <http://opinion.al/kamera-e-fshehte-320-euro-per-trajnimin-e-gati-per-tregun-qjerman-te-punes/>

⁴ VKM, http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/262-2016.pdf

⁵ Portali e-Albania, <https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=11138>

⁶ Njoftim i Ministrisë së Zhvillimit Urban, <http://ns3036873.ip-149-202-208.eu/websites/ministria.turizmit/sq/licencat-profesionale-ne-fushen-e-studimit-e-projektimit-dhe-mbikqyrje-e-kolaudit-te-punimeve-te-ndertimit/>

V. Rekomandime të përgjithshme

Edhe pse është bërë progres në zbatimin e angazhimeve, plani aktual i veprimit nuk trajton prioritetet kryesore të aktorëve dhe disa angazhime nuk kanë lidhje të qartë me vlerat PQH. Një rekomandim kryesor është që qeveria të ndërmarrë angazhime ambicioze që janë në përputhje me procesin e anëtarësimit të vendit në Bashkimin Evropian (BE) dhe të prioritojë angazhime të tilla si kontratat e hapura, deklarimi i pasurive të zyrtarëve publikë dhe zbatimi me efektivitet i ligjit për konsultimin publik.

Ky seksion synon të shërbejë si bazë për hartimin e planit të ardhshëm të veprimit dhe të orientojë zbatimin e planit aktual të veprimit. Ai ndahet në dy pjesë: 1) ato prioritetet të shoqërisë civile dhe qeverisë të identifikuar gjatë hartimit të këtij raporti; 2) rekomandimet e MRP-së.

5.1 Prioritetet e aktorëve kryesorë

Pjesëmarrësit e të katër fokus grupeve të organizuara nga hulumtuesi MRP ishin dakord që fokusi i planit aktual të veprimit duhet të jetë përmirësimi i koordinimit dhe i përfshirjes së shoqërisë civile gjatë zbatimit të angazhimeve. Pjesëmarrësit e shoqërisë civile i bënë apel Qeverisë që të qartësojë menjëherë kuadrin institucional të PQH-së pas riorganizimit të saj në shtator 2017, me qëllim që të mundësojë një proces të shëndetshëm me pjesëmarrje gjatë hartimit të planit të ri të veprimit. Qytetarët që morën pjesë në fokus grupet MRP ishin të familjarizuar me shumë nga angazhimet e planit të veprimit 2016-2018. Megjithatë, ata shprehën më shumë mbështetje për angazhimet që trajtonin prioritetet e qytetarëve, si Regjistri i Integruar i Banesave të Shtetasve (Angazhimi 3), Ligji “Për Sinjalizimet dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve” (Angazhimi 9) dhe Ofrimi i Shërbimeve Elektronike (Angazhimi 10). Gjithsesi, ata pranuan rëndësinë e madhe të angazhimeve të tjera që kanë të bëjnë me transparencën dhe pjesëmarrjen qytetare, siç është transparenca e buxhetit, regjistri elektronik për njoftimet dhe konsultimin publik dhe standardet e hapura për kontraktimin. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e shoqërisë civile që morën pjesë në fokus grupin e grupeve të interesit i dhanë më shumë përparësi angazhimeve që kanë ndikim të mundshëm të lartë, përfshirë këtu publikimin e akteve të qeverisjes vendore në internet në sisteme të hapura, Standardet e Hapura për Kontraktimin dhe zbatimin e Ligjit “Për Sinjalizimet dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”.

Prioritetet për planin e ri të veprimit 2018-2020 duhet të përqendrohen në ato çështje që kanë lidhje me PQH dhe me qytetarët shqiptarë, të tilla si dhe ato që i japin një vlerë të shtuar zhvillimit të përgjithshëm dhe anëtarësimit të vendit në BE. Disa nga propozimet më të rëndësishme të qytetarëve, të cilat mund të bëjnë të mundur një ndikim transformues sipas përfaqësuesve të OSHC-ve që morën pjesë në forumin e shumëpalësh, janë:

Aksesi tek informacioni

- Të përmirësohet zbatimi i Ligjit “Për të drejtën e informimit”, në mënyrë që institucionet, veçanërisht ato të nivelit vendor, të standardizojnë metodat kur i kthejnë përgjigje kërkesave të qytetarëve ose OSHC-ve; dhe
- Të publikohen në një portal të vetëm në internet të gjitha raportet periodike (tremujore) dhe vjetore të institucioneve qendrore dhe të mbikëqyrjes. Kjo do të bëjë të mundur edhe një bazë të dhënash të centralizuar të të gjitha raportimeve të qeverisë dhe një format të unifikuar të raportimit bazuar në standarde dhe tregues.

Pjesëmarrje qytetare

- Të sigurohen konsultime të përshtatshme me aktorët kryesorë gjatë zbatimit të planit PQH të veprimit.

Llogaridhënia publike

Më poshtë jepet një listë e disa çështjeve të gjithanshme në fusha që aktorët kryesorë duan që të trajtohen por që nuk janë trajtuar deri tani në planin kombëtar të veprimit:

- Të vazhdohet me masat anti-korrupsion, sidomos në lidhje me partneritetet publike-private, koncesionet, financimin e partive politike dhe sektorët e arsimit dhe kujdesit shëndetësor;
- Të hartohen mekanizma monitorimi për të rritur efektivitetin e Ligjit “Për financimin e partive politike”;
- Të përmirësohet etika dhe standardet e administratës publike (meritokracia, lufta kundër nepotizmit), shërbimet publike dhe transparenca e taksave; dhe
- Të monitorohet zbatimi i reformës gjyqësore, veçanërisht kolona e anti-korrupsionit e kësaj reformë, duke përfshirë procesin e vetingut (verifikimit), zbatimin e “legjislacionit të dekriminalizimit”, integritetit publik etj.

Procesi PQH

- Të rritet ndërgjegjësimi publik dhe informimi në lidhje me PQH;
- Të përfshihen më shumë institucione dhe sektorë të angazhuar në planin e veprimit PQH si institucione përgjegjëse (p.sh., Kuvendi, gjyqësori, etj.)
- Të sigurohet që institucionet drejtuese dhe ato mbështetëse të marrin përsipër përgjegjësitë e angazhimit.

Të tjera

- Të monitorohen masat dhe performanca e institucioneve shtetërore në luftën kundër dhunës ndaj grave;
- Të përdoret TIK për të përmirësuar llogaridhënien dhe transparencën në zbatimin e strategjive që lidhen me sektorin bujqësor dhe shërbimet në këtë sektor;
- Të përmirësohet transparenca e standardeve dhe sigurisë së ndërtimit;
- Të jepen të dhëna për ndotjen dhe të merren masa për përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit në qytete industriale;
- Të publikohen të dhëna dhe të përmirësohet transparenca e masave në luftën kundër përdorimit të drogës/alkoolit tek të rinjtë; dhe
- Të përmirësohet mjedisi i biznesit, të mundësohen investimet e huaja të drejtpërdrejta dhe të luftohet varfëria përmes transparencës më të madhe dhe përmirësimit të kushteve ekonomike

Për ta përmbledhur, aktorët kryesorë që morën pjesë në fokus grupe rekomandojnë fuqimisht që të ndërmerren angazhime më ambicioze për të trajtuar prioritetet e qytetarëve si dhe sfidat që hasen në reformat kryesore të shtetit ligjor (p.sh., gjyqësori, anti-korrupsioni, pandëshkueshmëria, etj.).

5.2 Rekomandimet e MRP-së

Të sigurohet rinovimi i udhëheqjes dhe transferimi i njohurive institucionale mbi PQH

Pas pesë vitesh si vend anëtar dhe pas tre plane veprimi, del në pah se ka pak njohuri për ndikimin e Partneritetit të Qeverisjes së Hapur në Shqipëri tek publiku në përgjithësi si dhe tek institucionet e tjera qeveritare. Për të nxitur angazhimin e qeverisë për reforma në qeverisjen e hapur dhe për të siguruar vazhdimësinë e angazhimeve të zbatuara me sukses, qeveria duhet të bëjë investime më të mëdha me burime njerëzore dhe financiare për PQH-në. Qeveria shqiptare duhet të marrë përsipër qartësisht përgjegjësinë e axhendës PQH në qeverinë e ristrukturuar duke forcuar edhe më shumë rolin drejtues të ministrave në këtë proces, të sigurojë që Sekretariati të ketë burime të mjaftueshme për të koordinuar PQH-në dhe për të transferuar kujtesën institucionale të PQH brenda qeverisë së ristrukturuar.

Të respektohen Standardet e Pjesëmarrjes dhe Bashkë-Krijimit të PQH

Në frymën e PQH-së, qeveritë pjesëmarrëse duhet të përpiqen të krijojnë dhe zbatojnë planet e veprimit në bashkëpunim me publikun nëpërmjet një procesi me pjesëmarrje. Për të përmbushur këtë qëllim, gjatë hartimit dhe zbatimit të planit të ardhshëm të veprimit, qeveria shqiptare duhet t'i marrë në konsideratë Standardet PQH të Pjesëmarrjes dhe Bashkë-krijimit, të miratuar kohët e fundit.¹ Del e nevojshme që Qeveria të shfrytëzojë forumin OpenAlb si një strukturë e përbashkët për të hartuar dhe monitoruar planin e veprimit. Për të pasur një angazhim të hapur, qeveria duhet të marrë në pronësi faqen e internetit të forumit OpenAlb dhe të informojë rregullisht publikun përmes kësaj platforme me informacione të fundit në lidhje me forumin shumëpalësh, duke përfshirë rregullat e funksionimit, anëtarësimin në forum dhe aktivitetet për konsultime. Po ashtu, Qeveria duhet të publikojë përditësime për ecurinë e zbatimit të planit të veprimit, duke përfshirë edhe procesverbalet e takimeve, përmbledhje të kontributeve të publikut dhe rezultatet e angazhimit.

Të vihet fokusi tek angazhime ambicioze me lidhje me vlerat PQH për sa i përket kontratave të hapura në përputhje me kuadrin e anëtarësimit në BE

Plani aktual i veprimit përfshin reforma në qeverisjes elektronike, të cilat nuk përfshijnë hapjen ose elementë të pjesëmarrjes qytetare që do t'u mundësonin atyre lidhjen me vlerat PQH. Përveç kësaj, reformat e kryera në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE nuk kanë inkuadruar angazhimet e planit të veprimit PQH. Gjithsesi, PQH dhe anëtarësimi në BE duhet të konsiderohen si procese plotësuese, duke qenë se planet e veprimit PQH mund të jenë një instrument më shumë për zbatimin efikas të reformave të transparencës drejt anëtarësimit në BE. Një reformë e tillë, siç u theksua edhe nga Raporti i Progresit i KE-së i vitit 2016, është prokurimi publik. Plani i ardhshëm i veprimit mund të përqendrohet në këtë reformë duke përfshirë angazhimet që synojnë harmonizimin e legjislacionit me rregullat e prokurimit publik të BE-së, përfshirë këtu edhe rekomandimet për një regjistër kontratash për të gjitha kontratat publike dhe përmirësimet në proceset e dhënies së dhe menaxhimit të koncesioneve dhe në prokurimin e mbrojtjes. Agjencia e Prokurimit Publik, në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave, duhet të krijojë një regjistër të plotë publik për kontratat, vendimet për shpalljen e fituesit dhe shpenzimet duke përdorur Standardin e të Dhënave të Hapura për Kontratat për ta bërë informacionin të aksesueshëm për publikun si dhe të hartojë udhëzime për monitorimin e procedurave të prokurimit me qëllim rritjen e transparencës, angazhimit të përdoruesve dhe besimit të publikut. Kjo duhet të lidhet edhe me procesin e ankimit të Komisionit të Prokurimit Publik.

APP duhet të vazhdojë të forcojë sistemin e performancës dhe monitorimit të respektimit të prokurimit elektronik me anë të përdorimit të këtyre të dhënave dhe bëjë publike raportet dhe monitorimin e performancës. Nga ana tjetër, Regjistri i Koncesioneve dhe i Partneriteteve Publike-Private duhet të nisë me publikimin e të gjitha kontratave në format të hapur të dhënash duke përdorur OCDS.

Të sigurohet zbatimi me efektivitet i legjislacionit për konsultimin publik

Qeveria duhet t'i japë përparësi zbatimit të Ligjit "Për njoftimin dhe konsultimin publik", i cili përcakton detyrime të konsiderueshme për sa i përket publikimit të projektligjeve dhe organizimit të konsultimeve. Qeveria duhet të institucionalizojë praktikën e konsultimit me publikun për projekt-aktet nënligjore, të ofrojë afate kohore të përshtatshme për konsultime, të krijojë rregulla të qarta për të orientuar konsultimet dhe të japë opinionin e saj për të kontributin e qytetarëve.

Të prioritetizohet deklarimi i pasurive të zyrtarëve dhe aksesit i publikut tek regjistri i tokës

Disa angazhime për anti-korrupsionin dhe llogaridhënien, të propozuara nga institucionet shtetërore dhe të shoqëria civile në vitin 2016, nuk u përfshinë në planin aktual të veprimit. Ndryshimet në ligjin për deklarimin dhe kontrollin e pasurive në prill 2017 shtynë publikimin e deklaratave në faqen e internetit të ILDKPKI-së për të paktën tre vjet, duke vënë në dukje se publikimi mund të bëhet vetëm pas krijimit të infrastrukturës së nevojshme. Qeveria mund të bëjë ndryshime në ligj në mënyrë që deklaratat të publikohen në internet brenda një afati të caktuar. Në planin e ardhshëm të veprimit mund të përfshihet një angazhim që lidhet me deklarimin e pasurive të zyrtarëve publikë, përfshirë këtu aktivitete specifike për publikimin e deklaratave në internet dhe prezantimin nën formën e dorëzimit dhe verifikimit elektronik të deklaratave, sipas kërkesave të ligjit. Së fundi, qeveria duhet të ndërmarrë masa për ta bërë publik regjistrin e tokës, i cili minon përpjekjet e tjera të luftës kundër korrupsionit.

Tabela 5.1: Pesë rekomandimet kryesore

1	Të sigurohet rinovimi i udhëheqjes dhe transferimi i njohurive institucionale mbi PQH
2	Të respektohen Standardet e Pjesëmarrjes dhe Bashkë-Krijimit të PQH
3	Të vihet fokusi tek angazhime ambicioze me lidhje me vlerat PQH për sa i përket kontratave të hapura në përputhje me kuadrin e anëtarësimit në BE
4	Të sigurohet zbatimi me efektivitet i legjislacionit për konsultimin publik
5	Të prioritetizohet deklarimi i pasurive të zyrtarëve dhe aksesit i publikut tek regjistri i tokës

¹ Shih <https://www.opengovpartnership.org/ogp-participation-co-creation-standards>

VI. Metodologjia dhe burimet

Raporti i progresit MRP hartohet nga hulumtuesit sipas secilit vend pjesëmarrës në PQH. Të gjitha raportet MRP i nënshtrohen një procesi të kontrollit të cilësisë për të siguruar që janë zbatuar standardet më të larta të kërkimit dhe që është treguar kujdesi i duhur për to.

Analiza e progresit për planet e veprimit PQH ndërthur intervistat, hulumtimin, dhe kontributin nga takimet me aktorët jo-qeveritarë. Raporti MRP bazohet në gjetjet e raportit të vetë-vlerësimit të qeverisë dhe vlerësime të tjera të progresit të hartuara nga shoqëria civile, sektori privat, apo organizatat ndërkombëtare.

Çdo hulumtues MRP kryen takime me aktorët kryesorë për të siguruar një evidentim të saktë të ngjarjeve. Duke pasur parasysh kufizimet buxhetore dhe kohore, MRP nuk mundi të konsultonte të gjitha palët e interesuara ose të prekura. Rrjedhimisht, MRP përpaket për transparencë metodologjike dhe, për këtë arsye, kur është e mundur, bën publike procesin e angazhimit të palëve të interesuara në punën kërkimore (për të cilat jepen detaje më poshtë në këtë seksion.) Në ato kontekste kombëtare ku kërkohet anonimati i informatorëve-qeveritarë dhe jo-qeveritarë, MRP rezervon të drejtën për të mbrojtur anonimin e informatorëve. Për shkak të kufizimeve të nevojshme të metodës, MRP inkurajon dhe mirëpret komente mbi draftet publike të çdo dokumenti kombëtar.

Çdo raport i nënshtrohet një procesi me katër hapa për shqyrtimin dhe kontrollin e cilësisë:

1. Shqyrtimi nga stafi: Stafi i MRP-së e shqyrton raportin në aspektin e gramatikës, lexueshmërisë, përmbajtjes dhe respektimit të metodologjisë MRP.
2. Shqyrtimi nga Komisioni i Ekspertëve Ndërkombëtarë: Komisioni shqyrton përmbajtjen e raportit për saktësinë e evidencave që përdoren për të mbështetur gjetjet, vlerëson shkallën në të cilën plani i veprimit përmbush vlerat PQH dhe ofron rekomandime teknike për përmirësimin e zbatimit të angazhimeve dhe realizimin e vlerave PQH përmes planit të veprimit në tërësi. (Shih më poshtë për anëtarësimin në këtë komision.)
3. Shqyrtimi para publikimit: Qeveria dhe organizatat e përzgjedhura të shoqërisë civile ftohen të japin mendimin e tyre për përmbajtjen e raportit MRP.
4. Periudha e komenteve të publikut: Në këtë periudhë publiku ftohet të bëjë komente për përmbajtjen e draft raportit MRP.

Ky proces shqyrtimit, përfshirë edhe procedurën për reflektimin e komenteve të marra, përshkruhet më hollësisht në Seksionin III të Manualit të Procedurave.¹

Intervista me fokus grupe

Çdo hulumtuesi MRP i kërkohet të organizojë të paktën një takim publik për mbledhjen e informacionit. Hulumtuesit duhet të bëjnë përpjekje të vërteta për të ftuar edhe aktorë jashtë listës “standarde” të të ftuarve që tashmë marrin pjesë në proceset ekzistuese. Për të mbledhur opinionin e aktorëve kryesorë në një mënyrë më kuptimplote (p.sh. anketimet në internet, përgjigjet me shkrim, intervistat pasuese, etj.) mund të nevojiten mjetet të tjera plotësuese. Përveç kësaj, hulumtuesit duhet të kryejnë intervista specifike me agjencitë përgjegjëse kur për angazhimet kërkohen më shumë informacione nga sa jepen në vetëvlerësim ose nga sa mund të gjenden në internet.

Përveç kontakteve periodike gjatë periudhës së zbatimit me përfaqësuesit e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e çdo angazhimi dhe aktorëve të tjerë të përfshirë (shoqëri civile apo sektori privat), hulumtuesi MRP kreu një sërë intervistash në fund të periudhës së raportimit, korrik - tetor 2017. Megjithatë, u hasën vështirësi të jashtëzakonshme në intervistimin e përfaqësuesve të shtetit dhe në marrjen e informacioneve zyrtare deri në fund të tetorit 2017 për shkak të shkrirjes së disa ministrive dhe ristrukturimit të shumë agjencive shtetërore të listuara si institucione përgjegjëse ose të përfshira në zbatimin e planit të veprimit. Për më tepër, deri në kohën kur po hartohej ky raport qeveria nuk kishte përgatitur një raport vetëvlerësimi dhe ishte e paqartë se cili institucion shtetëror do të ishte koordinatori (i ri) i PQH-së. Përveç kësaj, pika e kontaktit e PQH për pjesën më të madhe të institucioneve shtetërore të përmendura në planin e veprimit ishte e paqartë. Rrjedhimisht, një pjesë e mirë e intervistave gjatë periudhës korrik - tetor 2017 u zhvilluan me aktorë jo-shtetërorë, ndërsa me përfaqësuesi të institucioneve shtetërore u realizuan një numër i kufizuar intervistash.

Për të marrë mendimin e aktorëve të shumtë, Hulumtuesi MRP organizoi katër diskutime në fokus grupe, prej të cilëve tre ishin me qytetarë dhe një ishte fokus grup me përfaqësues të shoqërisë civile - një forum shumëpalësh.

Qëllimi i fokus grupeve me qytetarë ishte të merrej informacion nga përdoruesit përfundimtarë të ndikimit të angazhimeve PQH në lidhmë me ndërgjegjësimin, përfshirjen dhe rezultatet nga plani i veprimit PQH. Më konkretisht, me fokus grupet e qytetarëve u diskutuan çështjet e mëposhtme kryesore:

- Niveli i informimit dhe ndërgjegjësimit të pjesëmarrësve për PQH dhe PQH Shqipëri, procesi, plani i veprimit, mekanizmat koordinues, rezultatet dhe ndikimi (pikëpamjet e përgjithshme).
- Niveli i informimit për angazhime të caktuara.
- Sa besojnë se plani aktual i veprimit trajton sfidat dhe prioritetet për Shqipërinë dhe për veten e tyre si një grup?
- Vlerësimi dhe analizimi i angazhimeve të planit aktual të veprimit - shqyrtimi i ecurisë (në varësi të nivelit të informacionit që ata kanë) dhe pritshmëritë e tyre.
- Cilat janë angazhimet konkrete (ose sfida/prioritete) që duan t'i shohin në planin e ardhshëm të veprimit?

Diskutimet e mëposhtme në fokus grupe me qytetarë u kryen nga Hulumtuesi MRP.

Fokus grupi 1 (Tirana, 30 gusht 2017)

Në grupin e parë bënë pjesë të rinj dhe të reja të moshës 20-30 vjeç që ishin ose kishin përfunduar universitetin, në punë dhe të papunë, që vinin nga zona të mëdha urbane (Tiranë, Durrës, Elbasan) dhe nga qytete të mesme apo të vogla (Lushnja, Vora). Ata përfaqësonin karakteristika të ndryshme fetare dhe etnike/kulturore (p.sh., komuniteti rom apo besimtarë praktikantë të fesë).

Përmbledhje e diskutimit

Vetëm 2 nga 10 pjesëmarrës (një student dhe një i ri në marrëdhënie pune) kishin dëgjuar por nuk kishin shumë informacione për PQH-në. Burimi i informacionit ishte media sociale (Facebook). Vetëm një prej tyre e dinte se MIAP është koordinatori kombëtar i PQH-së për Shqipërinë dhe kishte dëgjuar për Forumin OpenAlb. Pavarësisht mosnjohjes së PQH Shqipëri (për procesin apo planin e veprimit), pjesa më e madhe e pjesëmarrësve (tetë nga 10) kishin dëgjuar për të paktën një angazhim të PQH-së. Asnjë prej tyre nuk ishte në gjendje ta lidhte këtë informacion me PQH, por ishin informuar në një kontekst të ndryshëm rreth angazhimeve (siç

janë raportimi nga media i aktiviteteve të qeverisë, projekte të ndryshme të OJQ-ve, aktivitete të donatorëve të huaj, etj.). Angazhimet për të cilat kishin dëgjuar më parë ishin: Transparenca e buxhetit; Regjistri i integruar i banesave të shtetasve; Publikimi i legjislacionit të qeverisë qendrore dhe vendore në internet në sistemet e hapura dhe falas; Standardet e hapura për Kontratat, kontratat publike që duhet të publikohen në format të hapur të të dhënave; Ligji “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”; Ofrimi i shërbimeve elektronike (e-Albania); Kartela informative e qytetarëve. Megjithatë, pjesa më e madhe e pjesëmarrësve raportuan se nuk kishin informacione për ecurinë e zbatimit të këtyre “projekteve”. Pak prej tyre mund të ofronin përvojë personale me këto angazhime - shpesh duke përdorur rezultatet e angazhimeve ose duke pasur disa informacione rreth rezultatet e tyre. Të gjithë pjesëmarrësit sugjeruan që PQH Shqipëri është një nismë e dobishme për vendin, por për të qenë më efikas, ka shumë rëndësi të informohet publiku dhe të sigurohet përfshirja e qytetarëve (ndërgjegjësimi dhe informimi). Edhe pse angazhimet u konsideruan të dobishme nëse zbatohen ashtu siç duhet, shumica e grupit mendojnë se ato nuk pasqyrojnë prioritetet dhe sfidat aktuale të vendit. Disa nga pjesëmarrësit sugjeruan se shumë angazhime janë të rëndësishme dhe adresojnë disa nga shqetësimet kryesore me të cilat po përballlet Shqipëria (p.sh. anti-korrupsioni) dhe se publiku duhet të jetë më aktiv e t'i kërkojë qeverisë të japë informacione dhe të informojë publikun me anë të fushatave të veçanta. Pjesëmarrësit sugjeruan se disa nga sfidat më të mprehta të vendit nuk reflektoheshin në planin e veprimit, pavarësisht nga rëndësia e çështjeve që mbulon aktualisht plani i veprimit. Sfidat dhe prioritetet të tilla për Shqipërinë janë: varfëria, punësimi (sidomos punësimi i të rinjve) dhe liria e medias. Sa i përket planit të ri të veprimit, pjesëmarrësit sugjeruan që qeveria të përfshijë angazhime specifike në fushat / sektorët e mëposhtëm:

- Forcimi i parimit të meritokracisë në administratën publike dhe luftimi i nepotizmit
- Punësimi (i të rinjve dhe grave), veçanërisht në zonat periferike të qendrave kryesore urbane për shkak të migrimit të brendshëm
- Shërbimet publike (p.sh shtrirja e zyrave me një ndalesë)
- Anti-korrupsioni
- Reforma në gjyqësor
- Përmirësimi i mjedisit të biznesit, mundësimi i investimeve të huaja të drejtpërdrejta dhe luftimi i varfërisë
- Ndërgjegjësimi dhe informimi i publikut për PQH
- Forcimi i tolerancës dhe lufta kundër diskriminimit etnik, fetar dhe racial
- Transparenca e taksave
- Përmirësimi i cilësisë së arsimit fillor dhe të mesëm
- Lufta kundër korrupsionit dhe përmirësimi i cilësisë së sistemit të arsimit të lartë në universitetet publike

Fokus grupi 2 (Tirana, 31 gusht 2017)

Fokus grupi i dytë përbëhej nga gra që vinin nga zona të ndryshme (Tirana, Kamza, Elbasani, Durrësi, dhe Vora), me moshë të ndryshme (35 - 57 vjeç), me arsim të ndryshëm (50% me arsim të mesëm dhe 50% me arsim universitar), me banim në zonat rural (40%) dhe urbane (60%) dhe me status punësimi (50% në marrëdhënie pune, 50% të papunë).

Përmbledhje e diskutimit

Kur u pyetën për PQH, pjesëmarrësit nuk ishin në dijeni të PQH-së. Pas një prezantimi të shkurtër të PQH Shqipëri dhe rolit të MRP-së, një pjesëmarrës konfirmoi se kishte dëgjuar për PQH dhe OSHC-të në edicione lajmesh gjatë vitit të kaluar (ky pjesëmarrës i referohej një prej aktiviteteve të forumit OpenAlb). Pjesëmarrësit nuk ishin në dijeni të procesit të PQH apo të strukturës së organizatës në nivel global apo në Shqipëri, por ata theksuan se kjo është një nismë shumë interesante, e cila, nëse zbatohet siç duhet, mund të sjellë vlerë të shtuar për reformat dhe zhvillimin në Shqipëri. Megjithatë, ata ishin shumë skeptikë për efikasitetin e procesit. Ndërkohë që të gjithë pjesëmarrësit ishin skeptikë për Qeverinë, disa prej tyre shprehën dyshime në lidhje me efektivitetin e rolit të OSHC-ve. Një pjesëmarrës tjetër (i cili punon për një OJQ) e kundërshtoi këtë qëndrim: “Ky është një rreth vicioz. Nëse nuk i besojmë shoqërisë civile apo grupeve të qytetarëve për të sjellë ndryshimin dhe të përpiqemi t’i kërkojmë llogari qeverisë, atëherë sigurisht që OSHC-të nuk mund të bëjnë shumë. Ne varem nga besimi i qytetarëve për të ushtruar presion mbi Qeverinë. Por nëse besimi i publikut është i ulët, atëherë ne nuk mund t’ia dalim dot.” Asnjë pjesëmarrës nuk kishte dijeni për angazhimet PQH, ndonëse më shumë se gjysma e tyre konfirmuan se njiheshin me disa nga angazhimet, si më poshtë: Përmirësimi i bazës së të dhënave/portalit me të dhënat e koordinatorëve për të drejtën e informimit dhe programeve të transparencës; Regjistri i integruar i banesave të shtetasve; Krijimi i Regjistrit elektronik për njoftimet dhe konsultimin publik; Angazhimi për të publikuar legjislacionin e qeverisë qendror dhe vendore në internet në sistemet e hapura dhe falas; Standardet e hapura për Kontratat, kontratat publike që duhet të publikohen në format të hapur të të dhënave; dhe, Sistemi elektronik i regjistrimit të recetave elektronike në Republikën e Shqipërisë.

Dy pjesëmarrës ishin të punësuar në OSHC vendore dhe diskutuan me hollësi për angazhimet si: Përmirësimi i bazës së të dhënave/portalit me të dhënat e koordinatorëve për të drejtën e informimit dhe programeve të transparencës; dhe Krijimi i Regjistrit Elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike. Sidoqoftë, pjesëmarrësit e tjerë nuk kishin përvoja ose informacione të hollësishme për angazhimet e planit të veprimit. Shumica e pjesëmarrësve në këtë fokus grup sugjeruan se: grupi i angazhimeve pasqyron ndoshta prioritetet e qeverive ose ato të OSHC-ve dhe donatorëve, por ato nuk pasqyrojnë nevojat e qytetarëve. Në këtë kontekst, një nga pjesëmarrësit e fokus grupit argumenton: “Si është e mundur që nuk ka angazhim për varfërinë, përdorimin e drogës në shkollë apo dhunën ndaj grave?”

Disa pjesëmarrës sugjeruan se disa nga angazhimet janë shumë të dobishme, siç është ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve, por shprehën dyshime për zbatimin efikas të tyre. Në përgjithësi, shumica e tyre ranë dakord se plani i veprimit nuk reflekton sfidat urgjente të Shqipërisë. Kur u pyetën për sfidat dhe shqetësimet më të rëndësishme që Shqipëria duhet të trajtojë dhe që mund të gjejnë hapësirë në planin e veprimit të PQH përmes angazhimeve specifike, pjesëmarrësit sugjeruan sektorët/fushat e mëposhtme: Papunësia dhe varfëria; Rinia; Arsimi; Të drejtat e grave; dhe anti-korrupsioni dhe reforma në gjyqësor. Hulumtuesi MRP i ftoi pjesëmarrësit të jepnim sugjerime për çështje konkrete, të cilat, sipas mendimit të tyre, duhet të merren parasysh në planin e ardhshëm të veprimit. Më poshtë jepen ato që u sugjeruan nga pjesëmarrësit:

- Angazhimet në mbështetje të punësimit të të rinjve
- Standardet e sigurisë ushqimore
- Lufta kundër përdorimit të drogës/alkoolit tek të rinjtë
- Promovimi i mundësive për përmirësimin e aktiviteteve social-kulturore për të rinjtë

- Transporti publik, veçanërisht për nxënësit e shkollave
- Angazhimet lidhur me sigurinë rrugore (duke pasur parasysh numrin shumë të madh të vdekjeve në rrugët e vendit)
- Mbrojtja e mjedisit në qytete industriale (p.sh. Elbasan) dhe qendra të tjera urbane
- Siguria e ndërtimit
- Standardet e ndërtimit (për të siguruar standardet e sigurisë, por edhe cilësinë e jetës së banorëve)
- Angazhimet për përmirësimin e infrastrukturës së shkollave publike 9-vjeçare
- Fuqizimi i grave në vendimarrje
- Angazhimet lidhur me luftën kundër dhunës ndaj grave

Fokus grupi 3 (Tirana, 4 shtator 2017)

Në fokus grupin e tretë u bënë bashkë gra dhe burra nga periferitë e qyteteve kryesore dhe nga zonat rurale pranë qarqeve të Tiranës dhe Elbasanit, të moshës mbi 45 vjeç, me statuse të ndryshme punësimi (të papunë dhe të punësuar, përfshirë të vetëpunësuar) dhe arsimin e mesëm ose të lartë .

Përmbledhje e diskutimit

Ky diskutim fokus grupi u karakterizua nga qëndrime shumë skeptike ndaj PQH dhe mosbesimit të plotë tek qeveria. Kur u pyetën për PQH-në, pjesëmarrësit konfirmuan se ata nuk ishin në dijeni apo nuk kishin dëgjuar për të. Pjesëmarrësit u njohën me Partneritetin për Qeverisje të Hapur (2013-2017) - përparimet, arritjet dhe performancën e Shqipërisë në këtë partneritet - dhe u pyetën nëse ata ishin njohur me to. Pas prezantimit të shkurtër të PQH Shqipëri dhe rolit të MRP-së, pjesëmarrësit konfirmuan përsëri se nuk kishin informacione në lidhje me PQH në Shqipëri apo PQH në përgjithësi. Pjesëmarrësit ishin shumë skeptikë ndaj PQH dhe suksesit të saj të mundshëm në Shqipëri, kryesisht për shkak të faktit se ata nuk besojnë se qeveria shqiptare është serioze në përmbushjen e angazhimeve të saj.

“Ne [shqiptaret] jemi shumë të mirë për t’i vënë ligjet dhe strategjitë në letër por i harrojmë ato në praktikë.”

“Nuk mendoj se qeveria do të përmbushë as 30% të angazhimeve në praktikë.”

“Qeveria është konsultuar me shoqërinë civile, po për ne qytetarët? Ne jemi shoqëria e vërtetë civile, jo OJQ-të.”

Pjesëmarrësit nuk ishin në dijeni të angazhimeve të planit të veprimit. Gjithsesi, disa nga angazhimet u dukën të njohura për gjysmën e grupit, siç janë: Kartela informative e qytetarëve; Arkivi dixhital; Sistemi Elektronik i Monitorimit të Pyjeve; Transparenca e buxhetit; Receta elektronike; Regjistri i integruar i banesave të shtetasve; portali e-Albania. Ndryshe nga fokus grupet e tjera, disa pjesëmarrës vunë në dukje (si për habi) se reforma gjyqësore nuk është pjesë e planit të veprimit. Shumica e grupit (ndryshe nga fokus grupet e tjera) kanë pritshmëri shumë të larta për reformën në gjyqësor dhe e konsiderojnë atë si shtyllën e reformave të Shqipërisë. Në këtë kuptim, një nga pjesëmarrësit e fokus grupit argumenton se “çdo gjë tjetër do të varet nga kjo reformë. Lufta kundër korrupsionit, varfëria dhe gjithçka varet nëse gjyqësori do të fillojë të japë drejtësi në këtë vend.”

Shumica e pjesëmarrësve nuk e konsiderojnë angazhimin e planit të veprimit si pasqyrim të realitetit të Shqipërisë për sa i përket sfidave dhe shqetësimeve.

Pjesëmarrësit listuan çështjet/sektorët e mëposhtëm si sfidat më të rëndësishme të vendit: papunësia; korrupsioni; nepotizmi dhe mungesa e meritokracisë në administratën publike (në nivelin e qeverisë kombëtare si dhe në nivel vendor, ku sfidat janë edhe më serioze); cilësia e dobët e shërbimeve sociale sidomos për të papunët; mbizotërimi i ekonomisë informale; varfëria; shërbimet e dobëta shëndetësore në zonat rurale; politizimi i çdo institucioni shtetëror; dhe taksat vendore. Kur u pyetën për sfidat dhe shqetësimet më të rëndësishme që Shqipëria duhet të trajtojë dhe që mund të gjejnë hapësirë në planin e veprimit PQH nëpërmjet angazhimeve specifike, pjesëmarrësit sugjeruan angazhimet e mëposhtme specifike për planin e ardhshëm të veprimit:

- Përmirësimi i etikës dhe standardeve në administratën publike qendrore
- Përmirësimi i administratës publike në nivelin e qeverisjes vendore
- Angazhimet për të luftuar varfërinë në zonat e largëta
- Zbatimi i duhur i konsultimeve publike me qytetarët (dhe jo me anëtarët e partive në pushtet)
- Monitorimi i reformës gjyqësore
- Angazhimet për përmirësimin e sektorit bujqësor (si një degë e ekonomisë jetike për Shqipërinë) dhe i shërbimeve në këtë sektor

Forumi shumëpalësh (Tirana, 27 tetor 2017)

Me shoqërinë civile dhe përfaqësuesit e tjerë u zhvillua një takim sipas modelit të fokus grupit për të mbledhur pikëpamjet e aktorëve të ndryshëm të përfshirë në PQH dhe atyre pa këtë përvojë. Përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, akademisë dhe palëve të tjera të interesit që morën pjesë në diskutimin në fokus grup ishin:

- Ish pikë kontakti i qeverisë për PQH (Tiranë)
- Pedagog universiteti (Durrës)
- Instituti Shqiptar i Çështjeve Publike (Tiranë)
- Lëvizja Evropiane e Shqipërisë (Tiranë)
- Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (Tiranë)
- Lëvizja Mjaft! (Tiranë)
- Fondacioni Shoqëria e Hapur Shqipëri (Tiranë)
- Partnerët Shqipëri (Tiranë)

Pjesëmarrësit në diskutimin në këtë fokus grup u përqendruan kryesisht në procesin e PQH-së, mekanizmat institucionalë dhe përvojën me qëllim që t'i kthejnë planet e veprimit PQH dhe proceset e tyre në mekanizma më efikasë që janë në gjendje të prodhojnë rezultate të vërteta, ndikim dhe vlerë të shtuar për zhvillimin e përgjithshëm dhe reformat e anëtarësimit të Shqipërisë në BE. U diskutua edhe për mendimet që u evidentuan nga diskutimet në fokus grupe të organizuara me qytetarë të zakonshëm. Së fundi, fokus grupi me shumë aktorë shërbeu për të përditësuar gjetjet e MRP-së në lidhje me zbatimin e planit të veprimit, ndërkohë që u mbështetën propozimet e fokus grupeve me qytetarët për angazhime të reja në planin e ardhshëm të veprimit.

Pjesëmarrësit në këtë fokus grup nënvizuan mungesën e ambicieve në planin aktual të veprimit, ku shumë angazhime përfaqësojnë projekte në vazhdim apo veprime rutinë të qeverisë për miratimin e detyrime ligjore ose ndërmarrjen e reformave të tjera në kuadrin e procesit të anëtarësimit të vendit në BE (p.sh., zbatimi i Ligjit "Për

sinjalizimet dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, Transparenca e buxhetit, Ofrimi i shërbimeve elektronike). Angazhimet e propozuara nga organizatat e shoqërisë civile ishin thuajse tërësisht të varura nga financimi i donatorëve të siguruara nga OSHC-të përkatëse (p.sh. INFOCIP dhe Partnerët Shqipëri) dhe kur një financim i tillë nuk mund të sigurohej zbatimi i angazhimit kishte mbetur prapa (angazhimet: Krijimi i një baze të dhënash për arkivimin dhe publikimin e fondeve dhe programeve të kërkimit në Shqipëri dhe Standardet e Hapura për kontraktimin e kontratave publike që duhet të publikohen në format të dhënave të hapura).

Mungesa e burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për të koordinuar procesin e PQH dhe planin e veprimit u vu në dukje si pengesë kryesore për një PQH kuptimplotë dhe gjerësisht të njohur në Shqipëri. Përveç kësaj, kjo po pengon edhe përfshirjen më aktive të shoqërisë civile në këtë proces, pasi donatorët nuk e konsiderojnë si prioritet financimin e veprimtarisë së shoqërisë civile në kuadër të PQH Shqipëri. Një tjetër faktor që ndikon në rënien e vëmendjes së institucioneve qeveritare tek procesi të PQH dhe angazhimeve të tij në Shqipëri, sipas aktorëve të përfshirë në PQH, është mungesa e qartësisë dhe theksit të plotësueshmërisë ndërmjet PQH-së dhe proceseve të reformave në kuadër të anëtarësimit në BE. “Anëtarësimi në BE konsiderohet si objektiv kombëtar, ndërkohë që procesi jo vetëm që ka ndërgjegjësim dhe përkrahje të gjerë publike, por edhe kushtëzim më të qartë (kulaçi dhe kërbaci), dhe si pasojë, institucionet shtetërore jo vetëm që janë më rigorozë në raportim, por sigurojnë përfshirjen më të gjerë të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë jo-shtetërorë.”

Në vazhden e riorganizimit të institucioneve që qeverisë qendrore në shtator 2017 dhe statusit të paqartë të strukturave institucionale të PQH-së, përfshirë këtu dilemën se në cilin institucioni shtetëror do të caktohej koordinatori kombëtar i PQH-së, pjesëmarrësit sugjeruan me vendosmëri që qeveria të sigurojë stabilitetin e strukturave institucionale përgjegjëse për procesin e PQH dhe për ciklin në tërësi. Kjo do të shërbejë për të ngritur edhe profilin e PQH jo vetëm në sytë e publikut, por më e rëndësishmja mes institucioneve shtetërore, shoqërisë civile, donatorëve dhe aktorëve të tjerë pjesëmarrës apo potencialë.

Megjithatë, pjesëmarrësit ranë dakord se shqetësimet e mësipërme mbi rolin e institucioneve qeveritare të ngarkuara ose të përfshira në PQH nuk e justifikojnë mungesën e interesit tek OSHC-të për të marrë pjesë aktive në zbatimin dhe monitorimin e planit të veprimit. Organizatat donatore duhet të jenë më proaktive dhe të mbështesin veprimtarinë e shoqërisë civile në lidhje me PQH-në.

Së fundmi, pjesëmarrësit e grupit të fokusit mbështetën propozimet për planin e ri të veprimit, propozime që vijnë nga qytetarët në tre diskutimet e fokus grupeve të organizuara nga hulumtuesit MRP. Disa nga propozimet më të rëndësishme të qytetarëve, të cilat mund të kenë ndikime transformuese sipas përfaqësuesve të OSHC-ve që marrin pjesë në forumin shumëpalësh, lidhen me çështje si:

- Anti-korrupsioni
- Cilësia e arsimit, infrastruktura e shkollave publike dhe transporti i nxënësve
- Rinia dhe punësimi në zonat periferike të qendrave urbane
- Lufta kundër dhunës ndaj grave; promovimi i grave në vendimmarrje
- Sektori i bujqësisë dhe shërbimet bujqësore në këtë sektor
- Standardet dhe siguria e ndërtimit
- Mbrojtja e mjedisit në qytetet industriale
- Lufta kundër përdorimit të drogës/alkoolit tek të rinjtë

- Përmirësimi i standardeve të sigurisë rrugore dhe ushqimore
- Përmirësimi i etikës dhe standardeve në administratën publike (meritokracia, lufta kundër nepotizmit); shërbimet publike; transparencja e taksave
- Përmirësimi i mjedisit të biznesit, mundësimi i investimeve të huaja direkte dhe lufta kundër varfërisë
- Reforma/monitorimi i gjyqësorit
- Mundësitë për përmirësimin e aktiviteteve social-kulturore për të rinjtë
- Zbatimi i duhur i konsultimeve publike me qytetarët (dhe jo me anëtarët e partive në pushtet)
- Ndërgjegjësimi dhe informimi i publikut për PQH
- Forcimi i tolerancës dhe lufta kundër diskriminimit

Përveç kësaj, disa pjesëmarrës sugjeruan se është e nevojshme të ndërmerren veprime të vazhdueshme për të përmirësuar zbatimin e lirisë së informimit dhe aksesit tek informacioni. Një përfaqësues i Lëvizjes Mjaft! raportoi se disa institucione, veçanërisht ato në nivel vendor, kanë mendime të ndryshme kur u paraqitet një kërkesë për informacione nga qytetarët në krahasim kur një kërkesë e tillë bëhet nga OJQ-të. Përveç kësaj, disa institucione të qeverisë qendrore ndonjëherë janë të paqartë nëse Ligji “Për të drejtën e informimit” mbulon fushën e tyre të përgjegjësisë.

Një tjetër pjesëmarrës propozoi një angazhim për publikimin në një portal të vetëm në internet të gjitha raportet periodike (tremujore) dhe vjetore të institucioneve qendrore dhe të mbikëqyrjes. Kjo do të bëjë të mundur edhe një bazë të dhënash të centralizuar të të gjitha raportimeve të qeverisë dhe një format të unifikuar të raportimit bazuar në standarde dhe tregues.

Së fundi, aktorët kryesorë që morën pjesë në fokus grupe rekomandojnë fuqimisht rritjen e diversitetit të institucioneve dhe sektorëve të përfshirë si institucione përgjegjëse (p.sh., parlamenti, gjyqësori, etj.) dhe që të ndërmerren angazhime më ambicioze për të trajtuar prioritetet e qytetarëve si dhe sfidat që hasen në reformat kryesore të shtetit ligjor (p.sh., gjyqësori, anti-korrupsioni, pandëshkueshmëria, etj.).

Rreth Mekanizmit të Raportimit të Pavarur

MRP është një mjet kryesor me anë të të cilit qeveria, shoqëria civile dhe sektori privat mund të ndjekin hartimin dhe zbatimin nga qeveria të planeve të veprimit PQH çdo vit. Hulumtimi dhe kontrolli i cilësisë së këtyre raporteve bëhen nga Komisioni i Ekspertëve Ndërkombëtarë, të përbërë nga ekspertë të metodave të transparencës, pjesëmarrjes, përgjegjshmërisë dhe kërkimit në shkencat sociale.

Aktualisht, anëtarët e Komisionit të Ekspertëve Ndërkombëtarë janë:

- César Cruz-Rubio
- Hazel Feigenblatt
- Mary Francoli
- Brendan Halloran
- Hille Hinsberg
- Anuradha Joshi
- Jeff Lovitt
- Fredline M'Cormack-Hale
- Showers Mawowa
- Ernesto Velasco

Për raportet kujdeset një staf i vogël në numër me qendër në Uashington DC, nëpërmjet procesit MRP në bashkëpunim të ngushtë me hulumtuesin. Pyetjet dhe komentet për këtë raport mund të drejtohen tek stafi në adresën irm@opengovpartnership.org.

¹ Manuali i Procedurave MRP, V.3 : <https://www.opengovpartnership.org/documents/irm-procedures-manual>

VII. Shtojca e Kushteve për Pranim

Njësia për Mbështetjen e PQH i shqyrton kriteret e pranimit çdo vit. Këto rezultate paraqiten më poshtë¹. Aty ku është e përshtatshme, raportet MRP diskutojnë kontekstin në lidhje me përparimin apo hapat prapa për sa i përket kriterëve të caktuar në seksionin e kushteve të vendit.

Në shtator 2012, PQH vendosi të inkurajojë qeveritë të miratonin angazhime ambicioze në lidhje me performancën e tyre për kriteret e pranimit.

Tabela 7.1: Shtojca e pranimit të Shqipërisë

Kriteri	2011	Aktualisht	Ndryshimi	Shpjegimi
Transparenca e buxhetit ²	4	4	Nuk ka ndryshim	4 = raporti i auditit dhe propozimi i buxhetit të ekzekutivit i publikuar 2 = Një prej të dyve i publikuar 0 = Asnjëri nuk është publikuar
Akresi në Informacion ³	4	4	Nuk ka ndryshim	4 = Ligji për të drejtën e informimit 3 = dispozita kushtetuese për të drejtën e informimit 1 = Projekt ligj për të drejtën e informimit 0 = Nuk ka ligj për të drejtën e informimit
Deklarimi i pasurisë ⁴	4	4	Nuk ka ndryshim	4 = Ligji i deklarimit të pasurisë, të dhëna publike 2 = Ligji i deklarimit të pasurisë, të dhëna jo-publike 0 = Nuk ka ligj
Pjesëmarrja qytetare (pikët bazë)	4 (7.35) ⁵	4 (7.63) ⁶	Nuk ka ndryshim	Pikët bazë të Indeksit të Pjesëmarrjes së qytetarëve sipas EIU 1 > 0 2 > 2.5 3 > 5 4 > 7.5
Totali / (Përqindja) e mundshme	16/16 (100%)	16/16 (100%)	Nuk ka ndryshim	75% e pikëve të mundshme për t'u pranuar

¹ Për më shumë informacion shih <http://www.opengovpartnership.org/how-it-works/eligibility-criteria>.

² Për më shumë informacion shih Tabelën 1 in <http://internationalbudget.org/what-we-do/open-budget-survey/>. Për vlerësimet më të fundit shih <http://www.obstracker.org/>.

³ Dy bazat e të dhënave të përdorura janë dispozitat kushtetuese në <http://www.right2info.org/constitutional-protections> dhe ligjet e projektligjet në <http://www.right2info.org/access-to-information-laws>.

⁴ Simeon Djankov, Rafael La Porta, Florencio Lopez-de-Silanes, dhe Andrei Shleifer, "Disclosure by Politicians," (Tuck School of Business Working Paper 2009-60, 2009): bit.ly/19nDEfK; Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik (OECD), "Llojet e informacionit që duhet të publikojnë zyrtarisht vendimmarrësit dhe niveli i transparencës," in Qeverisja në një vështrim 2009, (OECD, 2009). bit.ly/13vGtqS; Ricard Messick, "Deklarimi i të ardhurave dhe pasurive nga vendet klient të Bankës Botërore" (Washington, DC: World Bank, 2009). bit.ly/1cloyf; Për informacion më të fundit shih bit.ly/1hjHfEJ. In 2014, Komiteti Drejtues i PQH miratoi një ndryshim në masën e deklarimit të pasurive. Ekzistenca e ligjit dhe aksesit de facto i publikut tek të dhënat e deklaruar zëvendësojnë masat e deklarimit nga politikanët dhe nga zyrtarët e nivelit të lartë. Për më shumë informacion shih shënimin udhëzues në Kërkesat për Pranin në PQH për vitin 2014 në bit.ly/1EjLJ4Y.

⁵ “Indeksi i Demokracisë 2010: Demokracia në tërheqje”, Njësia e Inteligjencës e Revistës Economist, (Londër: Economist, 2010), marrë nga bit.ly/eLC1rE.

⁶ “Indeksi i Demokracisë 2014: Demokracia dhe pakënaqësitë e saj”, Njësia e Inteligjencës e Revistës Economist (London: Economist, 2014), <http://bit.ly/18kEzCt>.